
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti IV (XVIII) - Nr. 15 (168) ISSN: 2305-655X

SHKENËA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

15

2016

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI IV (XVIII) 2016, NR. 15 (168)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2016

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI IV (XVIII), prill, maj, qershor 2016 nr. 15 (168)

Nën kujdesin e

kryetarit të KMSH-së: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Ali Zaimi

Prof. dr. Ayhan Tekinesh

Prof. dr. Ferdinand Gjana

Prof. dr. Hajri Shehu

Prof. dr. Njazi Kazazi

Prof. dr. Qazim Qazimi

Prof. dr. Rahim Ombashi

Dr. Brikena Smajli

Dr. Fahredin Ebibi

Redaktor: Andrin Rasha

Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame

Tefsir

Hadith

Fikh

Sociologji

Filozofi

Gjuhësi

Letërsi

Psikologji

Histori

Kulturë

Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Xhamia Muradije, Vlorë

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Rr. "George W. Bush", Nr. 50,

Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al

www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Strategjia e Islamit për vendosjen e paqes në botë,
Prof. dr. Muhamed Sherkavi, Arabi Saudite5
2. Ai është Kur'an i famshëm (një ajet dhe refleksione mbi një fakt),
Blerim Lazimi, Gjumnazi "Said Najdeni", Peshkopi12
3. Ibnu Maxheh dhe suneni i tij,
Dr. Sedat Islami22

Studime

4. Homazh i vonuar njeriut-gurqemer të urës shqiptare -
Lumo Skëndoja te *Zani i Naltë*,
Prof. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër, Tiranë36
5. "Zani i Naltë"- revistë e mendimit dhe emancipimit fetar e kombëtar,
Resul Rexhepi, Bashkësia Islame e Kosovës44
6. Myslimanët dhe koha, myslimanët në kohë,
Illir Akshija, M.D., M.Sc., Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë50

Gjuhë-Letërsi

7. Mësimi i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare e deri në fillimin e viteve
'20 të shekullit të kaluar (pjesa e II-të),
Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti i Shkodrës, "Luigj Gurakuqi"60

Histori

8. Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet për pavarësinë
e xhamisë shqiptare,
Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA80
9. Feja në shkolla, këndvështrim specialistësh të komunikimit ndërkulturor
dhe të dialogut ndërfaqet
MSc. Qani Sulku95

Personalitete

10. Iljas Bej Mirahori, një personalitet i shquar shqiptar (1410-1512)
Hysen Kobellari, Ph.D104

Retrospektivë

11. Duhet përkrahur feja
Rrapo Rustemi, Student i Medresesë së Përgjithshme114
12. Abstracts in English118
13. Rregullat e shkrimit125



Strategjia e Islamit për vendosjen e paqes në botë

Prof. dr. Muhamed Sherkavi
Arabi Saudite

Abstrakt

Mësimet islame e vënë theksin tek e drejta e njeriut për të zgjedhur besimin dhe fenë. Këtë parim Kur'ani e thekson në shumë pasazhe, si: "S'ka detyrim në fe" (Bekare, 256); "Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë" (Kehf, 29); "dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!" (Gashije, 22); "Detyra jote është vetëm që të kumtosh." (Shura, 48).

Islami njeh të drejtën e lirisë, të mendimit dhe shprehjes

Çfarëdo përpjekje për zhbërjen e parimit të pluralizmit dhe lirisë, si dhe çfarëdo manipulimi që mund t'i bëhet, duhet ditur se nuk ka të bëjë me Islamin dhe nuk shpreh parimet e vërteta islame, edhe nëse vjen nga persona dhe organizma që identifikohen me fenë islame. Praktika të tilla janë katërcipërisht larg Islamit të vërtetë dhe objektivave madhore të mesazhit të tij.

Në mënyrë të përmbledhur, do të flasim mbi strategjinë e Islamit për vendosjen e paqes në botë, strategji e cila bazohet në natyrën e mesazhit muhamedan në botë, ashtu siç e ka përcaktuar dhe prezantuar vetë Zoti kur thotë: **"Dhe nuk të kemi dërguar veçse si mëshirë për botët"** (Enbija, 107).

Kështu, funksioni i profetit Muhamed (a.s.) dhe misioni i tij, nga fillimi e gjer në fund, ishte të përhapë mëshirën me të gjitha kuptimet dhe format e saj, për mbarë botët. Që do të thotë, për mbarë njerëzimin, për ata që besojnë në këtë mesazh dhe për ata që e përgënjeshtrojnë. I dërguari i Zotit ishte i obliguar nga ana e Zotit që të shërbejë si mëshirë

për të gjithë, për mbarë gjithësinë, njerëzit, kafshët, bimët, ambientin etj.

Me qëllim që profeti Muhamed (a.s.) ta përmbushte misionin e tij (pra përhapjen e mëshirës për të gjithë), u pajis me disa vlera bazike dhe themeltare, me parime madhore, obligime dhe detyra që myslimanët duhej t'u përmbahen të gjithave, t'i zbatojnë me veten, t'i përhapin e t'i ndajnë me mbarë njerëzimin, myslimanë apo jo myslimanë qofshin.

Ndër këto vlera themeltare mund të cekim: Respektin e parimit të pluralizmit dhe të lirisë. Po, pluralizmit të feve dhe besimeve, pluralizmit të etnive dhe racave, pluralizmit të kulturave dhe civilizimeve, ose thënë shkurt pluralizmit të identiteteve në mbarë botën.

Pluralizmin fetar Zoti e përmend në Kur'an me fjalët: **“Vërtet, si ata që kanë besuar, ashtu dhe hebrenjtë, sabi'inët, të krishterët, mexhusitë e idhujtarët, Allahu do t'i gjykojë drejt të gjithë Ditën e Kiametit. Nuk ka dyshim, se Allahu është dëshmitar për çdo gjë.”** (Haxh, 17)

Pasazhi i mësipërm tregon se pushteti dhe kompetenca për të gjykuar fetë dhe besimet është vetëm e Zotit të lartësuar dhe i askujt tjetër, kompetencë e cila do të përdoret vetëm në botën tjetër dhe jo në këtë botë.

Lidhur me pluralizmin etnik, Zoti thotë: “Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Huxhurat, 13)

Kur profeti Muhamed (a.s.) migroi nga Meka, shoqëria e Medinës ku u vendos ishte një shoqëri diversive për nga besimet dhe zakonet, prandaj dhe ai vendosi atë që njihet si kushtetuta e Medinës, e cila u garantonte të drejtat të gjithë ithtarëve të feve të tjera, myslimanë, hebrenj dhe idhujtarë. Ajo organizonte marrëdhëniet, detyrimet dhe të drejtat në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët e Medinës. Kjo kushtetutë i mori në konsideratë të gjitha obligimet dhe të drejtat në mënyrë të barabartë mes grupeve, shoqërisë dhe shtetit. Ndër nenet që spikasin më fort në këtë sferë është ai që thekson se: “Myslmanët dhe hebrenjtë janë bashkësi e vetme”, pra një shoqëri e vetme e cila bazohet mbi të qenit pjesë e një komuniteti, pavarësisht besimit të individëve të saj.

Sakaq, lidhur me vlerën e lirisë, Islami e sheh atë si një të drejtë njerëzore të natyrshme, madje e sheh si një dhuratë hyjnore për njeriun, dhuratë e cila nuk duhet shkelur dhe cenuar.

Mësimet islame e vënë theksin tek e drejta e njeriut për të zgjedhur besimin dhe fenë. Këtë parim Kur'ani e thekson në shumë pasazhe, si: **“S’ka detyrim në fe”** (Bekare, 256); **“Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë”** (Kehf, 29); **“dhe nuk je ngarkuar t’i detyrosh ata me forcë!”** (Gashije, 22); **“Detyra jote është vetëm që të kumtosh.”** (Shura, 48).

Islami njeh të drejtën e lirisë, të mendimit dhe shprehjes.

Çfarëdo përpjekje për zhbërjen e parimit të pluralizmit dhe lirisë, si dhe çfarëdo manipulimi që mund t’i bëhet, duhet ditur se nuk ka të bëjë me Islamin dhe nuk shpreh parimet e vërteta islame, edhe nëse vjen nga persona dhe organizma që identifikohen me fenë islame. Praktika të tilla janë katërçipërisht larg Islamit të vërtetë dhe objektivave madhore të mesazhit të tij.

Nëse kolosët e mëdhenj të jurisprudencës islame gjykojnë se objektivat madhore të Islamit janë pesë: Mbrojtja e besimit, mbrojtja e jetës, mbrojtja e mendjes, mbrojtja e nderit dhe mbrojtja e pasurisë”, unë shkoj më tej dhe i bashkohem atyre që shtojnë dhe një të gjashtë: Mbrojtja e lirisë.

Kjo, sepse liria përbën esencën e nderimit dhe dinjitetit me të cilin Zoti e pajisi njeriun dhe nuk mund të flitet për dinjitet dhe nder për një të privuar nga liria e tij dhe për një të shtypur. Njeriu është një qenie e

nderuar nga vetë Zoti, pavarësisht fesë dhe nënshtetësisë që mban. Çfarëdo lloj agresiviteti dhe cenimi ndaj dinjitetit të njeriut është agresivitet dhe cenim ndaj Zotit, më saktë ndaj vullnetit të Tij, sepse Ai thotë: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit”** (Isra, 70).

Ndër vlerat tek të cilat Islami i fton njerëzit, të cilat kontribuojnë në vendosjen e paqes dhe forcimin e saj në botë, janë dhe:

Barazia, drejtësia dhe standardet e njëjta në ndërveprimin me njerëzit, pavarësisht diversitetit të kombësive, nënshtetësive dhe feve. Standardet e dyfishta janë të ndaluara për çfarëdo shkak, edhe nëse bëhet fjalë për armiq të kundërshtarët. Kjo, sepse praktika e standardeve të dyfishta kultivon padrejtësinë, urrejtjen dhe dhunën, duke përgatitur skenën lokale dhe globale për më shumë akte hakmarrjeje dhe reagime të dhunshme, të cilat, në fakt, prekin jetën e të pafajshmëve dhe pronat e tyre.

Në këtë kontekst, dua të kujtoj një udhëzim hyjnor plot urtësi për mbarë njerëzit: **“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.”** (Maide, 8)

Ndër vlerat islame me të cilat synohet reduktimi dhe kontrolli i konflikteve, armiqësive, përplasjeve dhe luftërave në botë, është dhe parimi i nxitjes së pajtimit dhe marrëveshjes mes palëve në konflikt. Vetë profeti Muhamed (a.s.) ishte model dhe shembull i pajtimit dhe uljes së gjakrave. Këtë e shohim qartë në marrëveshjen e Hudejbijes. Togfjalëshi i shenjtë të cilin e dëgjon shpesh nga gjuhët e myslimanëve është “pajtimi është më i mirë”, gjë e cila thekson dhe njëherë orientimin tonë si myslimanë për pajtim dhe marrëveshje të drejta, pasi kështu vendoset dhe forcohet paqja. Myslimani duhet ta kërkojë paqen më shumë se kushdo tjetër, pasi Kur’ani e porosit: **“Nëse ata shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano nga ajo.”** (Enfal, 61)

Gjithashtu, Islami bën thirrje për falje, tolerim dhe reagim me atë që është më e mirë. Islami bën thirrje që kundërshtari dhe armiku të trajtohen mirë pasi vetëm kështu ka shpresë për ndryshim të qëndrimit të tij armiqësor dhe orientim kah paqja dhe mirëkuptimi. Në Kur’an lexojmë: **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fusilet, 34)

Mësimet e Islamit dhe vlerat e tij e bëjnë myslimanin “njeri të paqes” nëse do të përdorim të njëjtat fjalë

që ka përdorur dhe mendimtari Fet’hullah Gylen. Prandaj dhe është detyrë e myslimanëve që këto vlera dhe parime t’i bëjnë pjesë të jetës së tyre dhe t’i ndajnë me të tjerët me qëllim që të mbretërojë paqja në botë.

Ndoshta është e tepërt të them që gjuha e myslimanit e shqipton me dhjetëra herë fjalën “paqe” brenda një dite të vetme, e shqipton teksa lutet në namaz, në jetën e tij private dhe atë publike. Ndoshta, urtësia e kësaj është me qëllim që t’ia kujtojë gjatë gjithë kohës që ai është mysliman dhe për rrjedhojë njeri që prodhon paqe dhe se është përgjegjësi e tij që të ndërtojë paqen në botë.

Lufta e lejuar në Islam është luftë defensive nga njëra anë dhe nga ana tjetër luftë që synon mbrojtjen e paqes dhe forcimin e saj në mbarë botën.

Islami kurrë nuk i ka lejuar luftërat ofensive kundër të pafajshmëve për hir të dominimit politik dhe ekonomik, apo për pushtimin e tokave të popujve të tjerë, zaptimin e tyre, cenimin e të drejtave dhe dinjitetit njerëzor, apo dhe mbrojtjen e pushtetarëve diktatorë si instrumente për të shtypur popujt dhe për t’i zhvatur.

Islami i ka dhënë status preferencial dialogut, të cilin e prezanton si strategji për ndërtimin dhe forcimin e paqes. Prandaj dhe

shohim që Islami e nxit dialogun dhe i fton njerëzit që ta praktikojnë atë, gjë e cila zë një hapësirë jo të vogël në Kur'an dhe në traditën profetike.

Në çfarëdo gjendje të jetë mospajtimi, kundërshtitë, konflikti dhe armiqësia, dialogu mes palëve bën që këndvështrimet të afrohen dhe të arrihet në mirëkuptim, gjë e cila e redukton armiqësinë dhe konfliktin, si dhe hedh themelet për vendosjen e paqes reale mes njerëzve.

Islami ofron modele të shumta dhe reale të dialogut. Një nga këto modele është dhe ai mes Zotit të lartësuar dhe shejtanit, të cilët janë simbole absolutisht të kundërt. Ky model orientues dhe udhëzues i Kur'anit është me qëllim që të kultivojë kulturën e dialogut pa kufi mes myslimanëve dhe të tjerëve, pasi vetë Zoti që është burimi i të vërtetës, i të mirës dhe i paqes, ka dialoguar me simbolin e të ligës dhe të keqes.

Në Islam, dialogu nuk ka tavan dhe kufi, ai përfshin dhe dialogun mes feve dhe mes kulturave.

Të shpeshta janë dialogët e frytshme që janë zhvilluar përgjatë historisë dhe gjeografisë islame mes dijetarëve myslimanë dhe atyre të feve të tjera. Këta dialogë zhvilloheshin në të gjitha sferat, disa zhvilloheshin në takimet e drejtpërdrejta, në xhami, tempujt e dijes, pallatet e pushtetarëve... duke respektuar njëri-tjetrin, dhe

të tjera që zhvilloheshin nëpërmjet literaturës dhe korrespondencës mes dijetarëve dhe liderëve.

Historia e ka regjistruar këto letër këmbime mes kalifit të pestë, Omer ibnu Abdul Aziz (vdekur në vitin 101 hixhri) dhe mes perandorit bizant Leo i tretë, letërkëmbime të cilat përbëjnë një dokument të vyer në historinë e dialogut ndërfeetar. Kalifi Omer ibnu Abdul Aziz, ndër të tjera, në një nga letrat që i dërgon Leos së tretë, i cili bëri një revolucion fetar kundër shenjtërimit të ikonave, imazheve dhe statujave në kisha, i thotë: “Më ka joshur ideja e njohjes së sekteve në fenë tuaj si dhe të studioj më thellë besimin tuaj, por që nuk më është dhënë shansi. Prandaj më trego për... këtë e atë...”

Mes dy liderëve ekzistonte një respekt qartësisht i dallueshëm, madje kur u sëmur kalifi Omer, perandori bizantin i dërgoi doktorin e tij për ta kuruar, i cili ishte prift i krishterë.

E nëse kalojmë në Andaluzi do të gjejmë dy të dërguarit e murgut Petrus Veneralibis nga manastiri Cluny, tek emiri i Saragozës. Të dërguarit biseduan dhe debatuan me dijetarin mysliman Ebul Velid el-Baxhi. Ata i dorëzuan dhe një letër nga murgu Petrus, të cilës ai iu përgjigj me një letër dialogu të mahnitshme. Unë vetë kam arritur të shtie në dorë një kopje të dorëshkrimit nga ana e manastirit Escorial në Spanjë. Dy letrat në fjalë janë publikuar në një studim.

E nëse shohim te mendimi i Fet'hullah Gylen, gjejmë që ai e thekson faktin se dialogu - te myslimani - nuk është një çështje dytësore dhe dekorative, por është obligim. Madje, shohim që ai shkon dhe më larg kur deklaron se dialogu është një nga detyrat e myslimanëve në tokë për hir të një bote më të paqte dhe më të sigurt.

Ai e bazon dialogun mbi tre parime islame: Tolerancën, mëshirën dhe dashurinë, duke e marrë "Bismilahun" si pikënisje, për shkak se në të përmenden dy cilësitë e Zotit "Rahman Rrahim – Gjithëmëshirshëm, Mëshirëbërës". Bismilahi përmendet në Kur'an 114 herë. Ai mendon se fakti i përmendjes kaq shpesh është me qëllim që t'i mësojë myslimanët që të jenë të mëshirshëm në marrëdhëniet e tyre me njerëzit e tjerë, madje edhe me vetë natyrën. Njeriu është përgjegjës që të manifestojë mëshirë karshi shoqërisë ku jeton dhe karshi njerëzimit. Sa më i mëshirshëm të jetë, aq më shumë lartësohet dhe sa më shumë të zhytet në ligësi, padrejtësi dhe dhunë, aq më i ulët dhe i degraduar bëhet për njerëzimin.

Për sa i përket dashurisë, Gylen tërheq vëmendjen tonë tek emri i Zotit "El Vedud –Miqësori" dhe i këshillon myslimanët që të bëhen pasqyrë e miqësisë dhe të bëhen umeti i dashurisë. Nuk ka armë më të fuqishme sesa dashuria. Dashuria është elementi themeltar i

ekzistencës, ajo është drita rrezatuese dhe forca e pathyeshme të cilës nuk i reziston dot askush.

Gylen beson se falja dhe toleranca janë në gjendje t'i mbyllin dhe trajtojnë plagët e të çarat përderisa kjo armë qiellore është në duart e atyre që e njohim dhe kuptojnë gjuhën e saj. Përndryshe, qasja dhe trajtimi ynë i gabuar mund të çojë në komplekse të ndryshme dhe të na fusë në qorrrokak, duke na privuar nga kontributi i vendosjes së paqes në botë.

Të kuptuarit e gabuar nga ana e disa myslimanë të konceptit të xhihadit dhe mos përmbajtja ndaj rregullave, ligjeve dhe etikës së tij, e cenon paqen dhe i hedh disa të rinj të zellshëm në krahët e dhunës dhe terrorit, pa e kuptuar.

Në kuptimin e tij më të gjerë, xhihadi është përpjekje - për hatër të Zotit – në të gjitha fushat e jetës, në forma të ndryshme, duke filluar nga përpjekjet për reformimin e zemrave dhe shoqërisë e deri te derdhja e gjakut në mbrojtje të jetës, shoqërisë dhe së shenjtës.

Xhihadi është dy llojesh, xhihad i madh dhe xhihad i vogël. Xhihadi i madh është ai që përfaqëson aspektin moral, është xhihadi i njeriut me veten dhe botën e tij të brendshme, gjë e cila i mundëson përsosmërinë. Kurse xhihadi i vogël është xhihadi i jashtëm; përpjekjet që bëhen për reformimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e saj në rast nevoje,

duke dhënë qoftë dhe jetën për këtë qëllim. Myslimani është i obliguar të ekuilibrojë mes dy xhihadeve, të brendshëm dhe të jashtëm, të vogël dhe të madh, ku secilit i duhet dhënë haku, për të ruajtur ekuilibrin e kërkuar.

Myslimani duhet ta mbajë shpirtin e xhihadit të ekuilibruar të ndezur në shpirtin e tij dhe të mos lejojë kurrë t'i shuhet. Besimtari gjatë gjithë jetës së tij duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për hatër të Zotit, si brenda vetes ashtu dhe jashtë saj, me qëllim që të reformojë shoqërinë dhe ta mbrojë atë.

Sipas këtij kuptimi, xhihadi nuk është një akt sezonal të cilin myslimani e praktikon, për t'iu kthyer rehatisë dhe dembelizmit më pas, por është një akt përpjekjesh i pandërprerë.

Gylen citon: Besimtari është i detyruar ta largojë padrejtësinë në çdo vend të botës, sepse është element i ekuilibrit në botë, është i mëshirshëm me krijesat, bujar me ta dhe bën çmos që t'i shpëtojë duke duruar fyerjet dhe vuajtjet. Ai i përngjan malit të paepur përballë kaosit, terrorit dhe dhunës. Ai pranon të flijojë dhe veten për të hequr vuajtjet e tyre nga shoqëria. Myslimani që mjaftohet me xhihadin e brendshëm dhe heq dorë nga xhihadi i jashtëm, dorëzohet përballë sfidave të jashtme dhe bëhet i nënshtruar dhe i përuhur. Kurse myslimani që jepet vetëm pas xhihadit të jashtëm, pa i

dhënë hakun xhihadit të brendshëm me veten, shndërrohet në një hajdut ose terrorist. Që këtu lind nevoja për ekuilibër dhe balancë mes dy xhihadeve dhe mbajtja e të dy këtyre përgjegjësive në mënyrë të balancuar dhe të përgjegjshme.

Sigurisht që korrigjimi dhe saktësimi i konceptit të xhihadit sipas rregullave dhe etikës do të kontribuojë në forcimin e paqes në tokë.

Përmbledhje

Strategjia e Islamit për prodhimin e paqes në botë dhe forcimin e saj buron nga një objektiv madhor i mesazhit islam: Përhapja e mëshirës në botë, kuptimi i të cilës e tejkalon atë të paqes.

Ajo ngrihet mbi themele dhe parime sublime të cilat nëse vihen në jetë nga myslimani me veten fillimisht dhe i ndan ato me njerëzit, shndërrohet në njeriun e vërtetë të paqes.

Kjo duket qartë në humbjet e shumta të botës për shkak të prapambetjes së myslimanëve, degradimit të tyre dhe mos praktikimit të fesë së tyre, parimeve dhe mësimëve të saj.

Përktheu: Elmaz Fida

Ai është Kur'an i Famshëm (një ajet dhe refleksione mbi një fakt)

Blerim Lazimi

Mësues i Fizikës në gjimnazin “Said Najdeni”, Peshkopi

Abstrakt

Njerëzit, në çdo kohë, janë përpjekur të gjejnë argumente, mbi të cilat kanë arsyetuar për lëvizshmërinë apo palëvizshmërinë e Tokës, e më tej, për vendin e saj në gjithësi (si i vetmi planet i privilegjuar nga jeta) ... Në pjesën e parë të ajetit pasqyrohet shumë qartë mendimi dhe pikëpamja që sundoi për shekuj të tërë në botëkuptimin shkencor dhe filozofik, madje edhe përtej epokës kuranore, deri në vitet 1500-1600. “E, i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme...”. Domethënë, në këtë pjesë të shkurtër të ajetit tregohet në mënyrë të sintetizuar se njeriu vazhdimisht historikisht i ka parë dhe studiuar malet e tokën. Dhe, më tej, ka menduar se ato e, edhe toka, janë të palëvizshme. Pra ka formuluar përshtypjen e pavërtetë se toka nuk lëviz, pikërisht pikëpamjen e sistemit gjeocentrik.

“... E, i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si retë, (kjo është) mjeshtri e Allahut që përsosi çdo send...”

Kur'an (27/88)

Hyrje

Në përmbledhjen “Mektubat” (Letrat), Bediuzzaman Said Nursi shtjellon argumentet e

pejgamberisë së Muhamedit (a.s.). “Shenja e tetëmbëdhjetë” fillon me argumentin më parësor, më kryesor dhe më bazik, Kur'anin e Gjithurtë, si mrekullia më e madhe

e të Dërguarit të Nderuar. Më tej, ai vazhdon të trajtojë një prej dyzet aspekteve mrekullore të Kur'anit, duke u shprehur kështu: "Kur'ani i Gjithurtë ka një lloj të ndryshëm mrekullie, duke i korresponduar të kuptuarit të çdo klase shoqërore. Ai e tregon ekzistencën e mrekullisë së tij për gjithsecilin në mënyrë të veçantë..." Për dyzet klasat e njerëzimit Kur'ani hap një dritare dhe tregon mrekullinë e tij. Për studiuesit e retorikës dhe elokuencës, ai shfaq mrekullinë e elokuencës së tij të jashtëzakonshme; për poetët dhe oratorët, ai tregon stilin e tij origjinal, të lartë e të bukur; për historianët demonstroi informacione të epokave të ndryshme; për sociologët e politikanët, ai udhëzon me mrekullinë e parimeve të ndërtimit të jetës njerëzore; për mistikët, ai zbulon misteret e fshehura në versetet e tij, për të pasionuarit pas dijes, ai i fton në të vërtetat kozmike. Në mbyllje të trajtimit të "Shenja e tetëmbëdhjetë", për ta bërë më të kuptueshëm argumentin e tij, Bediuzzaman Said Nursi sjell krahasimin: "Për më tepër, gjendet një gjerësi e tillë në udhëzimin e Kur'anit, saqë, si engjëlli Xhibril, ashtu edhe një fëmijë i maturuar, mund ta dëgjojnë të njëjtin mesim krah për krah dhe të dy marrin pjesën e vet."¹

1. Përmbledhja "Risale-i Nur" - "Letrat" Bediuzzaman Said Nursi, botimi shqip, f. 262-275.

Në këtë këndvështrim, ajeti kuranor "... E, i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si retë, (kjo është) mjeshtri e Allahut që përsosi çdo send..."², është komentuar ndryshëm nga studiuesit e Kur'anit. Sjellim këtu dy komente që dallojnë dukshëm nga njëri-tjetri. Harun Jahja (Adnan Oktar) e ka komentuar ajetin e mësipërm lidhur me teorinë e "lëvizjes kontinentale", pra të largimit të kontinenteve nga njëri-tjetri, për shkak të zhvendosjes së pllakave tektonike. Këtë ai e mbështet në të qenët e kodrave dhe maleve si pjesë e rëndësishme organike e kontinenteve dhe e kores së Tokës.³ Ndërsa dietari i njohur Abdul Mexhid ez Zendani (ashtu si edhe komentues të tjerë të Kur'anit) e komenton ajetin si një shprehje të qartë për lëvizjen (rrotullimin) e planetit Tokë.⁴

Duke qëndruar në këtë argument, po shtjelloj një fakt interesant, që mund të bëhet pjesë e komenteve të mësipërme për ajetin kuranor 27/88. Fakti është një argument plus në mbështetje të qëndrimit për lëvizjen (rrotullimin) e planetit Tokë, por ai është i interpretuar në rrafshin krahasues

2. Kur'an (27/88), f. 439, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

3. "Mrekullitë e Kur'anit", Harun Jahja, Alb-Books 2002, f. 34, 35.

4. "Njëshmëria e Krijuesit", Abdul Mexhid Ez-Zendani, Prishtinë, 1998, f. 456.

me idetë e dy përfaqësuesve të shquar të shkencës në kohën kur jetuan, Klaud Ptolemeu dhe Nikolla Koperniku. Krahas kujdesit të matur dhe të sinqertë, që duhet treguar në komentimin e ajeteve kuranore me gjuhën e arritjeve shkencore, ndoshta plotësohet mrekullia që gjithsecili të marrë prej Kur'anit pjesën e vet të mësimimit dhe udhëzimit hyjnor.

Toka, lëvizja e saj dhe retë – kronologji citimesh

Ptolemeu: "... Pra, në qoftë se Toka do të rrotullohej, së paku me një rrotullim në ditë...trupat që bien lirisht, nuk do të arrinin as ato, pingultas në vendin që u është përcaktuar, i cili ndërkohë do të zhvendosej me shpejtësi shumë të madhe nën ta. Dhe do të shihnim po ashtu **retë** që të shkonin gjithmonë drejt perëndimit, si të gjitha gjërat e tjera që notojnë në ajër..."⁵

(shekulli II i erës sonë)

Kur'an (27/ 88): "... E, i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si **retë**, (kjo është) mjeshtri e Allahut që përsosi çdo send..."⁶

(vitet 610-632 të erës sonë)

N. Koperniku: "... Tani, për sa i takon lëvizjes së Tokës, mund të

ndodhë që në mënyrë të ngjashme të besohet që e tërë bota të lëvizë përreth (saj). Por, ç'është themi ne po të prekim **retë** dhe gjërat e tjera që lundrojnë në qiell, si dhe ato që bien poshtë, apo në të kundërt, që ngjiten lart?..."⁷

("De Revolutionibus" – viti 1543 i erës sonë)

3. Histori ... dhe informacion

Klaud Ptolemeu – Jeto i dhe kreu vrojtimit e tij në Aleksandri në shekullin e dytë të erës sonë. Vepra e tij, që ka mundur të arrijë deri në ditët tona, na e tregon atë si astronom, matematikan dhe gjeograf. Vepra kryesore e Ptolemeut mban emrin "Ndërtimi i madh", që sot njihet me titullin "Almagest". Një pjesë e madhe e përmbajtjes së Almagest-it, siç e pohon vetë Ptolemeu, rrjedh nga Hiparku. Vepra përbëhet nga 13 libra (kapituj), në të cilët trajtohen parime të trigonometrisë plane dhe sferike, fakte të vrojtuar, si dhe parimet themelore të filozofisë së Ptolemeut, të cilat mbetën në fuqi gjatë gjithë mesjetës e deri në kohën e Kopernikut. Sipas Ptolemeut: Toka ka formë sferike; perimetri i saj është 180000 stade= 28000-30000 km (stade është njësi gjatësie e përdorur në Greqinë e lashtë); toka është në qendër të botës dhe mund të quhet si pikë kundrejt largësisë së yjeve; Toka

5. "Astronomia e re. Nikolla Koperniku", përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983, f. 91.

6. Kur'an (27/88), f. 439, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

7. "Astronomia e re. Nikolla Koperniku", përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983, f. 95.

nuk kryen asnjë lëvizje (për të është më e lehtë të lëvizin yjet që duken të një natyre me flakën, se Toka që është e ngurtë). Me gjithë gabimin e koncepteve themelore, vepra e Ptolemeut çmohet për shkallën e lartë të përpikërisë së arritur në vrojtimit e tij. Kjo përpikëri kontribuoi në mënyrë vendimtare që sistemi ptolemean të vlerësohej si sistemi më i rëndësishëm ndër të gjitha sistemet dhe të pranohej për shumë shekuj.

Kur'ani – Libër që daton rreth viteve 610-632 të erës sonë. Mbi autorësinë e tij ka dy qëndrime. Myslimanët e besojnë se është Fjala e Zotit, që i është shpallur profetit Muhamed gjatë një kohe prej gati 23 vjetësh, për të udhëzuar njerëzimin në rrugën e paqes e të lumturisë. Ndërsa pjesa tjetër ia atribuojnë autorësinë e Kur'anit Muhamedit, megjithëse, nga të dhënat historike, dihet se ai ishte i paarsimuar, nuk dinte shkrim e këndim. Kur'ani përmban norma të besimit e të moralit, ligje për ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, si dhe të raporteve të njeriut me natyrën, etj. Përveç tyre, në këtë libër gjenden trajtime koncize (në parim) fenomenesh lidhur me njeriun, botën bimore e shtazore, planetin tonë dhe universin. Një ndër to është edhe çështja e shtruar për shqyrtim. Kur'ani shërbeu si frymëzues për lindjen dhe lulëzimin e një qytetërimi original që mbrojti, përpunoi

dhe tejçoi vlerat e qytetërimeve paraardhëse, që shërbeu edhe si pararendës i rilindjes evropiane dhe qytetërimit të sotëm.

Nikolla Koperniku – U lind më 19 shkurt 1473. Studioi në kurset e filozofisë, mjekësisë, drejtësisë, të pikturës dhe perspektivës. Por mbi të gjitha iu kushtua matematikës e astronomisë. Kultura dhe dija e tij e madhe i kishin lejuar të lexonte shumë tekste të lashta në gjuhën e tyre origjinale. Koperniku njëjhte mirë të gjitha teoritë astronomike të paraardhësve, duke përfshirë edhe ato që ndryshonin nga sistemi i Ptolemeut. Pikëpamjet e tij lidhur me Tokën dhe vendin e saj në gjithësi, Koperniku i përmbloodhi dhe i bëri publike në librin e tij “De Revolutionibus” - “Mbi rrotullimin e rrahëve qiellorë”. Botimi i veprës iu ngarkua Retikut në Nuremberg, por, kur ky u transferua në Lajpcig, kjo detyrë iu besua priftit luteran Andrea Osiander. Ky i fundit, duke pasur frikë të kujdesej për botimin e një libri në të cilin mohohej palëvizshmëria e Tokës, gjeti idenë “e ndritur” që t’i parashtrojë veprës një “shënim lexuesit mbi hipotezat e veprës”, të cilën nuk e firmosi. Në shënim ai nuk lodhej së thëni që në vepër bëhej fjalë vetëm për hipoteza, që autori nuk duhej qortuar, sepse detyra e vërtetë e astronomit është të vëzhgojë lëvizjet e trupave qiellorë dhe t’i shpjegojë ato nëpërmjet llogaritjeve, pa qenë nevoja që këto

hipoteza të jenë të vërteta, e të tjera si këto. Koperniku e mori kopjen e librit në shtratin e vdekjes dhe nuk arriti të ketë dijeni për këtë çështje. 60 vjet më pas, Johan Kepleri e sulmoi ashpër Osianderin dhe po kështu bëri edhe Xhordano Bruno. Vdekja e shpëtoi nga sulmet dhe sflitjet që me siguri do t'i vinin nga injoranca dhe fanatizmi i kundërshtarëve. Kisha filloi qëndrimin armiqësor ndaj veprës. Ja se si u shpreh ajo: "... Flasin për një astrolog të ri, që do të provojë se është Toka që vërtitet rreth vetes, e jo qielli, Dielli e Hëna (rreth Tokës) ... Një budalla kërkon të përmbysë tërë artin e astronomisë..." Përhapjen e doktrinës së Kopernikut kisha e quajti të rrezikshme, prandaj i bënte thirrje pushtetit laik që të luftonte kundër "shthurjes së mendjeve" dhe të mos lejonte mësimin e doktrinës së Kopernikut në shkolla. Në dekretin e 16 marsit 1616 kisha katolike e cilësonte atë si doktrinë pitagoriane: "Doktrina që vendos Diellin të palëvizshëm në qendër të gjithësisë është e gabuar, formalisht heretike dhe bie në kundërshtim me shkrimin e shenjtë, ndërsa doktrina që e heq Tokën nga qendra e gjithësisë dhe e vë në lëvizje është filozofikisht e gabuar dhe të paktën largim nga besimi". Libri i Kopernikut u fut në "Indeksin e librave të ndaluar", ku e mbajtën deri në vitin 1822. Mund të shtojmë se edhe teologët protestantë e quajtën të gabuar e të dëmshme

teorinë heliocentrike të Kopernikut.⁸

Në veprën "De Revolutionibus", "Mbi rrotullimin e rathëve qiellorë" arsyetimet e Kopernikut mbështeten fort në kuptimin e relativitetit të lëvizjes. Sipas tij Toka rrotullohet rreth një boshti. Dielli qëndron i palëvizshëm, ndërsa planetët, ndër ta edhe Toka, rrotullohen rreth tij. Koperniku ruajti postulatit e vjetër të lëvizjeve rrethore të njëtrajtshme.

4. Fakti

Njerëzit, në çdo kohë, janë përpjekur të gjejnë argumente, mbi të cilat kanë arsyetuar për lëvizshmërinë apo palëvizshmërinë e Tokës, e më tej, për vendin e saj në gjithësi (si i vetmi planet i privilegjuar nga jeta). Kur lexon tre citatat e fillimit (nga Ptolemeu, Kur'ani dhe Koperniku), të tërheq vëmendjen një fakt shumë interesant. Edhe pse të shfaqura në kohë të ndryshme, qëndrimet i referohen të njëjtut objekt fizik: **reve**.

Ptolemeu pranon vetëm lëvizjen e reve, kurse Toka sipas tij është e palëvizshme (kujtojmë se ai përdor edhe arsyetime të tjera për të arritur në këtë përfundim).

Në mekanikën klasike lëvizja e objekteve konsiderohet relative. Për shembull, një pasagjer, i ulur në ndenjësën e një makine që lëviz, është në prehje në lidhje me makinën dhe lëviz në lidhje me objekte të

8. "Astronomia e re. Nikolla Koperniku", përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983, f. 111-114.

fiksuar në tokë (pemë, ndërtesë etj.). Pra, për të vlerësuar nëse një trup lëviz apo prehet, duhet të përcaktohet paraprakisht një objekt, në të cilin (siç thuhet në gjuhën e fizikës) lidhet një sistem referimi. Këtë rol mund të luajë çdo objekt në natyrë. Duke përdorur këtë logjikë të relativitetit të lëvizjes, Koperniku mendon se, ashtu siç duket lëvizja e reve kur i vrojtojmë nga Toka, të njëjtën gjë mund të themi për Tokën (që ajo lëviz) po ta shohim nga retë. Mbështetur dhe në vrojtime të tjera, ai e konsolidon idenë e guximshme për kohën, të rrotullimit të Tokës rreth Diellit. Edhe pse me disa gabime konceptuale, të justifikueshme për kohën kur jetoi e punoi (Diellin e konsideronte të palëvizshëm), Koperniku është figura qendrore e astronomisë së re, pikë kthese në historinë e mendimit shkencor e filozofik, që çoi në rilindjen evropiane pas shekujve të errët mesjetarë.

Por, për të qenë të saktë, ideja për lëvizjen e Tokës dhe rrotullimin e saj rreth Diellit, është shumë e hershme. Atë e hodhi në formë hipoteze Aristarku (310-250 para erës sonë) i Aleksandrisë, domethënë rreth 1800 vjet para Kopernikut. Madje, Aristarkun, për hipotezat e tij të guximshme, e akuzuan si të pafe dhe përçmues të hyjnive, meqë kishte barazuar Tokën me planetët e tjerë, duke e rrotulluar këtë bashkë me to

rreth Diellit.⁹ Aristarku, gjithashtu e mendonte Diellin të palëvizshëm (për t'u habitur, këtë qëndrim mbajti edhe Koperniku!). E megjithatë, hipotezat e tij u tretën shumë shpejt pa lënë gjurmë, për t'u rishfaqur të kristalizuara në idetë e Kopernikut pas afro 1800 vjetëve.

Gjithashtu, reve i është referuar edhe Kur'ani, për të shpjeguar lëvizjen apo jo të Tokës. Në Kur'an qëndrimi duket i kthjellët dhe i prerë: Toka lëviz ("*... ato (kodrat) lëvizin si retë...*"). Ajeti i Kur'anit ka një ndërtim shumë interesant, gjë që nxjerr në pah stilin e lartë dhe elokuencën. Pra të tërheq vëmendjen mënyra se si trajtohet çështja në fjalë. Në pjesën e parë të ajetit pasqyrohet shumë qartë mendimi dhe pikëpamja që sundoi për shekuj të tërë në botëkuptimin shkencor dhe filozofik, madje edhe përtej epokës kuranore, deri në vitet 1500-1600. "*E, i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme...*". Domethënë, në këtë pjesë të shkurtër të ajetit tregohet në mënyrë të sintetizuar se njeriu vazhdimisht historikisht i ka parë dhe studiuar malet e tokën. Dhe, më tej, ka menduar se ato e, edhe toka, janë të palëvizshme. Pra ka formuluar përshtypjen e pavërtetë se toka nuk lëviz, pikërisht pikëpamjen e sistemit gjeocentrik. Kujtojmë se çdo kundërshtim ndaj saj shoqërohej me persekutime e

9. "Astronomia e re. Nikolla Koperniku", përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983, f. 71.

deri në ekzekutime me vdekje. Më pas, në pjesën e dytë të ajetit, jepet pozicionimi i Kur'anit (i ndryshëm nga ai i kohës): "... ndërsa ato lëvizin si retë...", i cili është i vendosur, e nuk lë vend për dyshime hipotezash apo përshtypjesh njerëzore. Mund të mendohet se në Kur'an bëhet fjalë për lëvizje të kodrave dhe jo të Tokës si planet. Por, malet janë pjesë kryesore e kores së planetit Tokë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e saj. Kjo sqarohet në disa vende në Kur'an: "*Kurse malet ia përforcoi*"¹⁰, "*Dhe Ai (Allahu) vuri kodra (të forta) në Tokë, ashtu që ajo të mos lëkundet me ju...*"¹¹, apo "*Ndërsa malet i bëmë shtylla*"¹². Gjithashtu, mund të shtohet se zgjedhja e fjalëve për të shpjeguar çështjen në mënyrë të kuptueshme, është bërë në përshtatje me kohën e paraqitjes së Kur'anit dhe me formimin kulturor e shkencor të njerëzve të thjeshtë.

5. Përfundime

Në rrjedhën e kohës Kur'ani ndodhet ndërmjet Aristarkut e Ptolemeut (që i përkasin qytetërimit të lashtë grek) dhe Nikolla Kopernikut (që përfaqëson fillimin e rilindjes

evropiane). Ishte ideja e lëvizjes së Tokës – modeli heliocentrik i sistemit diellor, që e bëri të famshme figurën e Kopernikut, jo vetëm në astronomi, por në historinë e mendimit njerëzor. Në monumentin e Kopernikut, të ndërtuar në Varshavë gati 300 vjet pas botimit të veprës së tij, pasardhësit shënuan këtë mbishkrim në shenjë mirënjohjeje për të: "Ndaloj Diellin, lëvizi Tokën."¹³ Por, a ishte Koperniku i pari, i cili mbrojti këtë pikëpamje? Nga sa parashtruar më sipër, del se për lëvizjen e Tokës ka folur edhe Aristarku (1800 vjet para Kopernikut). Ndërsa dokumenti i parë, në të cilin shprehet qartë e pa mëdyshje (jo në formë hipoteze si tek Aristarku) lëvizshmëria e Tokës, është Kur'ani, rreth 900 vjet para Kopernikut. Prandaj vendi meritohet i takon Kur'anit. Po! "...Ai është Kur'an i Famshëm!..." (Kur'an, 85/21) "... një Kur'an që mahnit..." pohuan xhindet (Kur'an, 72/1).

Vihet re një përputhje mes hipotezave të Aristarkut dhe pikëpamjeve të Kopernikut. Ashtu si Aristarku (që mendonte se Toka lëviz rreth Diellit në orbitë rrethore dhe se Dielli është i palëvizshëm në qendër të orbitës), arsyetonte edhe Koperniku. Sipas tyre Dielli ndodhet në qendër të orbitave rrethore të planetëve dhe nuk lëviz. Ndryshe nga ky qëndrim i pasaktë,

10. Kur'an (79/32), f. 693, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

11. Kur'an (16/15), f. 313, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

12. Kur'an (78/7), f. 691, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

13. "Astronomia e re. Nikolla Koperniku", përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983, f. 114.

në Kur'an gjejmë korrigjimin e saktë të tyre. “Ai është që krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë.”¹⁴, “... dhe nënshtroi Diellin dhe Hënën që çdonjëri udhëton deri në një afat të caktuar...”¹⁵, “...Edhe Dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënyjesit, të Dijshmit... As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën ... po secili noton në një orbitë.”¹⁶. Pra, jo vetëm Toka lëviz, por lëviz edhe Dielli sipas një orbite vetjake. Vlera e një konstatimi të tillë në Kur'an rritet edhe më shumë kur kujtojmë se ai (Kur'ani) nuk është libër i mirëfilltë shkencor dhe se Koperniku gaboi në këtë.

Përmendëm në fillim se për autorësinë e Kur'anit ka dy qëndrime: sipas myslimanëve ai është Fjala e Zotit; ndërsa të tjerët njohin Muhamedin si autor të librit. Le të krahasojmë në këndvështrimin e

Muhamedin (571-632 e.s.) dhe Kopernikun (1473-1543). Për vetë kohën kur jetoi, Koperniku është figura më e plotësuar – kujtojmë që ai ishte matematikan, astronom, mjek, jurist, teolog, njohës i disa gjuhëve të huaja, madje edhe i greqishtes së vjetër. Po ashtu, Ptolemeu ka qenë një personalitet i shquar i kohës së tij – njihite mirë pikëpamjet e paraardhësve të tij në fushën e matematikës dhe astronomisë; kreu vëzhgime të shumta të qiellit me një shkallë të lartë përpikërie. Ndërsa Muhamedi njihet si një figurë historike politike, shoqërore e shpirtërore. Ai ishte i paarsimuar.

Ptolemeu ishte larg së vërtetës me sistemin gjeocentrik (Toka nuk lëviz, Dielli rrotullohet rreth Tokës). Por edhe Koperniku gaboi kur e mendoj Diellin si të palëvizshëm.

Tabelë krahasuese e pikëpamjeve mbi Tokën dhe Diellin

ARISTARKU (310-250 p.e.s.)	K. PTOLEMEU (shekulli II e.s.)	KUR'ANI (610-632 e.s.)	N. KOPERNIKU (1473-1547)
Toka lëviz	Toka nuk lëviz	Toka lëviz	Toka lëviz
Dielli nuk lëviz	Dielli lëviz rreth Tokës	Dielli lëviz	Dielli nuk lëviz

formimit shkencor tre personalitetet: Ptolemeun (shekulli II e.s.),

14. Kur'an (21/33), f. 373, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

15. Kur'an (13/2), f. 289, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

16. Kur'an (36/38, 40), f. 507, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

Në qoftë se mendojmë se Muhamedi është autor i Kur'anit, atëherë ai nuk ka gabuar. Ai është tepër i saktë, sepse thekson edhe lëvizjen e tokës edhe lëvizjen e Diellit. Atëherë, natyrshëm mund të pyesim se: A është e mundur që një njeri, i paarsimuar, që nuk është marrë me ndonjë studim fizik e astronomik, që njihite vetëm

arabishten në të folur, të arrijë në përfundime absolutisht të sakta, për çështje që kanë munduar njerëzimin për dhjetëra shekuj me radhë? A mund të pranohet që Muhamedi të jetë autor i Kur'anit, i librit që pasqyroi shumë saktë të vërtetën, në një kohë të karakterizuar nga teori të gabuara kozmologjike? Për të shpjeguar lehtë dhe kuptueshëm lëvizjen e Tokës, Kur'ani përdor referimin ndaj reve. Muhamedi dinte vetëm gjuhën arabe (në të folur). A e dinte ai se reve i është referuar edhe Ptolemeu rreth 500 vjet më parë? Besojmë se jo, sepse Almagest-i i Ptolemeut është përkthyer në gjuhën arabe në vitin 807 me urdhër të kalifit El Memun, pra afro 180 vite pas Muhamedit. Po ashtu, nga do ta dinte Muhamedi se të njëjtit objekt - reve, do t'i referohej edhe Koperniku 900 vjet më pas? Edhe kjo mundësi është paimagjinueshme për mendjen e njeriut! Kështu, s'mbetet rrugë tjetër, veçse të pranojmë që autor i Kur'anit nuk është as Muhamedi, e as ndonjë njeri tjetër i kohës së tij. Kur'ani është Libër i Zotit. Zoti e di të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ai di çdo gjë, edhe atë çka njerëzit kanë në mendje e zemër. Ai i jep dituri gjithsecilit, por më shumë atij që përpiket në rrugën e dijes. Zoti ia shpalli Kur'anin Muhamedit për të dëshmuar qartë të vërtetën.

Këto 2-3 shekujt e fundit është propaganduar me të madhe ideja se feja dhe shkenca janë në

antagonizëm me njëra-tjetrën. Këtë antagonizëm e reklamoi në mënyrë tejet të hiperbolizuar rryma filozofike materialiste-ateiste, me qëllim që të fitonte mbështetje sa më të madhe në qarqet shkencore, intelektuale dhe masat popullore. Materiali i trajtuar më sipër është një fakt më shumë që tregon se në librin bazë të besimit islam - Kur'anin, jo vetëm që nuk gjendet ndonjë kundërshti, por përputhja me shkencën moderne i tejkalon kufijtë e imagjinatës - si në kohë edhe në saktësi, aq sa të duket se shkenca e sotme kërkon argumente për të vërtetuar të vërtetat kuranore. Me siguri që me kohën do të shfaqen argumente të tjera. "Kur'ani është një mrekulli e përhershme dhe e përjetshme. Ai gjithmonë tregon mrekullinë e Tij. Ai kurrë nuk shuhet si mrekullitë e tjera. Koha e tij kurrë nuk mbaron. Përkundrazi, koha e tij shtrihet gjer në përjetësi."¹⁷ Bediuzzaman Said Nursi ("Mektubat")

"Ti je pa të meta. Ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti.

Vërtet, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti."¹⁸

17. Përmbledhja "Risale-i Nur" -"Letrat" Bediuzzaman Said Nursi, botimi shqip, f. 275.

18. Kur'an (2/32), f. 35, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

Referencat

- “Astronomia e re. Nikolla Koperniku”, përshtatur nga Mina Naqo, Tiranë, 1983.
Kur’ani Fisnik (Sherif Ahmeti, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, 1992).
Përmbledhja “Risale-i Nur” - “Letrat” Bediuzzaman Said Nursi, botimi shqip.
“Njëshmëria e Krijuesit”, Abdul Mexhid Ezzendani, Prishtinë, 1998.
“Mrekullitë e Kur’anit”, Harun Jahja, Alb-Books 2002.

Ibnu Maxheh dhe Suneni i tij

Dr. Sedat Islami, Kosovë

Abstrakt

Një nga dijetarët që ka zënë vend në historinë e shkencave islame është edhe Ibnu Maxheh. Kontributi i tij, megjithëse i shtrirë në disa fusha fetare, ka lënë gjurmë të thella në hadith. Ibnu Maxheh është autor i Sunenit, njërit prej gjashtë librave bazë të thënieve profetike apo haditheve siç njihen në terminologjinë përkatëse. Ky punim mëton të hedhë dritë mbi biografinë e autorit, në njëërën anë, dhe përshkrimin studimor të veprës së tij, në anën tjetër. Rëndësia e tij qëndron në faktin se lexuesin shqiptar e njeh ndoshta për herë të parë në këtë format me këtë kolos dije dhe këtë vepër madhështore.

Fjalët kyçe: *Ibnu Maxheh, Sunen, hadith, thënie profetike, dijetarë myslimanë.*

Rezime

Një nga dijetarët që ka zënë vend në historinë e shkencave islame është edhe Ibnu Maxheh. Kontributi i tij, megjithëse i shtrirë në disa fusha fetare, ka lënë gjurmë të thella në hadith. Ibnu Maxheh është autor i Sunenit, njërit prej gjashtë librave bazë të thënieve

profetike apo haditheve siç njihen në terminologjinë përkatëse. Ky punim mëton të hedhë dritë mbi biografinë e autorit, në njëërën anë, dhe përshkrimin studimor të veprës së tij, në anën tjetër. Rëndësia e tij qëndron në faktin se lexuesin shqiptar e njeh ndoshta për herë të parë në këtë format me këtë kolos dije dhe këtë vepër madhështore.

Hyrje

Hadithi prezanton korpusin e madh të fjalëve, veprave dhe miratimeve të Profetit (a.s.). Hadithi, si burim fetar, zë pozitë të lakmueshme në fe. Pas Kur'anit, vjen si burimi më kryesor për fenë. Madje, hadithi, si burim i fesë, është lloj tjetër i vahjit (shpalljes hyjnore).¹ Fjalët që ka thënë Profeti (a.s.) nuk janë fjalë të tij, janë shpallje. Këtë e ka sqaruar edhe Kur'ani. "Ai nuk flet sipas qejfit të vet, 4. por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij." (En-Nexhm: 3-4) Dhe këtu qëndron pikërisht arsyeja pse hadithi ose suneti shihet si sinonim i Kur'anit.²

Në fillim hadithet janë përcjellë në formë narracionesh dhe gojëdhënash nga njëri te tjetri për t'u standardizuar më pas me rregulla dhe kritere të cilat garantojnë transmetimin e saktë të tyre. Mbi bazën e këtyre rregullave dhe

1. Shih: Ibn Abdul Hadi, Abdul Mehdi bin Abdul Kadir. (2000) *El-med'bal ila-s-Sunneti-n-Nebevijeti – buhuthun fi-l-kadaja el-esasijeh an es-Sunneti en-Nebevijeti*. Ed. 2. Egjipt: Dar El-It'isam. F. 47.

2. Për këtë ka një hadith, të cilin Buhariu e shënon në Sahihun e tij. Në të thuhet se dikush ka kërkuar nga Profeti (a.s.) që të gjykojë me Librin e Allahut. Profeti (a.s.) gjykoj sipas tekstit, ndërsa gjykimin e tij e quajti gjykim me Librin e Zotit, duke aluduar në atë se nuk ka dallim në gjykim ndërmjet gjykimit me Kur'an dhe gjykimit me Sunet sepse që të dyja kanë burim Allahun. Shih: Ibn Abdul Hadi. (2000) *El-med'bal ila-s-Sunneti-n-Nebevijeti*. Ed. 2., f. 17.

kritereve hadithet janë kodifikuar në libra dhe koleksione, ndër të cilat, gjashtë janë si më kryesoret dhe më të rëndësishmet. Fjala është për Sahihët e Buhariut dhe Muslimit si dhe Sunenet e Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nesaiut dhe Ibnu Maxhes.

Duke iu referuar kësaj pozite, këto libra kanë gëzuar një tretman ndryshe nga librat dhe koleksionet tjera të hadithit. Përgjatë gjithë historisë islame (duke përfshirë dhe kohën tonë), ato kanë qenë objekt studimi të dijetarë dhe studiues të ndryshëm. Janë shpjeguar e komentuar, janë trajtuar nga këndvështrime të ndryshme shkencore e kritike, kanë qenë tema hulumtimi për punime magistraturash dhe doktoratash, dhe janë përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Ky punim³ mëton të hedhë dritë mbi njërin prej këtyre veprave bazë, Sunenin e Ibnu Maxhes. Për këtë jemi fokusuar në dy pika kryesore:

Kemi bërë një biografi të shkurtër por përmbledhëse të autorit, dhe e kemi trajtuar Sunenin nga aspekti deskriptiv dhe analitik. Pra, nuk jemi mjaftuar vetëm me përshkrimin e tij, por jemi marrë edhe me kritikën pro dhe kundër që është dhënë për këtë libër.

Për natyrën e tij punimi do të

3. Në fakt, ky punim është pjesë e shkëputur nga përkthimi dhe komentimi që autori është duke i bërë Parathënies së Sunenit të Ibnu Maxhes.

jetë në interes të lexuesve shqipfolës dhe do të ngjallë kureshtjen e tyre për t'u njohur edhe më shumë me thesarin tonë shkencor e akademik ndërsa personalisht e lus Allahun dhe i përgjërohem që të më falë për çdo gabim apo lëshim, profesional apo teknik qoftë.

1. Njoftim me Ibni Maxhen

1.1. Emri dhe prejardhja

Quhet *Ebu Abdullah Muhammed bin Jezid Ibnu Maxheb El Kazvini*.⁴ Njihet me emrin Ibnu Maxheh sipas ofiqit të babait të tij, Jezidit. Rrjedh nga Kishvini (në persisht) ose Kazvini (në arabisht).

Ka lindur në vitin 209 h. (824 g.) në Kazvin,⁵ qytet që sot gjendet

4. Shih: Edh-Dhehebi, Shemsuddin Ebu Abdullah Muhammed bin Ahmed bin Uthman bin Kajmaz. (1998) *Tedbkiretu-l-huffadh*. Bejrut: Dar el kutub el ilmijeh. 2/155; Ibn Hal-likan, Ebu-l-Abbas Shemsuddin Ahmed bin Muhammed bin Ibrahim bin Ebi Bekr. (1971) *Vefejat el-a'jân ve enbau ebunai-ç-çeman*. Verifikimi shkencor: Ihsan Abbas. Bejrut: Dar Sadir. 4/279; Ez Zerkeli, Hajruddin bin Mahmud bin Muhammed bin Ali bin Faris. (2002) *El A'lam*. Ed. 5. Bejrut: Dar el ilm li-l-melajin. 7/144.

5. Shih: Edh-Dhehebi. (1998) *Tedbkiretu-l-huffadh*. Op. cit. 2/155; Edh-Dhehebi, Shemsuddin Ebu Abdullah Muhammed bin Ahmed bin Uthman bin Kajmaz. (1985) *Sijer a'lam-i-n-nubela*. Verifikimi shkencor: Shuajbi Arnauti dhe të tjerë. Bejrut: Muessesetu-rrrisale. 13/277; Ibni Haxher El Askalani, Ahmed bin Ali bin Muhammed. (1326 h.) *Tehdbibu-t-tehdbib*. Indi: Matbaatu Daireti-l-Mearif en-nidhamijeh. 9/531; Ibn Tahir

100 milje në pjesën veriperëndimore të Teheranit. Në veri të tij ndodhet deti që ka marrë emrin sipas tij, Deti Kazvin. Qyteti është çliruar nga sahabiu i nderuar El Bera bin Azib në kohën e Uthman bin Affanit (r.a.) në vitin 24 sipas hixhretit.

1.2. Kërkimi i diturisë

Ibnu Maxheh ka lindur dhe është rritur në një familje të përkushtuar për dijen. Këtë më së miri e dëshmon fakti se nga familja e tij kanë dalë edhe bij të tjerë që janë dalluar për dijet fetare, si vëllezërit e tij Ebu Bekri, Ebu Abdullahu dhe Ebu Muhammedi. Sigurisht, një ambient i këllë është një mbështetje dhe motivim i madh për kërkimin e dijes. Ka qenë prej atyre që janë zgjeruar (përkushtuar shumë) në kërkimin e dijes.⁶ Ibnu Maxheh do të merrte rrugën për kërkimin e dijes në Rijj

El Makdisi, Ebu-l-Fadl Muhammed. (2000) *Shurutu-l-Eimmeti es-sitteti El Buhari ve Muslim ve Ebi Davud ve-t-Tirmidhij ve-n-Nesaij ve Ibnu Maxheb*. Bejrut: Dar el kutub el ilmijeh. F. 25; Mes'ij. (2008) *El-med'hal ila Sunen Ibnu Maxheb*. Op. cit., f. 21.

Ka edhe mendime të tjera për vitin e lindjes së tij, si ai i Dr. Ebu Xhemil El Hasen El Alemijj i cili mendon se ka lindur në vitin 207. Shih: El Ilemijj, Ebu Xhemil El Hasen. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith ve menabixhu et tasnifi inde-l-muhaddithine*. Publikuar nga: www.islamicwest.org f. 126; El Haseni, Muhammed bin Sejjid El Alevi El Maliki. (1990) *El menbel el-letif fi usuli el badithi esb sherif*. P.v.b.: p.sh.b. f. 305.

6. Mes'ij. (2008) *El-med'hal ila Sunen Ibnu Maxheb*. Op. cit., f. 23.

(Ray, Iran), Nisabur (Nishapur, Iran), Irak, Sham, Egjipt dhe Hixhaz (më saktë Mekë dhe Medinë).⁷ Sipas asaj që kanë llogaritur disa biografë, Ibnu Maxheh ka marrë dije nga 310 dijetarë.⁸

1.3. Veprimtaria e Ibnu Maxhes

Ibnu Maxheh, përveç mësimdhënies, u angazhua edhe me shkrieme. Shkoi disa vepra madhore, ndër të cilat edhe Suneni. Më konkretisht, shkoi tre vepra:

Tefsir (komentar) i Kur'anit, i cili, për fat të keq, nuk i mbijetoi kohës. Ka gjasa që të ketë qenë viktimë e shkatërrimeve të Timurlenkut në Damask, ngase dijetarë, si Dhehebiu dhe Ibni Kethtiri, thonë ta kenë patur në dorë.⁹

Sunenin, për të cilin do të bëjmë fjalë pak më gjerësisht në këtë hyrje, dhe *Et Tarib* (Historia), vepër në të cilën ka përmbledhur histori personalitetesh e vendesh që nga koha e Sahabeve (r.a.) e deri në kohën e tij.¹⁰

7. Ibn Hal-likan. (1971) *Vefejat el-a'ján*. Verifikimi shkencor: Ihsan Abbas. Op. cit. 4/279.

8. Muhammed bin Reshid Nu'mani në librin e tij në urdu ka numëruar deri në 310, ndërsa vetëm nga Suneni, Shejh Shuajbi ka numëruar 303 hoxhallarë prej të cilëve ka marrë dije Ibnu Maxheh. Shih: Ibn Maxheh, Muhammed bin Jezid. (2009) *Sunen Ibn Maxheb*. Verifikimi shkencor: Shuajb Arnauti dhe të tjerë. Bejrut: Dar er-risale el-alemijeh. 1/13.

9. Ibnu Maxheh. (2009) *Sunen Ibn Maxheb*. Op. cit. 1/20.

10. Shih: Ibn Tahir El Makdisi. (2000)

Një libër tjetër që i atribuohet Ibnu Maxhes është edhe *Tarihu-l-Hulefa* (Historia e Halifëve).¹¹ Libri është botuar në vitin 1979 nga Akademia e Gjuhës Arabe në Damask me verifikim shkencor të hoxhës Muhammed Mutië. Ky libër nuk është përmendur në shumicën e burimeve të biografisë së Ibnu Maxhes. Hoxha Es'ad Tejmi në librin *Ilm tabekah el-muhaddithine* mohon që ky libër të jetë i Ibnu Maxhes. Ai akuzon kontrollorin shkencor se ia ka atribuar librin Ibnu Maxhes pasi sipas tij në këtë gjeneratë (ar. tabekah) të hadithologëve nuk ka tjetër që ka emrin Muhammed bin Jezid. Ky argument është jo i saktë. Më pas sjell dëshmi që provojnë se libri nuk është i Ibnu Maxhes. Fjala është për disa transmetues, si Abbad bin Abbad, i cili ka vdekur në vitin 180 h., dhe Hejthem bin Abdijj, që ka vdekur në vitin 207 h., ndërsa Ibnu Maxheh ka lindur në vitin 209 h., ose 29 vite pas vdekjes së Abbadit dhe dy vite pas vdekjes së Hejthemit. Hoxha Es'ad Tejmi mendon se autor i librit është Muhammed bin Jezidi nga Kufa, mësuesi i Buhariut.¹²

Shurutu-l-Eimmeti es-sitteti. Op. cit., f.25; Edh-Dhehebi. (1985) *Sijer a'lami-n-nubela*. Op. cit. 13/277; Ez Zerkeli. (2002) *El Alam*. Ed. 5. Op. cit. 7/144; Hashim, Ahmed Umer. (2000) *Mebahith fi-l-hadithi-sh-sherif*. Kajro: Mektebetu-sh-shuruk, f. 58.

11. Shih: El Ilemij. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith*. Op. Cit., f. 126.

12. Shih: Tejmi, Es'ad Salim. (1994) *Ilmu tabekah el-muhaddithine – ebemmijjetubu ve fevaid*.

1.4. Për personalitetin e Ibnu Maxhes

Ibnu Maxheh ka gëzuar famë dhe autoritet të madh. E kanë vlerësuar dijetarë të shumtë. Ibn Abdul Hadi e vlerëson si dijetar të madh e thotë: ‘*Është hafidhi³ i madh, komentuesi i Kur’anit...*’¹⁴

Ibnu Kethiri, duke folur për personalitetin e tij, nuk kursehet nga lavdet ndërsa duke iu referuar librit dhe përmbajtjes së tij thotë se ajo e dëshmon diturinë dhe

fetarinë e tij – mbajtjen për Sunetin në çdo gjë.¹⁵ Ibnu Hal-likani duke folur për të thotë: ‘*Është hafidhi i njohur, ka qenë imam¹⁶ në hadith, njohës i shkencave të hadithit dhe gjërave që lidhen me të.*’¹⁷ Ibnul Ethiri ndan po kështu fjalë miradije e thotë: ‘*Ka qenë i mençur, imam dhe dijetar.*’¹⁸ Ibn Abdul Hadi e përshkruan me këto fjalë personalitetin e Ibnu Maxhes: ‘*Hafidhi i madh, komentuesi Ebu Abdullah Kazvini.*’¹⁹ Ka thënë po kështu: ‘*Ka qenë Ibnu Maxheh hafidh, kritik i sinqertë dhe (dijetar) me dije të gjerë.*’ Hafidh Mizzi e përshkruan si autor të Sunenit dhe të librave tjerë të dobishëm²⁰, ndërsa Dhehebiu e përshkruan si dijetar të cilit i referohet.²¹

Rijad: Mektebetu-rr-rushd, f. 64.

13. Titulli ‘*Hafidh*’ është një titull i veçantë për hadithologët. Ai i jepet dijetarit që njeh sunetet e të Dërguarit të All-llahut (a.s.), që ka dituri për rrugët e transmetimit të tyre, që ka aftësinë e dallimit të seneleve – vargut të transmetuese të tyre, që ka memorizuar atë sasi hadithesh për saktësinë e të cilave dijetarët janë unanimitë dhe për të cilat kanë polemizuar. Ibnu Haxheri ka përmendur tre kushte themelore për të fituar këtë titull: të jetë i njohur për kërkimin dhe marrjen e haditheve nga dijetarët, jo nga librat; të ketë njohuri për gjeneratat e transmetuesve dhe rangjet e tyre, si dhe të ketë njohuri për xherhin dhe ta’dilin (kriteret e vlerësimit të transmetuesve), për dallimin e hadithit të saktë nga të pasaktët, si dhe, përveç që duhet të ketë mundësinë e përkujtimit të shumë teksteve, të jetë në gjendje që, hadithet, që i sjell ndërmend (i di përmendësh), të jenë më shumë se ato që nuk i kujtohen. Shih: El-Gavri, Sejjid Abdul Mexhid. (2007) *Mu’xhem el-mustalabat el-hadithijeh*. Damask-Bejrut: Dar Ibni Kethir, f. 297; 298.

14. Ibn Abdul Hadi, Muhammed bin Ahmed. (1996) *Tabekat Ulemai-l-Hadith*. Verifikimi shkencor: Ekrem El-Bushi dhe Ibrahim Ez-Zejbek. D. 2. Bejrut: Muessesetu-rr-risale. 2/341.

15. Ibnu Kethir, Ebu-l-Fida Ismail bin Umer. (1986) *El bidaje ve-n-nibaje*. Damask: Dar el fikr. 11/52.

16. Titulli ‘Imam’ te hadithologët i jepet dijetarit, i cili pasohet në fushën e Hadithit. Shih: El-Gavri. (2007) *Mu’xhem el-mustalabat el-hadithijeh*. Op. cit., f. 160..

17. Ibn Hal-likan. (1971) *Vefejat el-a’jân*. Verifikimi shkencor: Ihsan Abbas. Op. cit. 4/279.

18. Ibnul Ethir, Ebu-l-Hasen Ali bin Ebi-l-Kerem. (1997) *El kamil fi-t-tarih*. Verifikimi shkencor: Umer Abdus Selam Tedmuri. Bejrut: Dar el kitab el arabijj. 6/436.

19. Ibn Abdul Hadi. (1996) *Tabekat ulemai-l-hadith*. Ed. 2. Op. cit. 2/341.

20. El-Mizzi, Jusuf bin AbduRrahman bin Jusuf. (1980) *Tebdibu-l-kemal fi esmai-rr-rixhal*. Verifikimi shkencor: Besh-shar Avad Ma’ruf. Bejrut: Muessesetu-rr-risaleh. 27/40.

21. Edh-Dhehebi. (1985) *Sijer a’lami-n-nubela*. Op. cit. 13/277.

1.5. Vdekja

Ibnu Maxheh ka vdekur më 22 ramazan 273 h., (887 g.).²² Ky mendim merret si më i sakti ndryshe ka mendime se ka vdekur në vitin 275 h.²³

2. Suneni i Ibnu Maxhes

2.1. Rreth Sunenit të Ibnu Maxhes

Suneni është njëri ndër tre librat që ka shkruar Ibnu Maxhe, falë të cilit, pas suksesit dhe bekimit prej Allahut, ka arritur të hyjë në historinë e dijetarëve myslimanë.²⁴

Sunenet janë libra, të cilat radhitjen dhe sistemimin e haditheve e bëjnë sipas kapitujve të fikhut.²⁵ Suneni i Ibnu Maxhes, i cili quhet ‘Sunen El Mustafa (a.s.)’²⁶ (apo edhe Musned por më pak njihet me këtë emër²⁷), përveç këtyre kapitujve,

22. Ibni Kethir. (1986) *El bidaje ve-n-nibaje*. Op. cit. 11/52; Ibn Hal-likan. (1971) *Vefejat el-a’jan*. Op. cit. 4/279; En-Nu’mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es-Sunen*. Op. cit., f. 175.

23. Shih: Ibni Haxher El Askalani. (1326 h.) *Tebdhibu-t-tebdhib*. Op. cit. 9/531.

24. Shih: Ebu Shehbeh, Muhammed Muhammed. (1995) *Fi ribabi-s-Sunneti – El-kutubu es-sibabu es-sittetu*. Kajro: Mexhmeu-l-buhuth el-islamijeh, f. 174.

25. Shih: Kattan, Menna’. (1987) *Mebabith fi Ulumi-l-Hadith*. Kajro: Mektebetu Vehbeh, f. 36; El Gavri, Sejjid Abdul Maxhid. (2009) *El-vexhib fi ta’rifi kutubi-l-hadith*. Damask-Bejrut: Dar Ibn Kethir, f. 21.

26. Shih: El Hajr Abadi, Muhammed Ebu-l-Lejth. (2011) *Utum el hadith esiluba ve musairuba*. Malajzi: Dar Shakir, f. 78.

27. Shih: Mes’ij. (2008) *El-med’hal ila Sunen*

ka përfshirë dhe kapituj të tjerë që bëjnë fjalë për sprovat (e kohës së fundit ose ar. *El fiten*), asketizmin (ar. *Ez zuhd*). Po kështu, librit i ka bërë një parathënie, të cilin e ka ndarë në kapituj, ku ka folur për sunetin, akiden (kredon, besimin), dijen dhe çështje që kanë të bëjnë me të.²⁸ Disa studiues sunenin, për shkak të kësaj përmbajtjeje, e shohin më afër *xhevamiëve* (Sahihut të Buhariut, Muslimit, etj) sesa suneneve.²⁹

Në llogaritjen e Muhammed Fuad Abdul Baki, Suneni i Ibnu Maxhes ka 4341 hadithe.

Për herë të parë, Suneni i Ibnu Maxhes ka filluar të llogaritet si njëri prej gjashtë librave të saktë të hadithit³⁰ nga dijetari Ebu-l-Fadl Ibn Tahir në librin e tij *Atraf el kutub es-sitte* dhe *Shurua el cimmeti es-sitteti* dhe më pas nga Abdul Gani Makdisiu në librin e tij *El kemal fi a’ mali-rr-rrixhal*.³¹

Ibnu Maxheb. Op. cit., f. 44.

28. Shih: Esh Shemali, Jasir. (1998) *Menabixh el muhaddithine*. Jordani: Universiteti Jordanez, f. 225.

29. Shih: El Ilemijj. (2005) *Ummebatu kutubi-l-hadith*. Op. cit., f.127. Në këtë mbase mund të aludojë edhe thënia e Ibni Haxherit për Sunenin: “...është një *xhami*’ [përmbledhës] i mirë.”. Shih: Ibni Haxher El Askalani. (1326 h.) *Tebdhibu-t-tebdhib*. Op. cit. 9/531.

30. Këta libra janë: (1) Sahihu i Buhariut, (2) Sahihu i Muslimit, (3) Suneni i Ebu Davudit, (4) Suneni i Tirmidhiut, (5) Suneni i Nesaiut, (6) Suneni i Ibnu Maxhes.

31. Shih: Haxhi Halifeh, Mustafa bin Abdullah. (1941) *Keshfu-db-dnunun an esami el-kutub ve-l-funun*. Bagdad: Mektebetu el-muthenna. 1/81; 2/1473.

Suneni është transmetuar nëpërmjet disa nxënësve të tij, si: *Ebu-l-Hasen Kattani, Muhammed bin Isa El Ebberijj Ebu Bekir dhe Sulejman bin Jezid el Kazvini*.³²

2.2. Metodologjia e Ibnu Maxhes në Sunen

Metodologjia që Ibnu Maxheh ka ndjekur në Sunenin e tij dallon prej metodologjive të autorëve të pesë librave të tjerë të hadithit. Ndryshe prej tyre, Ibnu Maxhe nuk ka vënë kritere të forta për pranimin e haditheve. Si pasojë, libri ka shumë hadithe të dobëta, në mesin e të cilave edhe të trilluara (meuduah). Ibn El Xheuzijj numëron 34 (tridhjetekatër) hadithe të trilluara ndërsa tek Albani kjo shifër ngritet në 39 (tridhjetenëntë) hadithe.³³

Zakonisht nuk përmend dobësitë e haditheve. I sjell ato ashtu siç janë pa aluduar se janë të këtilla ose atilla. Këtë e bën fare pak.

Ibnu Maxheh përmend shumë pak ose aspak thënie të sahabeve (r.a.) dhe tabiinëve (r.a.).

Nuk përsërit hadithet brenda të njëjtit kapitull. Ai, në fakt, ka ndjekur rrugën e shkurtimit sa i përket haditheve. Ka sjellë rrugët e transmetimit të haditheve në një vend dhe nuk i ka përsëritur në vendin tjetër. Versionin e shkurtuar

të rrugëve të transmetimit e aplikon në këtë mënyrë:

Lidhjen ndërmjet transmetuesve e bën me pjesën lidhëse ‘dhe’ dhe jo me shprehjen ‘na ka treguar’ (ar. *baddethena*).

Në rast se dy rrugë transmetimi takohen te një transmetues atëherë ai bën shkurtimin e rrugës së dytë, gjegjësisht pjesë të saj deri tek transmetuesi në fjalë, për të vazhduar me pjesën tjetër ku ndryshon nga rruga ose mënyra e parë e transmetimit. Këtë e bën nëpërmjet transferimit (ar. *tabvii*) për çka simbolizon me shkronjën ‘h’ (ar. ح).

Në rast të përsëritjes së *senedit* (vargut të transmetuesve) ose *metnit* (tekstit) të hadithit, Ibnu Maxheh përmend një pjesë të tyre ndërsa për pjesën tjetër vetëm aludon. Pra nuk e përmend përsëritjen e plotë as të *senedit* dhe as të *metnit*.

Ndonjëherë ka dhënë shënime për domethëniet e fjalëve të panjohura të haditheve e ndonjëherë jo. Po kështu, në raste të caktuara, ka dhënë shpjegime edhe për vetë domethënien e hadithit, e cila nuk ka qenë krejtësisht e qartë nga teksti.

Ka paraprirë përmendjen e hadithit të abroguar ndaj atij abrogues dhe nuk e ka sinjalizuar këtë fare.

Për shkak të mos vënies së kushteve për pranimin e hadithit, nuk i është përmbajtur (të paktën jo gjithmonë) ndonjë rregull për

32. Shih: El Ilemij. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 129.

33. Shih: Esh Shemali. (1998) *Menahixh el mubaddithine*. Op. cit., f. 225.

të vënë së pari hadithet e sakta pastaj ato më pak të sakta. Ndodh që brenda kapitullit të ketë vetëm një hadith dhe ai të jetë i dobët (siç do të shohim gjatë shpjegimit të Parathënies).

Në përpilimin e titujve të kapitujve ka ndjekur metodologjinë:

e vënies së titujve të qartë, që nënkupton se titulli drejtpërdrejtë aludon domethënien e kapitullit dhe jo se lexuesi ka nevojë që të meditojë rreth asaj se çfarë synohet me të në kapitullin përkatës.

Ka vënë edhe tituj jo të drejtpërdrejtë por që më pas janë përkufizuar nga hadithet që ka sjellë në kapitull.³⁴

2.3. Kritika për Sunenin e Ibnu Maxhes

Ibnu Maxheh ka transmetuar prej atyre që jo vetëm janë vlerësuar nga hadithologët si transmetues të dobët, por edhe të akuzuar për gënjeshtria dhe vjedhje të haditheve.³⁵ Kjo metodologji e tij është kritikuar nga dijetarët. Ibnul Ethiri ka thënë:

34. Shih artikullin “*El-menabixh el-hassab li-l-muhaddithine – Menbexhu El-Imami Ibnu Maxheb*” të punuar nga Grupi Shkencor i portalit të mirënjohur islam, www.islamweb.net. Materiali është ngarkuar me datë 10.8.2011, ndërsa është shfletuar më datë 7.2.2016.

(<http://articles.islamweb.net/media/index.php?page=article&lang=A&id=168943#docu>).

35. Mes’ij. (2008) *El-med’hal ila Sunen Ibnu Maxheb*. Op. cit., f. 74.

*Libri i tij është i dobishëm dhe me interes të fortë në fikh, por ka hadithe shumë të dobëta dhe të tjera të urryera (munker)*³⁶.

Hafidh Mizzi mendon se shumica e haditheve me të cilat është veçuar Ibnu Maxheh nga pesë librat e tjerë janë të dobëta.³⁷ Për shkak të saj, siç thotë Dhehebiu, librit i ka rënë vlera.³⁸

Dijetarët janë pothuaj unanimitas sa i përket asaj se, të paktën, ky libër është nën vlerën e pesë librave të tjerë.³⁹ Ndoshta kjo ka bërë që dijetarët e gjeneratave të mëhershme dhe të sotme⁴⁰ e kanë marrë me rezervë. Imam Neveviu nuk e ka llogaritur fare si libër të gjashtë në

36. Hadithi ‘*munker*’ është ai që përcillet nga një transmetues i dobët që bie në kundërshtim apo kundërtënie me transmetuesit besnikë. Shih: Shakir, Ahmed Muhammed. (2003) *El-baithu-l-hathith sherhu Ibtisari ulumi-l-hadith*. Kuvajt: Xhem’ijjetu Ihjai et-turath el-islamij, f. 67.

37. Shih: Ibni Haxher El Askalani. (1326 h.) *Tebdhibu-t-tehdhib*. Op. cit. 9/531. Siç do të shohim pak më poshtë, kjo thënie është e ekzagjeruar, ndryshe nga një pjesë goxha e madhe e tyre janë autentike.

38. Edh-Dhehebi. (1985) *Sijer a’lami-n-nubela*. Op. cit. 13/279; Edh-Dhehebi, Shemsuddin Ebu Abdullah Muhammed bin Ahmed bin Uthman bin Kajmaz. (1963) *Mizanu-l-’idal fi nakdi-rr-rixbal*. Verifikimi shkencor: Ali Muhammed El Bexhavi. 2/20.

39. Shih: En-Nu’mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabuhu Es-Sunen*. Op. cit., f. 187.

40. Dijetari Muhammed bin Salih El Uthejmin thotë se ky libër nuk është në një vijë vlerësimi me librat e tjerë. Shih: El Uthejmin, Muhammed bin Salih. (1424 h.) *Mustalabu-l-Hadith*. Demmam (MAS): Dar Ibn El Xheuzijj, F. 82.

këtë koleksion të përmbledhjeve të sakta të haditheve,⁴¹ derisa të tjerë në vend të tij e kanë llogaritur Sunenin e Darimiut apo Muvettanë e Imam Malikut.⁴² Së këndejmi, thënia e Ebu Zur'as⁴³ për Sunenin se kinse ka shumë pak hadithe daife (të dobëta)⁴⁴ është marrë me rezerva (dysohet ta ketë thënë ai),⁴⁵ ngase hadithet e pasakta janë afër shifrës njëmijë.⁴⁶

Megjithëkëtë, Suneni ka edhe aspektet pozitive.

Ebu Zur'ah e shihte si një ndër librat më të mirë të haditheve ose më të mirë se shumicën e librave të hadithit. Ebu-l-Kasim Rafiu thoshte se huffadhët Sunenin e Ibnu Maxhes e krahasojnë me dy sahihët (Buhariun dhe Muslimin), sunenet e Ebu Davudit dhe Nesaiut, si dhe argumentojnë me hadithet e tij.⁴⁷

Ai ka marrë lëvdata sa i përket

41. Shih: Es-Sujuti, Xhelaluddin AbduRrahman. (1972) *Tedrib err-rravi fi sherhi Takrib En Nevavi*. Verifikimi shkencor: Abdul Vehhab Abdul Latif. Kajro: Mektebetu Dar Et-turath. F. 1/104.

42. Hashim. (2000) *Mebabith fi-l-hadithi-sh-sberif*. Op. cit., f. 61.

43. Shih: Edh-Dhehebi. (1998) *Tedbkiretu-l-huffadh*. Op. cit. 2/155.

44. Hadithi daif (i dobët) është hadithi në të cilin nuk qëndrojnë tiparet dhe cilësitë e hadithit *sahib* dhe as të atij *basen*. (Shih fusnotat: 55-56).

45. Edh-Dhehebi. (1985) *Sijer a'lami-n-nubela*. Op. cit. 13/279.

46. Shih: El Ilemij. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 129.

47. Shih: En-Nu'mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabuhu Es-Sunen*. Op. cit., f. 177.

strukturimit dhe sistemimit perfekt të kapitujve dhe nënkapitujve.⁴⁸ Ka emëruar kapitujt e librit me tituj që janë të shkurtër, por kuptimplotë.⁴⁹ Suneni ka 37 libra me gjithsej 1515 kapituj.⁵⁰ Mbase ky mund të jetë dhe shkaku që dijetarët e kanë llogaritur si librin e gjashtë, ngase Dr. Mustafa Sibai thotë se për shkak të vlerave që ka në fikh,⁵¹ e që në këtë rast nuk mund të interpretohet ndryshe vetëm se në bazë të këtyre nënkapitujve dhe haditheve shtesë që ka sjellë në krahasim me pesë librat e tjerë, siç do të përmendim në pikën në vazhdim.

Suneni po kështu ka merita për hadithet të cilat nuk janë në pesë librat e tjerë,⁵² afërsisht 1339 (njëmijetreqindetridhjetenëntë) hadithe.⁵³ Këto hadithe, siç përmendim disa studiues, kanë bërë që ai të jetë në listën e gjashtë librave, e jo Muvetta i Imam Malikut.⁵⁴

48. Shih: Esh Shemali. (1998) *Menabixh el mubaddithine*. Op. cit., f.228.; En-Nu'mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabuhu Es-Sunen*. Op. cit., f.120.

49. Mes'ij. (2008) *El-med'hal ila Sunen Ibnu Maxheb*. Op. cit., f. 46.

50. Shih: El Ilemij. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 127.

51. Shih: Sibai, Mustafa. (2003) *Es-Sunnetu ve mekanetuba fi-t-tesbri'-l-islamij*. Bejrut: Dar el-verr-rrak, f. 493.

52. Shih: El Hajr Abadi. (2011) *Ulum el hadith esiluba ve musairuba*. Op. cit., f. 78.

53. Shih: Mes'ij. (2008) *El-med'hal ila Sunen Ibnu Maxheb*. Op. cit., f.46.; El Uthejmin. (1424 h.) *Mustalabu-l-Hadith*. Op. cit., f. 82.

54. Shih: Abdulmuttalib, Rif'at Fevzi. (2008)

Prej këtyre haditheve:

428 (katërqindënjëzetetë) janë sahiha (autentike),⁵⁵

199 (njëqindënëntëdhjetenëntë) janë hasen⁵⁶, dhe

613 (gjashtëqindetrembëdhjetë)⁵⁷ janë daife, të urryera (munker) dhe të rreme (të trilluara - meuduah).⁵⁸

Siç mund të vërehet, nga kalkulimi i mësipërm janë vetëm 1240 hadithe. Kjo ngase Ahmed Umer Hashim (autori të cilit i jemi referuar) është mbështetur te Muhammed Fuad Abdul Baki⁵⁹, ndërsa me gjasë

El-Med'hal ıla menabih el-muhaddithine – el-usus ve-t-tatbiq. Kajro: Dar Es-salam, f. 266.

55. Hadithi *sahih* është hadithi, transmetuesit e të cilit janë të besueshëm e të përpiktë dhe që nuk e karakterizojnë kundërthënie ndërmjet transmetuesve (ar. *shudbudh – kundërthënia ose mospajtimi ndërmjet transmetimit të transmetuesit të besueshëm me transmetimin atij që është më i besueshëm*) dhe as dobësi (ar. *el il-letu*), e cila afekton saktësinë e hadithit. Shih: Shakir. (2003) *El-baithu-l-hadith*. Op. cit., f. 30.

56. Hadithi *hasen* është hadithi, vargu i transmetuesve të të cilit është i lidhur ndërsa transmetuesit janë të drejtë, por jo në nivel të lartë të përpikërisë. Pra, është nën gradën e hadithit sahih. Shih: Tahhan, Mahmud. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Kuvajt: Mektebetu Dar Et-turath, f. 46.

57. Hashim. (2000) *Mebabith fi-l-hadithi-sh-sberif*. Op. cit., f. 59.

58. Hadithi *meuduë* ose i shpifur është hadithi, transmetuesi i të cilit akuzohet për fabrikim hadithesh dhe shpifje ndaj Profetit (a.s.). Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 89.

59. Ibnu Maxheh, Muhammed bin Jezid. (p.v.b.) *Sunen Ibnu Maxheh*. Verifikimi shkencor: Muhammed Fuad Abdul Baki.

gabimisht i ka ikur edhe përmendja e 99 (nëntëdhjetenëntë) haditheve të cilat ky i fundit i cilëson si të urryera (munker) dhe të shpifura. Në fakt, ai i ka përmendur si normë, por jo edhe si shifër.

Shuajb Arnauti ka bërë një kalkulim tjetër. Ai thotë se bazuar në punën e tyre shumë profesionale që kanë bërë në verifikimin e këtij libri, del se hadithet me të cilat është veçuar Ibnu Maxheh prej pesë librave të tjerë janë 1213 (njëmijedyqindetrembëdhjetë) hadithe, prej të cilave:

98 (nëntëdhjetetë) hadithe janë me sened autentik,

113 (njëqindetrembëdhjetë) janë autentike për shkak të haditheve *mutabiiat*⁶⁰

219 (dyqindënëntëmbëdhjetë) ngriten në autentike me dëshmi,

58 (pesëdhjetetë) janë me senede hasen,

42 (dyzetedy) janë hasen me *mutabiiate*,

65 (gjashtëdhjetepesë) janë hasen me dëshmi (shevahid),⁶¹

Kajro: Dar ihja el kutub el arabijeh. 2/1519-1520.

60. *Mutabiiat* janë hadithet, transmetuesit e të cilave ndajnë me transmetuesit e hadithit të (menduar për të) vetëm (rrallë, transmetuar vetëm nga një njeri) të njëjtin hadith, qoftë në domethënie, qoftë në tekst, por që përputhen gjithsesi tek Sahabiu (transmetuesi i parë nga Profeti [sal-la-All-llahu alejhi ve sel-lem]). Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 141.

61. Shevahid janë hadithet transmetuesit e të cilave ndajnë me transmetuesit e hadithit të

6 (gjashtë) janë me mundësi të të qenit *hasen*,⁷ (shtatë) i ka sjellë si *merfuud*⁶² ndërsa ne - thotë Shejh Shuajbi - i kemi vlerësuar si autentike, por si *menkufeh*,⁶³

4 (katër) janë hadithe *mursel*⁶⁴,

384 (treqindetëdhjetekatër) janë të dobëta,

184 (njëqindetëdhjetekatër) janë shumë të dobëta,

1 (një) hadith është *shadb-dif*⁶⁵

21 (njëzetënjë) hadithe janë *munker* dhe të shpifura (meuduah)⁶⁶,

(menduar për të) vetëm (rrallë, transmetuar vetëm nga një njeri) të njëjtin hadith, qoftë në domethënie dhe tekst, qoftë vetëm në domethënie, por që nuk përputhen tek Sahabiu (pra, e transmetojnë hadithin nga Sahabijë të ndryshëm). Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 141.

62. *Merfuaah* janë hadithet që i atribuohen Profetit a.s., fjalë, vepra, miratime apo cilësi (tipare) qofshin. Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 128-129.

63. *Menkufeh* janë hadithet që i atribuohen Sahabeve, fjalë, vepra apo miratime qofshin. Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 130.

64. Hadithi *mursel* është hadithi të cilin tabiini e transmeton nga Profeti [sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem] pa përmendur fare Sahabiun. Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 71.

65. *Shadb* janë hadithet, transmetuesi i pranuar (besnik, i drejt) i të cilave transmeton diç që vjen ndesh me transmetuesit që kanë më shumë përparësi se ai (qoftë me nivel më të lartë të saktësisë, drejtësisë dhe korrektësisë, qoftë me kritere tjera të vlerësimit të një hadithi ndaj tjetrit). Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 117.

66. Meuduah janë hadithet që rrejshëm i atribuohen Profetit [sal-laAll-llahu alejhi ve sel-lem]. Shih: Tahhan. (1984) *Tejsiru mustalabi-l-hadith*. Op. cit., f. 89.

dhe 11 (njëmbëdhjetë) hadithe që nuk iu kemi dhënë normë të prerë.

Nga kjo del se hadithet e sakta (sahihah dhe haseneh) janë afërsisht 600 (gjashtëqind) hadithe ose gati gjysma e haditheve me të cilat është veçuar Ibnu Maxheh. Kjo - thotë Shejh Shuajbi - demanton thënien se shumica e haditheve me të cilat është veçuar Ibnu Maxheh janë të dobëta.⁶⁷

Ka bërë përsëritjen e haditheve brenda një kapitulli për të shpjeguar dobi të senedit (vargut të transmetuesve të hadithit) dhe shtesave të teksteve të haditheve, si dhe për të forcuar me dëshmi (transmetime) hadithin në senedin e të cilit ka dobësi.

Nuk ka përmendur fare hadithe *menkufeh* dhe *maktuah* (thënie të sahabeve dhe fetva të tabiineve).⁶⁸

Në disa hadithe, për shkak të udhëtimeve të tij të shumta për kërkimin e dijes, ka bërë një ngritje në sened, duke mos pasur ndërmjet tij dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.) më shumë se tre veta. Disa hadithologë i kanë mbledhur këto hadithe në një vëllim, por shumica e tyre janë nga transmetues të papranuar, pra janë të dobëta. Madje në mesin e tyre ka dhe një hadith të shpifur që flet për (kinse) vlerën e Kazvinit.⁶⁹

67. Ibn Maxheh. (2009) *Sunen Ibn Maxbeh*. Op. cit. 1/26-27.

68. Shih: En-Nu'mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxbeh ve kitabuhu Es-Sunen*. Op. cit., f.120; Mes'ij. (2008) *El-med'hal ila Sunen Ibnu Maxbeh*. Op. cit., f. 47.

69. Shih: El Ilemijj. (2005) *Ummehatu kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 128.

2.4. Komentare të Sunenit të Ibnu Maxhes dhe punime rreth tij

Suneni i Ibnu Maxhes ka gëzuar dhe vazhdon të gëzojë respekt të veçantë. Ai ka qenë objekt studimi për dijetarë të shumtë. Disa janë përkujdesur për të shpjeguar domethëniet e haditheve ndërsa të tjerë kanë trajtuar aspekte të ndryshme të tij nga këndvështrimi i shkencor i hadithit. Në vazhdim do të prezantojmë disa prej këtyre punimeve:

Abdu-l-Latif Bagdadiu ka shkruar një komentari të gjerë të Sunenit. Ai është përmendur në El erbeune et-tibbijeh të Birzalit. Është botuar për herë të parë në Marok, pastaj në Bejrut më 1405 h.⁷⁰

El erbeune et-tibbijeh të Birzalit, i cili nga libri paraprak ka nxjerrë dyzet hadithe me komentimin e tyre. Hadithet kanë të bëjnë me fushën e mjekësisë.⁷¹

Imami Alauddin Mugultaj ka shpjeguar në një vëllim një pjesë të haditheve, të cilin e ka quajtur *‘El Ilamu bi-Sunnetibi alejbisselam.’*⁷²

Siraxhuddin Umer bin Ali bin Mulekkini ka komentuar shtesat e

Sunenit në tetë vëllime, të cilat i ka titulluar *‘Ma temessu ilejbi el-baxhetu ala Suneni Ibnu Maxheb.’*⁷³

Muhammed bin Musa bin Isa bin Ali Ebu-l-Beka Ed Demirijj ka bërë komentimin e Sunenit në pesë vëllime, por nuk e ka kompletuar. E ka titulluar *‘Ed dibaxhetu fi sberbi Suneni Ibnu Maxheb.’*⁷⁴

Busajri ka përmbledhur në një vëllim të gjitha hadithet me të cilat është veçuar Ibnu Maxheb nga pesë librat e tjerë. Punimin e tij e ka titulluar *‘Misbabu-ç-çuxbaxheti fi çevaidi Ibnu Maxheb.’* Është botuar në Bejrut (1402 h.) dhe Kajro (1403 h.).⁷⁵

Ibrahim bin Muhammed bin Halil, i njohur si Sibt Ibn Axhemi, i ka bërë disa shënime dhe shpjegime Sunenit.⁷⁶

Muhammed bin Muhammed bin Muhammed Shemsuddin El Misriij ka bërë një version të shkurtuar të Sunenit të cilin e ka emërtuar *‘El gujuth eth-thexb-xbaxheb fi muhtesari Ibnu Maxheb’*, të cilin më pas e ka komentuar dhe e ka titulluar *‘Ed dibaxhetu li-teudibi muntehabi Ibnu Maxheb.’*

Sujuti i ka bërë disa shënime haditheve të Sunenit të cilat i ka

70. Shih: El Gavri. (2009) *El-veçbiç fi ta’rifi kutubi-l-hadith*. Op. cit., f.335; Shih: En-Nu’mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es-Sunen*. Op. cit., f. 231.

71. Shih: En-Nu’mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es-Sunen*. Op. cit., f. 234.

72. Libri nuk është komentuar në tërësi. Shih: El Gavri. (2009) *El-veçbiç fi ta’rifi kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 335.

73. Është ende në dorëshkrim. Shih: Ibid. Op. cit., f. 335.

74. Nuk e ka kompletuar. Libri është ende në dorëshkrim. Shih: Ibid. Op. cit., f. 335.

75. Shih: El Gavri. (2009) *El-veçbiç fi ta’rifi kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 335.

76. Libri është ende në dorëshkrim. Shih: Ibid. Op. cit., f. 335.

përmbledhur dhe i ka titulluar *'Misbabu-zi-xhaxheb.'*⁷⁷

Dijetari i madh Sindi ka bërë një koment, i cili njihet si Hashijetu-s-Sindi.⁷⁸

Hadithologu i njohur Dihlevi ka bërë një koment të shkurtuar të cilin e ka quajtur *'Inxhabul-haxheb.'*⁷⁹

Fahru-l-Hasen bin AbduRrahman El Kenkuhi ka një koment, të cilit ia ka bashkëngjitur dy komentare të *Inxhabu-l-haxheb* dhe *Misbabu-zi-xhaxheb.*⁸⁰

Imam Dhehebiu ka bërë një libër rreth transmetuesve të Sunenit të Ibni Maxhes të cilin e ka titulluar *'El muxherr-rrid fi rixhali Suneni Ibnu Maxheb.'* Libri është botuar më 1988 në Rijad nga shtëpia botuese Err-rajeh.

Muhammed AbduRreshid ka shkruar një libër rreth jetës dhe veprës së Ibnu Maxhes, të cilin e ka titulluar: *'El Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es Sunen.'* Libri është botuar nga Mektebu el matbuuati el arabijeti nën përkujdesjen shkencore të Abdul Fettah Ebu Guddeh.⁸¹

Muhammed bin Rexheb bin Abdu-l-Al Ez-Zubejri ka bërë një

komentim të cilin e ka emërtuar: *'Ma ted'u ilejbi-l-haxheb ala Suneni Ibnu Maxheb.'*⁸² Libri është dorëshkrim. Një kopje e tij ruhet në Kajro, në Dar el-kutub el-misrijeh me nr. 2424, ndërsa një kopje tjetër në Berlin.

Safa-udavvii Ahmed El Adevi ka bërë një koment të cilin e ka quajtur *'Ibdau-d-dibaxheti bi sherhi Suneni Ibnu Maxheb.'* Libri është botuar Dar El Jekin në Mensure të Egjiptit.

Komentari nga Muhammed Alevi El-Hajdarabadi. Komentari quhet *Miftabu-l-haxheb sherhu Suneni Ibnu Maxheb.*⁸³

Komentari nga Sa'ududdin Harithi.⁸⁴

Jafadavi ka bërë një koment, që është botuar më 2001 në Bahrejn.⁸⁵

Muhammed Ahsen Nanuvtevi. Është komentim në gjuhën persiane.⁸⁶

Në gjuhën urdu është bërë një koment nga Vehiduzzman.⁸⁷

Muhammed Munteka Keshnavi Kumsvi ka një koment të quajtur *'El-kevakib el-vehhaxheb bi sherhi Suneni Ibnu Maxheb.'* Libri është botuar më 1409 h., nga Dar el-kutub el-arabijeh në Bejrut.

82. Shih: El Gavri. (2009) *El-vexbiz fi ta'rifi kutubi-l-hadith.* Op. cit., f. 337.

83. Shih: Ibid. Op. cit., f. 338.

84. Shih: En-Nu'mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es-Sunen.* Op. cit., f. 236.

85. Shih: El Gavri. (2009) *El-vexbiz fi ta'rifi kutubi-l-hadith.* Op. cit., f. 339.

86. Shih: En-Nu'mani. (1419 h.) *El-Imam Ibnu Maxheb ve kitabubu Es-Sunen.* Op. cit., f. 275.

87. Shih: Ibid. Op. cit., f. 280.

77. Libri është botuar në Indi më 1282 h. Shih: Ibid. Op. cit., f. 337.

78. Shih: Ibid. Op. cit., f. 337.

79. Shih: Ibid. Op. cit., f. 338.

80. Është botuar në Pakistan dhe Indi. Shih: Ibid. Op. cit., f. 338.

81. Radhitjen e librat nga 1-14 e kemi bërë sipas asaj që ka bërë Shuajb Arnauti (1/29-35) ndërsa të dhëna shtesë kemi siguruar nga burime tjera.

Komentim i bërë nga Ali bin Abdullah bin Ni'mete El-Ensari El-Belensi El-Endelusi.⁸⁸

Koment nga Ali bin Sulejman Dimnete El-Buxhmava Magrebi. 'Nuru misbahi-*z-zuxhaxheti ala Suneni Ibnu Maxheb*.' Libri është botuar në Kajro nga Matbatu El-Vehbi, më 1294 h. Është version i shkurtuar i Sujutit.⁸⁹

Nën përkujdesjen e Raid bin Ebi Alefeh janë botuar në një libër dyvëllimësh komantarët e Sujutit (*Misbahu-*z-zuxhaxheb**), Sindiut (*Nihajetu-l-haxheb fi sberhi Suneni Ibnu Maxheb*), Dihleviut (*Inxhabu-l-haxheb*), Busajrit (*Misbahu-*z-zuxhaxheti fi zevaidi Ibnu Maxheb**), Kenkuhit (*Ma jeli^{ku} min bil-li-l-lugat ve sberhi-l-mushkilat*), Nu'manit (*Mubtesar ma temessu ilejbi-haxhetu limën jutaliu Sunen Ibnu Maxheb*), të cilin e ka titulluar 'Shuruh Suneni Ibnu Maxheb.' Libri është botuar nga Bejtu-l-efkar ed-deulijjeh më 2007 në Rijad (A. Saudite) dhe Amman (Jordani).

Është botuar me verifikim shkencor të haditheve nga Muhammed Nasiruddin Albani.

Është botuar me verifikim shkencor të haditheve nga Shuajb Arnauti me një grup studiuesish.

Është botuar me verifikim shkencor të haditheve nga Besh-shar Avvad Ma'rufi.

Është botuar me verifikim

shkencor të haditheve nga Muhammed Fuad Abdul Baki.

Sigurisht ka dhe punime të tjera të shumta. Në kohën tonë vërehen edhe punime të formatit audio dhe video, pra shpjegime në formë ligjëratash që i janë bërë Sunenit ose pjesëve të caktuara të tij.

Përfundim

Si përmbledhje të disa prej mësimëve më të rëndësishme të këtij punimi do të veçonim:

Afirmimin për pozitën e Ibnu Maxhes prej dijetari të madh të hadithit;

Konfirmimin për pozitën e Sunenit dhe vlerat e tij si një ndër librat bazë të hadithit; dhe

Justifikimin si të drejtë të rreshtimit të Sunenit në mesin e gjashtë librave të sakta të haditheve

Ndërsa si rekomandime do t'i propozonim institucioneve tona fetaro-arsimore që në kurrikulat e tyre të përfshijnë studimin e metodologjive të autorëve dhe veprave të shquara të trashëgimisë islame, të cilat paraqesin vlerat e qytetërimit tonë. Po kështu do t'i rekomandoja institucioneve përgjegjëse për veprimtarinë fetare që në programet e tyre të parashohin publikimin e këtyre veprave, duke i rishikuar ato që janë botuar për t'i botuar me shënime dhe shpjegime që lexuesit ia lehtësojnë kuptimin, si dhe duke përkthyer e botuar ato që nuk janë përkthyer deri më tani.

88. Shih: Ibid. Op. cit., f. 230.

89. Shih: El Gavri. (2009) *El-vechiz fi ta'rifi kutubi-l-hadith*. Op. cit., f. 338.

Homazh i vonuar njeriut, gurgemer të urës shqiptare Lumo Skëndoja te *Zani i Naltë*

Prof. Dr. Rahim Ombashi
Universiteti Bedër, Tiranë

Abstrakt

Revista e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë doli në një periudhë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, por që shfaqet shumë e trazuar, kur bota shpirtërore shqiptare vibet në kërkim të kohës së humbur dhe me pak ngjarje. Pas rebelimeve, revoltave dhe grushteve të shtetit që ndiqnin njëri-tjetrin, revista shfaqet në qiellin tonë shpirtëror si një dritë e ngrohtë që do të ndihmonte jo vetëm në informimin e lexuesit, por do të nxiste komunikimin që kishte kolorit lokal dhe kohor.

Revista dëshmon ndërlidhjen e traditës mediatike me bashkëkohoren, siç ka vënë në dukje T. S. Elioti në esenë e vet Tradita dhe talenti individual (1919), se, edhe pjesët më individuale dhe më të mira të veprës së autorit përkatës, janë ato me të cilat krijuesit paraardhës kanë verifikuar fuqimisht pavdekësinë e tyre.

S entenca minimaliste “Gjuha më shumë fshih se shpreh” gjen zbatim te ajo që na ka mbledhur, te ky thesar i publicistikës sonë, i krejt komunikimit tonë kulturor, e jo vetëm.

E përmuajshmja *Zani i Naltë* bulëzoi në tetor 1923 dhe vijoi normalisht deri në shtator 1924 me 12 numra. Revista ridel pas një pushimi gjashtëmuor, mars 1925, vijon në prill, maj, por në qershor dhe korrik bëhet e përdymuajshme.

Po kështu edhe gusht-shtator, kurse tetori dhe nëntori dalin botime mujore. Gjithsej viti 1925 mbyllet me 8 botime.

Revista e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë doli në një periudhë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, por që shfaqet shumë e trazuar, kur bota shpirtërore shqiptare vihet në kërkim të kohës së humbur dhe me pak ngjarje. Pas rebelimeve, revoltave dhe grushteve të shtetit që ndiqnin njëri-tjetrin, revista shfaqet në qiellin tonë shpirtëror si një dritë e ngrohtë që do të ndihmonte jo vetëm në informimin e lexuesit, por do të nxiste komunikimin që kishte kolorit lokal dhe kohor.

Koha zvarritej dhe Atdheu kishte mbetur 'midis Urës!', si e vendos artistikisht Lumo Skëndoja. Dekada II e shtetit të ri përhapte pesimizëm. Kishte vetëm një rrugë që mund të ndalte nga zhdukja e tmerrshme dhe e përjetshme. Ishim jo në rrugë, po mbi urë, që duhej ta kalonim. E kishim vetë në dorë. Të mençurit dhe të fismit e kombit i besonin kësaj alternative, ndaj dhe grishnin gjithkrah e gjithkënd që ndiente e kishte zemër. Më 27 dhjetor 1924 zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që i fiton grupi qeveritar i udhëhequr nga Ahmet Zogolli, por ende nuk ka stabilitet politik, kësisoj edhe ekonomik e social. Pas atentatit që i bëhet Zogollit, po me atentat

do të vritet Avni Rustemi, që do t'i shërbejë grupit opozitar të nisë Lëvizjen e Qershorit. Qeveritë në vijim janë ditëshkurtra. Më 27 maj 1924 jep dorëheqjen qeveria e Shevqet Verlacid, që zëvendësohet nga qeveria disa-javore e Iliaz Vrionit. Shteti shqiptar mbijeton pas Këshillit të Lartë që nuk di të dorëhiqet.

Revista bllokohet në periudhën kur krijohet qeveria shtatanike e Fan Nolit, që do të qëndrojë në pushtet vetëm një javë më tepër se gjashtë muaj, sepse në 24 dhjetor 1924 do të hyjë në Shqipëri Ahmet Zogolli (më pas Ahmet Zogu).

Zani i Naltë në nr. 1, Tetuer, Viti I shpall se 'e përkohëshmjat' fetare 'meret edhe me filosofi, moral, literaturë kombtare, sociologji' dhe cakton periudhën kohore: 'Del një herë në muej'. Drejtor i revistës është Ismail Maçi në Tiranë, por revista nuk shënon se ku është shtypur. Numri 1 ka 32 faqe. Në faqen e parë *Lënda* jep 7 rubrika, por nuk boton emrin e asnjë autori.

Numri 2, Nantuer, nga sociologji shkruan sociologji duke shtuar vendin dhe shtypshkronjën ku u shtyp: Tiranë, *Mbrothësia* Kristo Luarasi. Revista do të shtypet te kjo shtypshkronjë me tharm nacional deri në Nr. 1, gusht, 1926, sepse më pas vijon të shtypet në Shkodër, Shtypshkronja *Ora e Shkodrës*.

Në nr. 4, viti 1926 emërohet drejtor vetëm për këtë numër

Shyqyri Miftiu dhe pas tij drejtimin e merr Hafiz Isa Domni, kurse nga nr. 1 i vitit 1931 e gjersa u mbyll drejtor i saj do të jetë Haki Sharofi.

Numri i fundit, (153) ishte nr. 5, viti XIV, maj 1939. Pak vite për një medie periodike, po çfarë thesari ngërthehet brenda kolonës. Faktohet që cilësia nuk ka lidhje me sasinë ndaj nuk mund të gjykohet e aq më tepër të matet. Ajo vetëm vlerësohet.

Lexuesi shqiptar sado i pakët kishte krijuar përvojë-vetëdijen letrare të marrësit dhe arrinte të dallonte ndryshimet mediatike të krijimtarisë publicistiko-letrare qoftë nga aspekti i gjuhës poetike, i strukturës së mesazhit, i strukturës kompozicionale, si edhe qoftë nga sistemi i funksionimit dhe i koherencës tërësore të veprës. Gjithçka eci sipas parashikimit dhe shpresës së botuesit, revista iu nënshtrua (ta shprehim me nocionin H. R. Jaus-it) *horizontit të pritjes*, pranimit dhe ndikimit.

Revista dëshmon ndërlihdjen e traditës mediatike me bashkëkohoren, siç ka vënë në dukje T. S. Elioti në esenë e vet *Tradita dhe talenti individual* (1919), se, edhe pjesët më individuale dhe më të mira të veprës së autorit përkatës, janë ato me të cilat krijuesit paraardhës kanë verifikuar fuqimisht pavdekësinë e tyre.

Meqë fati kulturor kërkon që ende të jemi në pritje të *Historisë sonë të letërsisë*, duket ka ndodhur siç

thekson A. Flaker: “Në ato kultura e mese ku studimi i artit letrar ka arritur një nivel të lartë, historia e letërsisë i ka lëshuar vendin historisë së veprës letrare”.

Objekt i hulumtimit tonë u bënë 3 shkrime dhe një rubrikë: *Pjesa Sociale*, që prezantohet me shkrimin *Jemi midis Urës!* dhe njoftimin *Një lutje këndonjsve*. Kësisoj rritet numri i bashkëpunimeve të Lumo Skëndos, këtij personaliteti të kulturës shqiptare, me revistën.

1. *Refugjatët Shqiptarë*, shkruar në Tiranë, 19 shtator 1925. Është një reportazh ku vizatohet jeta autentike shqiptare, me shumë varfëri materiale e me shumë pasuri shpirtërore. f. 603-607. *Refugjatët Shqiptarë*, **19.09.1925**.

Është shkrimi i fundit i revistës qershor-korrik (6-7) 1924, që ka dalë për dy muaj, kështu do të dalë edhe numri 4-5, qershor-korrik 1925. Numri 8, tetor, ai 9, nëntor dhe ai 10, dhjetor do të jenë të veçantë.

2. *Edeb, jahu!* (Edukatë!) Artikulli është botuar në nr. 1, 1926. Shkrim i shkurtër, me nota satire që grish për të ecur në rrugën e qytetërimit. Autori fton dhe nxit që të ecet në rrugën e edukimit moral, si pjesë integrale e edukimit shpirtëror të shqiptarit, kur ishte krijuar shteti shqiptar.

Te revista *Zani i Naltë*, 1926, tetor, nr. 3, kur revistën e drejtonte

Ismail Maçi, del si artikull i parë i saj brenda rubrikës *Rreth studimeve historike*, artikulli *Nga pikat qi duhen shpjegue n'islamizëm: 'Tesavvufi' prensipi dhe rrugët e tij*. Ky shkrim, ashtu si edhe shumë të tjerë, nuk ka autorin, por duke u nisur nga shkrimet në vijim, përveç veprës së gjatë poetike *Fluturimet e shpirtit të Ferit Vokopolës*, del edhe emri letrar i Lumo Skëndos te rubrika *Pjesa Sociale Nji lutje këndonjësve*. Studiuesi u thekson lexuesve:

“Për neve sod të tana kto shkrime të moçme, kanë randësi fort të madhe: duhet të kujdesemi qi të mos hupnje dhe të jesë e harrueme as njena prej tyneve, se ata na diftojnë jetën morale, intelektuale dhe fetare të babavet dhe gjyshvet t'onë.”

Më poshtë ai u lutet lexuesve që materialet “... të na i dërgojnë në Zyrë të *Zanit të Naltë...*”, që na jep të drejtën të mendojmë se edhe shkrime të tjera mund të jenë të tij, përfshi edhe pjesën e mëparshme të rubrikës.

Është vendi të theksojmë se kjo revistë i ka çelur udhë botimit të veprës poetike të Nezim Frakullës në vitin 1938, kallnuer-fruer, numri 1-2 dhe më pas pothuajse në çdo numër deri te viti 1939, numri 2-3, fruer-mars, vetëm dy numra para numrit 4 dhe 5, ose numrit të fundit të revistës.

Nëse do të përdornim si metodë

letrare për përimtimin e *Divanit* shqip të Nezimit metodën psiko-letrare të Arshi Pipës, do të zbulonim lidhjen e vjershëtarit bohem me veprën, ku shkrimi dallon si individual, me mbizotërimin e dhembjeve të jetës.

Kësisoj revista bënte vlerësimin e traditës dhe realizonte lidhjen me bashkëkohësinë e periudhës, duke realizuar detyrën që kishte kritika letrare.

3. Rubrika: *Pjesa Sociale. Jemi midis Urës! dhe Nji lutje këndonjësve*, 4, 1926, tek i cili lypset të ndalemi për jonatyrshmërinë e tij dhe origjinalitetin, hijeshinë dhe mendimin që zgjon.

4. *Grishje*. Ky titull lexohet në nr. 5, 1928 dhe del si shkrimi i fundit i këtij personaliteti të kulturës shqiptare, që përsëri ka befasimin si veçanti:

Grishje

Zotërinj

Me rastin e festës së Shën Gjergjit, revista *Diturija*, do t'organizojë, më 23 të prillit, një ekspozitë për Skënder Benë, me libra të botuarë mbi heronë t'ënë, estampa dhe figura.

Ekspozita jonë është në Librarit Luma Skendo, dhe do të jetë çelur tër ditën gjer më 25 të prillit, mbrëmanet.

Jinni të luturë të nderoni këtë festin të kujtimit të Gjergj Kastriotit

t'ënë me ardhjen tuaj, dhe të miqvet tuaj.

Me nderime

Lumo Skendo

Drejtori i revistës "Dituria"

Shenim:

Ekspozitë jonë bëhet me një qëllim historik. Objektet e treguar janë pronja personale e drejtorit të *Diturisë*, dhe nuk janë destinuar për shitje.

Të hymit është' i lirë për gjith vizitorët nga ora 10 e mëngjezit e gjer sa perëndon dielli.

Njoftimi i shkurtër dëshmon për vizionin e madh të patriotit dhe dijetarit në zë. Tashmë ai ka mbështetje të fuqishme edhe revistën e vet dhe grishjen e boton vetëm atje, nëse duhet, por jo. Gjithçka e vë në shërbim të çështjes kombëtare: edhe revistën e bekuar, që duhet të vijojë me edukimin shpirtëror, i cili duhet të shkojë krahas atij intelektual, patriotik e profesional. Festa e Shën Gjergjit për të është së pari kombëtare, sepse lidhet me heroin kombëtar, njëherazi edhe fetare. Fakti që e thotë me shkrim këtë në revistën fetare të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zbulon arsyen kryesore pse ai iu ndodh pranë kësaj reviste. Të zgjedhurit prej tij të jetë në krye të revistës së KMSH, nuk e zvjerdh nga origjina bektashiane e familjes së vet. Mid'hat Frashëri natyrshëm qëndroi i lidhur me rrënjët e besimit,

siç do të provohet edhe me varrimin e tij në Amerikë.

Shkrimi: *Nji lutje këndonjsve*, 4, 1926, nis në fund të faqes dhe vijon edhe në faqen në vijim. Asnjë shkrim tjetër i këtij numri, që është lajmëruar te Landa, nuk fillon kësisoj. Duke parë edhe elemente të tjera të stilit, gjykojmë se e gjithë rubrika *Pjesa Sociale*, që prezantohet me shkrimin *Jemi midis Urës!* është e këtij autori. Metoda *diplomatike* vjen në ndihmë të gjykimit tonë. Eseja sociale do të jetë objekt i mëvonshëm, por le t'i kthehemi krijimit të nisur.

Te njoftimi *Nji lutje këndonjsve* lypset të ndalemi për jonatyrshmërinë e tij, origjinalitetin, hijeshinë dhe mendimin që zgjon, ndiejmë se na lë një peng diçka të shenjtë, ndaj duhet ta japim të plotë:

Prej këndonjëve të "Zanit të Naltë" kena nji lutje, dhe ushqejmë uzdajen (r.o, besimin në kohë, *shpresën*) se do të na digjojnë dhe do të na përgjegjen.

Midis shkrimeve në gjuhë shqip gjinden nji shumicë ilahi, vjersha, histori qi kanë mbetë në dorë të popullit dhe po ruhën n'arkat a në raftat e shtëpivet, në qytet a në katunde. Ma të shumë ose me thanë ma mirë të gjith kta shkrime të moçme me germa (*shkerojat*) Turqisht.

Për neve sod të tana kto shkrime të moçme, kanë randësi fort të madhe: duhet të kujdesemi qi të mos

hupnje dhe të jesë e harrueme as njena prej tyre, se ata na diftojnë jetën morale, intelektuale dhe fetare të babavet dhe gjyshvet t'onë.

Do prej ktyne shkruasave, dy mevluda kanë qenë shtypun katerdhetë dhe pesdhetë vjetë përpara, ashtu si kundër kanë qenë të shkrumun, dua me thanë me shkronja Turqishte. Po jemi sigur se dhe një shumicë e madhe po rrin e harueme dhe rezikon të hupi e të digjet na një zjarë, t'a hajë miu, ose t'a treti lagshatina.

Detyra e djemvet asht me pas një nderim e dashtuni për veprat e mira të gjyshvet dhe t'i shikojë si një trashgim të çëmueshëm.

U lutena pra këndusvet t'onë qi kujdesen për këta shkrime të vjetra dhe të na i dërgojnë në Zyrë të Zanit të Naltë¹ do me një njeri të sigurt, do me postë, tue pasë mendën qi mos grisen dhe prishen kartrat.

Na dishrojmë qi të kemi këto dokumenta n'origjinal, ashtu si kanë qenë. Do t'i përshkojmë pastaj me gërma shqipe dhe do t'i botojmë një ka një, dyke refyrë emnin e atyre zotënive qi kanë patur mirësin me na içue, ose me na i dhanë uha.

Këjo punë qi ka randësin e posaçme nga pikpamja e gjuhës e letraturës, ka edhe një kuptim për jetën fetare të Shqipnisë.

Lumo Skendo

Gjuha e artikullit është sipas gegërishtes jugore të Elbasanit, çka dëshmon se ai vijon të jetë nën ndikimin e ideve të Shoqërisë së Stambollit, ku drejtonte Sami Frashëri. Gjykimin e tij për ruajtjen e zhvillimin e traditës kulturore e mbështet më pas edhe Mehdi Frashëri, një tjetër Frashëlli me shenjë i kulturës dhe historisë sonë, çka dëshmon vizionin parak të Lumo Skendos:

“... për të kupëtuar ngjarjet e sotme me gjith arsyet e tyre, ka nevojë të kërkojmë ngjarjet e shkuara mbi krye të këtij populli, tue vazhduar fill’ e punëravet të shkuara pa prerë, që nga kohërat më të vjetëra deri në ditët tona. Në këtë udhëtimin’ e mendjes, çfaqet psikologjia e kombit që ka zotnuar ngjarjet.

(Frashëri, 1928)

E shkuara, psikologjia nacionale vjen e bëhet pjesë e identitetit kombëtar, ndaj këtë Lumo Skendoja synonte ta ruante me çdo kusht:

“Kur do të shofim qi organizat e pleqësive fillojë të regullohet me lider qi kuptojnë psikologjin e popullit, historin e qarkut qi ndollet, pozitën gjeografike shëndetsore, e kulturele të vendit, do të mbesojnë se kemi siguruë shtegtimin social në udhën madhshëtore të Evolucioneve: Pjesa intelektuale duhet të banjë këto sakrificat morale e materiale ma parë

1. Zyra e Zanit të Naltë asht ne Zyren e Myftiut përgjithshëm ne TIRANË.



se të lypin realizimin e dëshirave evolucionare.”

Mid'had Frashëri (1880-1949), që besonte te evolucioni social i kombit tonë e vetëm te ai (i druhej revolucionit), biri i Abdylit, nipi i Naimit dhe Shemsetin-Sami Frashërit, u zgjodh kryetar i Kongresit të Manastirit dhe nënkryetar i Komisionit për hartimin e alfabetit në Manastir, ku kryetar i Komisionit ishte Atë Gjergj Fishta. Në qeverinë e krijuar nga Ismail Qemali ai emërohet ministër i Botores, në qeverinë e Princ Vedit ndihmon në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kryen detyrën e Ministrit Fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë në Athinë nga 1923-1925.

Diplomat

Në vitin 1927, fillon të botojë sërish në Tiranë, revistën *Diturija* të cilën e kishte themeluar në Selanik më 1909 dhe e vijoi më vonë në Bukuresht gjatë qëndrimit të tij atje.

Në Tiranë themelon dhe librarinë *Lumo Skëndo*. Në 4 prill 1929 Mid'hat Frashëri në testamentin e tij shkruan amanetin duke e lënë si peng për ne:

“Çë kam pasuri të tundshme ose të patundshme, libra, mobilla, karta, plaçka etj. i lë për krijimin’ e një “INSTITUT ALBANOLOGJIE” që të jetë një qëndër e studimevet shqipëtare, të mprojë, të shvillojë, të qendrësojë dhe të udhëheq një studimetë që përkasin Shqipërinë dhe Shqipëtarët.”

Kundërshtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, detyrohet në nëntor 1944 të largohet nga atdheu për në Itali dhe pas 5 vjetësh shpërngulet për në SHBA. Në vitin 1949, vetëm disa muaj si kishte arritur në atë vend, gjatë një udhëtimi për në Nju Jork, ‘ora 9.25 minuta, në hotelin Winthrop, ai ndërron jetë si pasojë e një ataku kardiak’ (?).

Gazeta *Dielli* përshkruan sesi u vendos në një sallë të madhe ku binin në sy 25 kurorat e dërguara. Në orën 14 ka filluar ceremonia e varrimit. Imam Vehbi Ismaili i ardhur nga Detroiti ka bërë lutjet. Imam Vehbiu kujtonte shpesh në bisedat vetjake me miqtë se ky kishte qenë varrimi i parë i drejtuar prej tij në Amerikë. Kishte qenë amanet i Frashëlliut të shquar, që kurrë nuk e ndau besimin fetar nga besimi kombëtar, ashtu ndihej i plotë dhe në paqe me veten, duke mos iu ndarë binomit Fe-Atdhe.

Aftësinë e shquar, pasurinë dhe në fund edhe jetën ia fali Atdheut; nuk krijoi familje dhe nuk kërkoi kurrë asgjë prej tij. Jetoi e ndërroi jetë në paqe, që e sjell veç besimi. Një ditë, ndoshta, mund të kujtohemi ta vendosim pranë atit që e lindi dhe xhaxhallarëve që e formuan si të tillë.

Arkivoli ishte i mbuluar me flamurin kombëtar dhe në sallë ishin 200 veta'. Më pas kortezhi drejtohet për në varrezat *Ferncliff* të Nju Jorkut, që nuk janë sektare. Mid'had Frashëri prehet në mërgim mes figurash të shquara, përfshi Nikola Teslën, shkencëtarin e madh që kujtohet për aforizmin:

“E tashmja është e tyre; e ardhmja, për të cilën kam punuar me të vërtetë, është e imja.”

Revista, që u bë sebeb (shkas) për tubimin sot, së shpejti mbush shekullin, duke provuar se realisht ka siguruar ardhmërinë. Peizazhit mediatik shqiptar ajo i shton edhe ndihmesën metodologjike, origjinalitetin e pamohueshëm si kontribut specifik për studime të mëtutjeshme kuranistikës shqiptare.



Shteti shqiptar e ka kapërcyer tashmë urën e gurtë me qemer, ku gurkyç ka pasur luçidë si Mid'had Frashëri - alias Lumo Skëndoja.

Bibliografia

Frashëri, Mehdi. (1928) *Histori e Shqipërisë dhe shqipëtarëve*, vol. I, Botim i Ministris s'Arasimit, shtypshkronja “Vlora” Cav. G. direttore e C., Vlorë, f. 7.

“ZANI I NALTË” Revistë e mendimit dhe emancipimit fetar e kombëtar

H. Resul Rexhepi, Bashkësia Islame e Kosovës

Abstrakt

“Zani i Naltë” është një ndërmarrje e projektuar nga njerëz të mëdhenj, nga atdhetarë e ulema vizjonarë e largpamës, të cilët me punën e tyre dhanë kontribut të çmuar në shpjegimin e mësimëve të fesë islame drejtë dhe saktë dhe ndihmuan në bërjen e shtetit dhe në formësimin e kombit. Është ky brez i artë i prijësve të shquar myslimanë që lanë gjurmë të pashlyera në historinë tonë fetare dhe kombëtare, si Haxhi Vehbi Dibra - Hoxha që dha fetvanë për aktin e shpalljes së Pavarësisë, e më vonë edhe themelues dhe kryetar i parë i Komunitetit Mysliman Shqiptar, ulematë e dëshmuar: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Ali Kraja, Ismail Maçi, Jonuz Bulej, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, Qazim Hoxha, Shevqet Dajiu, Shefqet Muka, Nebil Çika, Sali Butka, Hamid Gjylbegu e shumë të tjerë, pa lënë anash këtu edhe personalitetet e tjera të mendimit politik, kulturor e letrar, siç ishte Mit’hat Frashëri dhe bashkëmendimtarë të tjerë. Kjo ka bërë që edhe 90 vjet pas, shkrimet që janë botuar në “Zanin e Naltë”, të mbesin prore aktuale dhe të tingëllojnë si të jenë thënë sot.

Të shkruash një fjalë me rastin e ribotimit të kolanës së revistës “Zani i Naltë”, që mbetet një nga veprat monumentale, dëshmi e një pune kolosale të një brezi të shquar të mendimtarëve fetarë shqiptarë,

e realizuar në një kohë historike e domethënëse për shtetësinë dhe kombin shqiptar, është nder dhe privilegj, por edhe përgjegjësi, sepse duke dashur që t’i përzgjedhësh fjalët, shumë gjera mbesin pa u thënë.

Sidoqoftë, risjellja për lexuesit në këtë format e “Zanit të Naltë”, është e një rëndësie të veçantë dhe shumë domethënëse, sepse përveç se na mundëson të njohim punën e vlefshme të paraardhësve tanë, po ashtu na mundëson që ta vlerësojmë drejt e objektivisht frymën, pikëpamjet dhe qëndrimet e Komunitetit Mysliman Shqiptar karshi problemeve dhe nevojave të kohës, të shprehura përmes organit të tyre që i dhanë një emër sa simbolik po aq edhe domethënës “Zani i Naltë”.

Shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar dhe ndërtimi i institucioneve të tij, u shoqërua edhe me formimin e një infrastrukture përkatëse socio-kulturore. Strukturat e mëparshme tashmë kishin përfunduar, ndërsa në realitetin e ri shtetëror kërkoheshin zgjidhje të reja. Komunitetit Mysliman Shqiptar, pas shpalljes së shkëputjes nga struktura paraprahe më 1921, në shtetin e ri shqiptar u konstituua si strukturë e plotë më 1923, pikërisht në një fazë të krizës institucionale e morale që e përjetonte përgjithësisht bota shqiptare dhe veçmas besimtarët islamë si pjesë dërrmuese e saj. Bazuar në Statutin e miratuar të Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe veçmas në nevojat e mëdha të kohës për ta bashkuar elementin islam, për ta ngritur e rizgjuar nga plogështia e hutimi që e kishin kapluar, për ta organizuar sa më mirë e më mbarë jetën fetare

në shtetin e ri, në tetor të vitit 1923, nisi botimi i të përkohshmes “Zani i Naltë”¹, e cila, përveç përmbajtjeve fetare, filozofike, morale, arsimore, kulturore, letrare dhe sociologjike, kishte për qëllim “...M’ia zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetën e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlikume..., si dhe me plotësue vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipëri”. Kjo me qëllim që, siç thuhet aty: “Me forcue themelet e një politikes së shëndoshtë e të thjeshte kombëtare në Shtetin tonë”².

Konceptimi i këtillë shumëplanësh nga “Drejtimi” (lexo: Redaksia) del prej synimit për ndryshime rrënjësore në jetën kulturore e fetare të shqiptarëve. Këtij qëllimi dhe kësaj filozofie që nga numri i parë e deri në numrin e fundit që doli në vitin 1939, drejtuesit e revistës “Zani i Naltë” i mbetën besnikë dhe këto parime të shenjta e madhore i kultivuan të gjithë ata që e drejtuan dhe shkruan në “Zanin e Naltë”. Të parë nga Ismail Maçi,

1. “Zani i Naltë”, në: Fjalori enciklopedik shqiptar, autorë të zërit: Palok Daka, Maksim Gjinaj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, vëllimi 3, Tiranë, 2009, f. 2976-2977. Autorët e këtij zëri, kanë një konstatim që nuk qëndron, kur thonë se në “Zanin e Naltë”, citojmë: “një pjesë e shkrimeve ishin arabisht” (f. 2976). Në fakt, e vërteta është se në asnjë numër të revistës nuk ka shkrime që janë në gjuhën arabe, përveç ajeteve të Kuranit dhe Haditheve (Thënieve) të Pejgamberit a.s. që janë dhënë në origjinal, por edhe kjo, jo gjithmonë është respektuar.
2. Drejtimi/Redaksia, *Parathënie e qëllim*, “Zani i Naltë”, nr. 1, 1 tetuer 1923, f. 3-6.

drejtor i parë, së shpejti rreth kësaj reviste do të tubohen emra të shquar të islamologjisë, të kulturës dhe të dijes sonë kombëtare. Për 16 vjet të daljes, “Zani i Naltë” u kthye në njërën ndër revistat më të dalluara të kohës, e cila e pasuroi trashëgiminë tonë shkrimore me rreth 5000 faqe tekste të elitës sonë fetare, diturore e kulturore. Veç kësaj, nuk duhet lënë anash edhe karakteri informativ i kësaj reviste. Kështu, “Zani i Naltë” njoftonte lidhur me zhvillimet në jetën fetare e kulturore, lidhur me gjendjen e vakëfeve, për botimet e reja, për zhvillimet e ndryshme në vend e jashtë tij (Kosovë, Maqedoni), por që ishin me interes për lexuesit etj., ndaj me të drejtë mund të konsiderohet si njëra ndër kronikat e kohës.

“Zani i Naltë” është një ndërmarrje e projektuar nga njerëz të mëdhenj, nga atdhetarë e ulema vizionarë e largpamës, të cilët me punën e tyre dhanë kontribut të çmuar në shpjegimin e mësimëve të fesë islame drejtë dhe saktë dhe ndihmuan në bërjen e shtetit dhe në formësimin e kombit. Është ky brezi i artë i prijësve të shquar myslimanë që lanë gjurmë të pashlyera në historinë tonë fetare dhe kombëtare, si Haxhi Vehbi Dibra - Hoxha që dha *fetvanë* për aktin e shpalljes së Pavarësisë, e më vonë edhe themelues dhe kryetar i parë i Komunitetit Mysliman Shqiptar, ulematë e dëshmuar: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz

Ali Kraja, Ismail Maçi, Jonuz Bulej, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, Qazim Hoxha, Shevqet Dajiu, Shefqet Muka, Nebil Çika, Sali Butka, Hamid Gjylbegu e shumë të tjerë, pa lënë anash këtu edhe personalitetet e tjera të mendimit politik, kulturor e letrar, siç ishte Mit’hat Frashëri dhe bashkëmendimtarë të tjerë. Kjo ka bërë që edhe 90 vjet pas, shkrimet që janë botuar në “Zanin e Naltë”, të mbesin prore aktuale dhe të tingëllojnë si të jenë thënë sot.

Mirëpo, për shkaqe tashmë të njohura, që lidhen me ekskomunikimin e vlerave kombëtare që kishin përmbajtje ideologjike të ndryshme nga ajo e komunizmit, kjo pasuri e rrallë mbeti e panjohur për lexuesit tanë për dekada të tëra. Ndryshimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë krijuan rrethana për ta risjellë në vëmendje këtë traditë, e cila, për shkak se u vu në mesin e literaturës së ndaluar, mezi i mbijetoi kohës e në disa raste edhe si ekzemplar i rrallë. Nisur nga ky fakt, ribotimi i gjithë kolanës ishte një imperativ i kohës, ndonëse jo lehtë i realizueshëm, por gjithsesi tejet e nevojshme, si për njohjen e traditës së periodikut islam e kulturor shqiptar, ashtu edhe për faktin se shumë nga kontributet e kësaj periudhe mund të shërbejnë edhe sot si vlera referente, qofshin ato të sferës mendimtare, qofshin të sferës kulturore.

Vetëdija dhe emancipimi fetar dhe kombëtar

Duke shfletuar e lexuar faqet e revistës “Zani i Naltë”, lexuesi s’ka si të mos bindet se firmat e vëna në këto shkrime u përkasin atyre dijetarëve që qenë njohës të shkëlqyer të mësimëve të fesë, kulturës e qytetërimit islam. Ata, përmes revistës “Zani i Naltë”, këto njohuri, i shprehën dhe ua ofruan lexuesve shqipfolës. Mirëpo, drejtuesit e revistës “Zani i Naltë” dhe bashkëpunëtorët e tyre, përveç se njihnin mirë mësimet fetare, ata njihnin mirë edhe traditën dhe historinë tonë. Ata e dinin se për çka kishte nevojë dhe çfarë i duhej shpirtit dhe mendjes së popullit shqiptar në atë kohë. Ata ishin të bindur se ngritja e ndjenjës fetare dhe kombëtare në një kohë kur po sendërtohej kombi dhe po jetësohej shteti, ishte detyrim i tyre nga Zoti dhe nga gjaku. Prandaj, revista “Zani i Naltë” s’kishte si të ishte tjetër veçse projekt i kolosëve të binomit Fe e Atdhe. Pikërisht për këtë, nuk na habit fakti se themeluesit dhe penat e para të revistës “Zani i Naltë” qenë pjesëmarrës aktivë dhe patën rol aktiv në shpalljen e Pavarësisë, në krijimin e Shqipërisë së lirë e të pavarur, në themelimin e Komunitet Mysliman Shqiptar, dhe më pastaj krijimin e organeve dhe institucioneve të tjera, në nxjerrjen e të parës revistë islame në gjuhën

shqipe. Ata, me mprehtësinë e lapsit, thellësinë e mendjes, motivimin hyjnor e atdhetar, kultivuan mësimet për njohjen e Krijuesit, edukimin shpirtëror, motivin për atdhedashuri dhe kultivim të gjuhës e të kulturës shqiptare.

Karakteri fetar dhe kombëtar i revistës del nga vetë pesë synimet e qarta programore, të botuara nën titullin “*Paratbanë e qëllim*”. Tri pikat e para kanë të bëjnë me angazhimin për bashkimin e myslimanëve shqiptarë, me përmirësimin e jetës institucionale islame në Shqipëri dhe me prezantimin e të vërtetave të këtij besimi, ndërsa në pikën e katërt shfaqet angazhimi i qartë për vëllazërim ndërmjet të gjithë elementëve kombëtarë, sigurisht duke e marrë parasysh strukturën heterogjene fetare, sociale dhe kulturore të shqiptarëve. Pika e fundit konsiston në forcimin e themeleve të një politike të shëndoshë dhe thjesht kombëtare të shtetit shqiptar. Edhe përmbajtja e numrave të revistës do ta dëshmonte këtë vijueshmëri konceptuale të organit të Komunitetit Mysliman Shqiptar, i cili emancipimin e shqiptarëve nuk e shihte si të veçantë dhe assesi duke ndjekur një rrugë të ndarë nga zhvillimet e tjera shoqërore³. Shumë çështje të trajtuara në faqet e “Zanit të Naltë” edhe sot janë aktuale

3. Më gjerësisht shih: Drejtimi/Redaksia, *Paratbanë e qëllim*, “Zani i Naltë”, nr. 1, 1 tetuer 1923, f. 3-6.

dhe objekt trajtimi i autorëve të shumtë, ngase ato, si të tilla, janë të gjithmonshme. Interesant është fakti se ndër to ka edhe kontribute, të cilat e tejkalojnë kohën e shkrimit e të publikimit, duke u bërë pjesë e fondit më të çmuar të mendimit antologjik shqiptar. Përveç aspekteve të përgjithshme doktrinare - kuranore dhe të atyre që lidhen me historinë e përgjithshme të Islamit, autorët ofrojnë në faqet e revistës edhe raportet e “Muslimanizmës”, siç e quanin ata Islamin, me ideologji, struktura shoqërore, vlera kulturore e shoqërore, me kultura të veçanta etj., sikundër janë: nacionalizmi, aristokracia, qytetërimi, reforma, orientalizmi, vendi i gruas dhe roli i saj në shoqërinë myslimane etj., një vëmendje e madhe iu kushtohet edhe aspekteve të tjera jetësore, madje edhe aktuale për kohën, duke u përpjekur që lexuesit shqiptar t’i ofrohet një informacion sa më i plotë, sa më i argumentuar si burim dhe sa më i saktë si konstatim. Bie fjala, aty gjejnë vend trajtimet për ideologjitë ekstreme (njëkohësisht të papranueshme nga këndvështrimi islam), që sapo kishin nxjerrë krye atëbotë, përkatësisht për komunizmin dhe fashizmin, pastaj për fanatizmin si dukuri e dëmshme shoqërore. Për të dëshmuar se sa vëmendje i kushtohet ngritjes diturore e shpirtërore të shqiptarëve të asaj kohe, në një periudhë të demoralizimit global, “Zani i Naltë”

bënte thirrje kundër fanatizmit si produkt i demoralizimit shoqëror: *“Fanatizma është më i dâmsbmi i demoralizimit sepse është katili i arsyes, sepse është një armik që njeriut ja shkurton gjykimin e kuptimin... Fanatizma është armiku i çdo përparimi, sa më do të shpëtojm prej fanatizmit aq më shpejt do të gjytnohemi”*.⁴ Sot flitet aq shumë për fanatizmin, shpeshherë edhe duke e identifikuar në mënyrë tendencioze vetëm në një sferë të jetës, apo vetëm si atribut të një grupi shoqëror dhe, fatkeqësisht, nuk e gjejmë kaq qartë të shkoqitur dhe të interpretuar si një dukuri që prek gjithandej shoqërinë.

Autorë dhe vlera kulturore kombëtare

Përveç konceptit programor të botuesit, mund të thuhet se një revistë e përbëjnë autorët e saj. “Zani i Naltë”, ndonëse i paragjykuar, herë më shumë e herë më pak, ka pasur autorët me të cilët është identifikuar, jo vetëm në tri vitet e para, por edhe gjatë gjithë daljes së tij.

Aspektet e teksteve diturore e kulturore janë vërtet të gjera, por ne do të mjaftohemi duke përmendur vetëm disa sosh në këtë tekst të shkurtër, me shpresë se lexuesi i sotëm do t’i kërkojë këta margaritarë të traditës sonë shkrimore. Së pari, do të veçoja tekstet lidhur me vlerën e

4. Shih: *Fanatizma*, të autorit të nënshkruar me pseudonimin Lybeteni, “Zani i Naltë”, viti I, 11 gusht 1924, f. 337.

rëndësinë e dijes, aspektet ekonomike të ringjalljes së Shqipërisë, pastaj me një vlerë emblematike vijjnë tekstet që trajtojnë kulturën e të shprehurit (nalt-shkrimin)⁵, fetvatë e ndryshme që prore tingëllojnë aktuale, rubrikën pyetje e përgjigje, rreth qytetërimeve, dhe veçmas shkrimet letrare. Vjershat e botuara të “Zani i Naltë” ishte e kuptueshme që kishin përmbajtje fetare, në të shumtën, por nuk duhet harruar as fakti se ka të tilla me motive atdhedashurie si dhe me aspekte të ndryshme sociale e psikologjike. Përmendim me këtë rast se në faqet e kësaj reviste më 1924 u botua njëri ndër shkrimet poetike më të bukura të letërsisë shqipe përgjithësisht, në të cilin mbizotërojnë tonet elegjiake. Fjala është për poemën “Vajtimit e

5. H. Korça (Hafiz Ali Korça), *Përmbi naltshkrimin dhe përmbi vjersbërimit shqip*, “Zani i Naltë”, viti II, 2 prill 1925, f. 433-438 etj.

Atdheut”⁶ kushtuar bombardimit të Drenicës nga serbët, që mund të thuhet se përgjithësisht ishte ndër reagimet e pakta të asokohshme ndaj mizorive serbe.

Si përfundim

Iniciativa që kanë marrë tri komunitetet tona islame për “rikthimin” e “Zanit i Naltë” dhe atë t’ua ofrojë masës së gjerë të lexuesve, s’ka se si të mos përshëndetet dhe të konsiderohet si një nga ndërmarrjet më të duhura në kohën e duhur. Komplet i “Zanit të Naltë” patjetër duhet që të zërë vend në bibliotekat tona, në bibliotekat e fakulteteve dhe medreseve tona dhe jo vetëm, dhe të na shërbejë si një mbështetje e fortë në rrugëtimin tonë drejt njohurive dhe të arriturave të reja.

6. H. Korça (Hafiz Ali Korça), *Vajtimit e atdheut*, poezi, “Zani i Naltë”, viti I, 11 gusht 1924, f. 349-351.

Myslimanët dhe koha, myslimanët në kohë

Iilir Akshija, M.D., M.Sc.
Qendra Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”,
Departamenti i Statistikës, Tiranë

Abstrakt

Myslimanët përbëjnë 24% të popullsisë së botës dhe numri i tyre në vitin 2020 pritet të jetë rreth 2 miliardë ose 26% e popullsisë së përgjithshme. Një popullatë e tillë, me një shtrirje në të gjithë kontinentet, sjell me vete edhe kulturën e veçantë të besimit të tyre, ku koncepti i kohës, matja dhe menaxhimi i saj merr ngjyrimet islame. Zbatimi i urdhëresave transhendentale të Kur’anit janë të mirëpërcaktuara për ymetin e Muhamedit a.s., duke genë të urdhëruar gjithashtu të bashkëjetojnë me të tjerët pa iu imponuar me dhunë besimin e tyre. Ekzistenca e shoqërisë islame në një balancë të tillë nuk bën përjashtim për nocionin e kohës, të përmendur gjerësisht nga Kur’ani dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në praktikimin e detyrimeve fetare. Njohja dhe studimi i saj kthehet minimalisht në detyrë së pari për përditshmërinë dhe gjithashtu për organizimin e raporteve me të tjerët. Parimi mbetet i njëjlojtë për të gjithë myslimanët, ndërsa projektimi në realitet merr vlera të ndryshme që varen nga gjeografia, periudha historike dhe deri te marrëdhëniet sociale. Në Mekë mund të llogaritet që koha që dubet marrë nga një vit hënor për agjërime është mesatarisht 4.7% dhe në Tiranë 4.9% e gjithë kohës së vitit. Nga ana tjetër mund të shohim ndryshimin e detyruar gjatë historisë kur myslimanët, matjes së tyre standard të kohës nëpërmjet kalendarit hënor dhe kohëve të faljes, i kanë shtuar kombinimin me kalendarin diellor, ose me komponentë të tillë si ndryshimi periodik i orës dy herë në vit. Ky ndryshim i përbershëm kërkon studim të vazhdueshëm të fenomenit dhe përshtatje të herëpashershme.

Fjalë kyçe

Kalendar, namaz, agjërime, haxh, zekat, myslimanë, kohë

Namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi janë obligime për besimtarët myslimanë. Koha e tyre është e përcaktuar dhe mosrespektimi i kohës së zbatimit të tyre pa arsye çon në anulimin e tyre dhe përgjegjësitë përkatëse. Diskutimi rreth kohëve të adhurimeve nuk mund të mos diskutohet, dhe as të diskutohet në mënyrë të pavarur nga përditshmëria, të cilën myslimanët janë të detyruar ta ndajnë me pjesëtarë të besimeve të tjera ose me jobesimtarë dhe të bashkëveprojnë me rregullat e një shteti laik. Në një situatë të tillë, i vendosur midis dy palë detyrimesh, më së paku qytetari mysliman duhet të ketë dijeni rreth obligimeve fetare dhe përcaktimit të kohëve kur ato praktikohen. Në një botë ku %24 e popullsisë janë myslimanë secila nga problematikat në lidhje me Islamin tashmë është globale. Në këtë perspektivë jemi munduar të analizojmë oraret e kohëve referencë të faljeve përgjatë ditëve të kalendarit Hixhri. Kalendarit islam është kalendar hënor që përbëhet nga 354 ose 355 ditë duke krijuar një cikël prej rreth 33 vitesh gjatë 32 viteve të kalendarit Gregorian.¹

Kohët e praktikimit të adhurimeve në Islam janë të varura nga ndryshimet e pozicioneve të

diellit dhe hënës duke krijuar gjatë kohës zhvendosje ciklike si brenda ditës dhe gjatë njësave më të gjata të kohës. Me qëllim paraqitjen e thjeshtuar të këtyre cikleve dhe ndryshimeve që paraqesin, ne kemi marrë në shqyrtim katër qytete, Mekën, Jeruzalemin, Tiranën dhe Londrën. Meka dhe Jeruzalemi janë marrë si referencë për rëndësinë e tyre në Islam dhe Tirana me Londrën si dy qytete Evropiane, por edhe si gjerësi gjeografike në vazhdim të dy të parave për të zgjeruar spektrin e paraqitjes së rezultateve. Llogaritjet në pjesën e parë i kushtohen ndryshimit gjatë një cikli prej 34 vitesh të kohëve të faljeve dhe të agjëritimit. Haxhi dhe zekati gjithashtu kanë kohë të caktuar në kalendarin hënor, por nuk janë paraqitur në mënyrë të hollësishme. Në pjesën e fundit kemi praqitur grafikisht, sipas të dhënave në dispozicion, numrin e popullatës së myslimanëve në botë në raport me përkatësitë e tjera fetare.

Myslimanët dhe koha

Koha përmendet shpesh në Kur'an dhe është i famshëm betimi i sures Asr, 'Pasha kohën!'² Pa pasur mundësi ta analizojmë temën e kohës në Kur'an mund të themi që ky betim nuk kufizohet vetëm në këtë sure. Objektet referencë të kohës,

1. "calendar." The Columbia Encyclopedia, 6th ed.. 2015. *Encyclopedia.com*. 23 Feb. 2016 <<http://www.encyclopedia.com>>.

2. Kur'ani, Asr, 1. h t t p : / / w w w . kuranifisnik.net/KuraniFisnik/Ballina/

pasojat e lëvizjes së tyre dhe kohët që kufizohen prej tyre, ‘qiellin me plot yje (85:1), diellin (91:1), hënën (91:2), yllin ndriçues (të natës) (86:1), qiellin (91:5), tokën (91:6), ditën (91:3), natën (91:4), paraditen (93:1), agimin (89:1), dhjetë netët (89:2) dhe ditën e premtuar (85:2)’ rreshtohen në Kur’an përkrah betimeve të tjera madhështore.³

Të fokusuar shumë mirë në besimin e tyre dhe të lokalizuar gjeografikisht, myslimanët e parë e ndanin mirë ditën sipas pesë kohëve të faljes me referencë këndimin e ezanit. Pas zgjerimit të kufijve të Islamit bëhet e domosdoshme kombinimi i matjes së kohës edhe sipas kërkesave që imponohen nga marrëdhënit politike, tregtare dhe shoqërore. Në tre perandori të ndërtuara mbi kulturën islame, atë Osmane, Safavide dhe Mugale vërejmë karakteristikën e përbashkët të ruajtjes së kalendarit hënor për efekte liturgjike dhe organizimin e jetës së përditshme, megjithatë nuk kanë mundur të qëndrojnë të pandikuar nga traditat e popullatave vendore në llogaritjen e kohës dhe numërimin e viteve.⁴ Baburi (1483-

1530), perandori i parë Mogul, shkruante: ... në vendin tonë ajo që njihet si ... nychtemeron [një ditë-natë] ndahet në 24 pjesë, secila quhet orë [*saat*], dhe ora ndahet në 60 pjesë, secila quhet minutë [*dakika*] ... (Autori vëren për shprehjen *dakika*) *Dakika* është e gjatë sa përsëritja gjashtë herë e Fatihasë bashkë me Bismil’lahin, kështu që ditë-nata zgjat sa përsëritja e 8640 Fatihave me Bismi’lah.⁵ Safavidët e ruajtën definicionin islam të perëndimit të diellit dhe njëlloj si Mugalët e ndanë 24 orëshin në 8 pjesë, katër për orët me dritë dhe katër për orët e natës. Kalendarit Zoroastrian kishte 365 ditë, 12 muaj nga tridhjetë ditë dhe pesë shtesë në fund. Ndërsa Osmanët e ndanë ditën në dy pjesë me nga 12 orë. Në të tre perandoritë eksperti që merrej me studimin e kohës quhej *munaxbixhim*.⁶ Shumë prej këtyre nocioneve hasen edhe sot si alternativa ndërmjet sistemeve të ndryshme për matjen e kohës. Gjatë llogaritjeve tona kemi marrë parasysh pikërisht këtë fakt të pozicionimit të kalendarit hënor (Islam) dhe atij diellor (Gregorian).

Gjatë diçka më shumë se 33 viteve kalendarit hënor vjen dhe mbivendoset përsëri mbi kalendarin

3. Kur’ani, (85:1), (91:1), (91:2), (86:1), (91:5), (91:6), (91:3), (91:4), (93:1), (89:1), (89:2) (85:2) <http://www.kuranifisnik.net/KuraniFisnik/Ballina/>

4. Blake, Stephen P. Time in Early Modern Islam: Calendar, Ceremony, and Chronology in the Safavid, Mughal and Ottoman Empires. (Cambridge University Press, 2013), 48.

5. Zahir al-Din Muhammad Babur Padshah, Babur Nama (Memoirs of Babur), trans. Annette Susannah Beveridge, trans. (New Delhi, 1970), 516.

6. Blake, Stephen P., 49, 52, 66.

Gregorian, duke krijuar një cikël që përsëritet. Ne kemi marrë si bazë për llogaritjet të dhënat e kalendarëve të faqes së internetit IslamicFinder, ku për secilin qytet kemi marrë sipas datave oraret referencë të faljeve dhe agjërimit. Të dhënat janë përpunuar nga ana statistikore dhe janë paraqitur edhe grafikisht. Disa konkluzione interesante janë paraqitur në vazhdim. Tabela më poshtë tregon të gjitha të dhënat në lidhje me koordinatat dhe metodën e llogaritjeve të qyteteve të analizuara.

Figura 1. Pozita gjeografike e vendeve të marra në konsideratë dhe të dhënat bazë të llogaritjes së

kohëve të faljes sipas IslamicFinder⁷ Imsaku, L. Diellit, Yleja, Ikindia, Akshami dhe Jacia janë kohët referencë të faljeve ditore për besimtarët myslimanë. Emërtesat e tyre janë marrë nga faqja zyrtare e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në tabelën më poshtë janë përmbledhur për secilin qytet dhe kohë reference, ora më e vogël dhe më e madhe gjatë vitit e secilit vakt. P.sh., hyrja e Akshamit në Mekë ndryshon nga ora 17:38 deri në orën 19:08 gjatë një viti, në vazhdim në tabelë tregohet diferenca midis këtyre dy orareve ekstreme, 1:30.

7. IslamicFinder <http://www.islamicfinder.org/>



Londër, Mbretëria e Bashkuar	Tiranë, Shqipëri	Rajoni i Jeruzalemit, Palestinë	Mekë, Arabia Saudite
Gjerësi: 51.5000, Gjatësi: -0.1167	Gjerësi: 41.3167, Gjatësi: 19.8667	Gjerësi: 31.7500, Gjatësi: 35.0000	Gjerësi: 21.4200, Gjatësi: 39.8300
Juristic Method: Standard	Juristic Method: Standard	Juristic Method: Standard	Juristic Method: Standard
Metoda e llogaritjes: Muslim World League	Metoda e llogaritjes: Muslim World League	Metoda e llogaritjes: Muslim World League	Metoda e llogaritjes: Umm Al-Qura
Zona kohore: GMT +0.00	Zona kohore: GMT +1.00	Zona kohore: GMT +2.00	Zona kohore: GMT +3.00

Tabela 1. Oraret minimale dhe maksimale referencë të faljeve sipas qyteteve

	Imsaku	L. Diellit	Yleja	Ikindia	Akshami	Jacia
Meka	(4:11-5:41) 1:30	(5:37-7:01) 1:24	(12:04-12:35) 0:30	(15:16-15:55) 0:38	(17:38-19:08) 1:30	(19:08-21:08) 2:00
Jeruzalemi	(3:55-5:15) 1:19	(5:31-6:40) 1:09	(11:24-12:47) 1:23	(14:17-16:27) 2:10	(16:36-19:50) 3:13	(17:57-21:23) 3:26
Tirana	(2:58-5:37) 2:39	(5:06-7:08) 2:02	(11:25-12:48) 1:23	(13:53-16:47) 2:54	(16:12-20:18) 4:06	(17:45-22:18) 4:33
Londra	(2:26-6:03) 3:37	(4:42-8:06) 3:24	(11:45-13:08) 1:23	(13:34-17:27) 3:52	(15:52-21:22) 5:30	(17:49-23:26) 5:37

Koha e agjërimit është paraqitur më poshtë në orë dhe minuta që janë të detyrueshme për mbajtjen e tij. Gjatë ciklit të zhvendosjes së Ramazanit gjatë muajve të kalendarit diellor koha ditore e agjërimit rritet ose zvogëlohet. P.sh., Tirana minimumin e agjërimit e ka rreth 11 orë dhe maksimumin rreth 17.5 orë me një diferencë ndërmjet kohëve maksimale dhe minimale të agjërimit (rangu) prej rreth 6.5 orë. Mesatarisht në Tiranë gjatë gjithë viteve të analizuara agjërohet rreth 14 orë në ditë.

Sa për qind të kohës së një viti duhet ta kalojmë në agjërime? Londra është rasti më ekstrem nga 4 qytetet e analizuar ku mesatarisht në vit konsumohet 5.1% e kohës vjetore dhe 60.7% e kohës së muajit të Ramazanit. Sa më afër Mekës aq më e shkurtër është koha e agjërimit. Në paraqitjen grafike shikohet që sa më shumë rritet gjerësia gjeografike aq më shumë oshilon koha e duhur për agjërime. Londra në ekstrem ka vitet me kohën më të shkurtër por edhe më të gjatë të agjërimit, ndërkohë që Meka ka më pak ndryshime.


Tabela 2. Llogaritje rreth kohëve të agjërimit të një dite Ramazani gjatë ciklit prej rreth 33 viteve.

	Rangu	Minimumi	Maksimumi	Mesatare	Dev. Std.
Meka	2:44	12:11	14:55	13:29	0:56
Jeruzalemi	4:23	11:31	15:54	13:37	1:30
Tirana	6:29	10:50	17:20	13:55	2:12
Londra	9:01	9:53	18:55	14:23	3:11

Tabela 3. Përqindja e kohës së kaluar në agjërime gjatë një viti dhe gjatë Ramazanit

	% e kohës vjetore (min. -max.)	% e kohës brenda Ramazanit (min. -max.)
Meka	4.7 (4.2-5.2)	56.4 (50.8-62.0)
Jeruzalem	4.8 (3.9-5.6)	57.1 (48.1-66.0)
Tirana	4.9 (3.7-6.1)	58.5 (45.3-71.9)
Londer	5.1 (3.4-6.7)	60.7 (41.5-78.6)




Figura 2. Ndryshimi sipas kalendarit hënor i kohës mesatare në agjërim (% e kohës së vitit)




Katër paraqitjet grafike në vazhdim kanë marrë në konsideratë ndryshimin ditë pas dite të orareve referencë të faljeve dhe agjërimit për vitin 2016 në 4 qytetet. Secili nga oraret referencë të faljeve është paraqitur me një vijë të pandërprerë. Vihen re ndryshimet e orareve të faljeve dhe agjërimit sipas stinëve, duke kapur maksimumin e tyre në periudhën e verës dhe minimumin në dimër. Me vija të ndërprera në anësore janë kufijtë e kalendarit islam dhe me vija të ndërprera në qendër tregohet pozicionimi i muajit të Ramazanit për vitin 2016, duke qenë edhe këtë vit një ndër më të gjatët për agjërim. Në 16 vitet e ardhshme koha e Ramazanit vjen duke u zvogëluar, dhe ky cikël përsëritet vazhdimisht. Thyerjet e vazhdimësisë së vijave janë ndryshimet e orës dy herë në vit me përjashtim të Mekës ku nuk ka ndryshim të orës. Zona me ngjyrim të errët mund të konsiderohet si zonë e natës së plotë ndërkohë që zona me ngjyrim të bardhë përfshin kohët nga Imsaku deri në Jaci. Versioni i

animuar vit pas viti është paraqitja më e mirë e mundshme duke marrë parasysh që kemi vendosur në një grafik të vetëm: vitin diellor, vitin hënor, orët e ditës, kohët referencë të faljeve dhe agjërimit, muajin e Ramazanit dhe 4 pozita të ndryshme gjeografike që përfaqësojnë Mekën, Jeruzalemin, Tiranën dhe Londrën.

Figura 3. Paraqitje grafike e kohëve referencë të faljeve gjatë vitit 2016 në Mekë, Jeruzalem, Tiranë dhe Londër. Me vija të ndërprera është paraqitur muaji i Ramazanit.





Myslimanët në kohë

Fillimi i Islamit daton me pejgamberinë e Muhamedis s.a.v.s. (570-632 e.r.), dhe në vitin 2010 rezultojnë 1,65 miliardë myslimanë. Islami është i fundmi i ‘qytetërimeve fetare’ dhe përgjithësisht ka një rritje të vazhdueshme të ndjekësve të tij. Rritja e popullsisë së botës në shekullin e XIX-të e në vazhdim është reflektuar edhe me rritjen numrit të myslimanëve në botë duke arritur në vitin 2010 në 24% të popullatës së planetit. Paraqitjet grafike tregojnë

rritjen e vazhdueshme të Krishterimit dhe Islamit, dhe gjithashtu shfaqjen e fenomenin të ateizmit me përmasa të dukshme globale, duke përafëruar në vitin 2010 një numër prej 662 milion pasuesish.

Pjesa më e madhe e myslimanëve është e vendosur më së shumti në Azi (69%) dhe Afrikë (27%). Europa në vitin 2010 kishte 734,602,633 banorë (6.47% myslimanë) ose e thënë ndryshe në Evropë jetojnë 49,545,462 myslimanë ose 2.99% e myslimanëve të botës.⁸

Tabela 4. Rritja e qytetërimeve fetare (në milionë), 0-2000 e.r.⁹

8. Kettani, Houssain. “2010 World Muslim Population.” *Proceedings of the 8th Hawaii international conference on arts and humanities*. 2010.

9. Princi Ghazi bin Muhammad, Ibrahim Kalin, Mohammad Hashim Kamai. “Lufta dhe paqja në Islam.” *Logos-A, Shkup* (2015).

Viti	S/nik	Ind. e parë	Indian	Budist	Ateist	I krishterë	Islam
1	53	87	24	19		0	
200	59	89	29	24		3	
400	55	69	26	28		16	
600	45	64	32	34		21	
800	50	47	43	39		26	11
1000	66	44	52	43		35	23
1100	98	42	66	45		40	32
1200	115	40	73	46		53	44
1300	86	37	77	44		76	52
1400	81	34	82	40		60	56
1500	108	40	93	42		81	71
1600	146	41	104	48		106	98
1700	160	46	122	57	4	131	114
1800	292	54	132	73	18	219	162
1850	384	65	158	96	32	332	215
1900	435	71	193	107	50	552	282
1950	405	62	410	167	100	887	478
1975	390	59	637	228	555	1333	852
2000	661	76	816	390	600	1972	1290
2010	739	78	842	449	662	2219	1588

Figura 4. Qytetërimet fetare, treguar në % të popullsisë së botës viti 1-2010 e.r.





Figura 5. Qytetërimet sipas përkatësisë fetare (në milionë), viti 0-2010 e.r.



Konkluzione

Në Kur’an, për Diellin dhe Hënë, Allahu xh.sh. sqaron në mënyrë eksplicite se një ndër arsytet që i ka krijuar, është “për llogaritje të kohës” (6:96). Në vazhdim përmendet nata dhe dita si standard për “njehsimin e viteve dhe llogaritjen (e kohës)” (17:12) dhe “Tek Allahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e Allahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre

katër janë të shenjtë” (9:36).¹⁰ Ajetet e Kur’anit janë mjaft të qartë që dielli dhe hëna përdoren për llogaritjen e kohës dhe gjithashtu për njehsimin e viteve, por në momnetin kur përmendet numri i muajve dhe katër muajt e shenjtë, mbështetur kjo dhe me hadithe vendoset edhe standardi i veçantë për vitin hënor.

Kohët e faljeve varen ekskluzivisht nga kalendari diellor dhe ndryshimet e tij periodike duke përjashtuar ndërhyrjen e kalendarit hënor në përcaktimin e tyre dhe këtu kemi reflektimin e plotë praktik të ajetit të mësipërm. Agjërimi është një kombinim i kalendarit hënor dhe diellor duke e bërë një fenomen që përsëritet periodikisht dhe projektohet në segmente të ndryshme të kalendarit diellor. Në këtë mënyrë koha e agjërimit është e ndryshme nga viti në vit. Gjithashtu edhe haxhi dhe zekati janë fenomene të përsëritura në mënyrë periodike sipas kalendarit hënor. Pra adhurimet që përsëriten në cikle vjetore kanë për bazë kalendarin hënor.

Pas këtij caktimi nga Allahu xh.sh. dhe pranimi nga myslimanët, le të shohim disa karakteristika të ndikimit të kalendarit islam, kur merret në konsideratë për t’u përdorur në disa aspekte si ekonomia, shëndeti dhe sjellja shoqërore. Përgjithësisht edhe kur

10. Kur’ani, (6:96), (17:12), (9:36) <http://www.kuraniFisnik.net/KuraniFisnik/Ballina/>

ky kalendar nuk përdoret në mënyrë zyrtare ka funksione pothuajse të plota nga myslimanët praktikantë.

Së pari, zhvendosja e orës dy herë në vit nga një orë duket fenomen që ndërhyt në natyrshmërinë e rrjedhjes së kohës duke krijuar përshtypjen në grafik (fig. 2) për zhvendosje në boshtin e kohës. Në të vërtetë namazi dhe agjërimi janë të lidhura me këtë fenomen. Ato nuk ndikohen nga ndryshimi i orës, por me aktivitetet e tjera ditore po. Pra me 26 mars 2016, në Tiranë, Ikindia hyn në orën 15:17, të nesërmen, më datë 27, hyn në orën 16:18. Nëse ndërmyjet të tjerash ndryshimi gradual i orareve të faljeve dhe agjërimet ka urtësi në vetvete, ndryshimi akut i aktiviteteve të tjera të përditshme dhe sidomos oraret e punës, sigurisht që nuk janë një rekomandim i mirë për myslimanët. Gjithashtu njerëzit që ndodhen larg Islamit mund të mendojnë që financat janë larg ndikimit të kalendarit islam, aty ku ka popullatë myslimane, por studimet tregojnë se ka efekt të pas Ramazanit në bursa.¹¹ Gjithashtu vërehet impakt pozitiv në ruajtjen e vlerës së parasë dhe impakt negativ në depozita. Mosmarrja në konsideratë e muajit të Ramazanit dhe karakteristikave të tjera të kalendarit hënor më së

11. It shows that there is after Ramdhan effect in Karachi Stock market. Mustafa, Khalid. "The Islamic calendar effect on Karachi stock market." *8th International Business Research Conference on March*. 2008.

paku do të sillte parashikime të shtrembëruara.¹² Impakti i muajit të Ramazanit shikohet edhe në çmimin e ushqimeve.¹³ Indikatorët e përmendur më sipër që nga tregjet financiare e deri te çmimi i ushqimeve janë të pastuduara në Shqipëri.

Nga ekonomia të vazhdojmë me ciklet cirkadiene të trupit të njeriut, cikle të proceseve jetësore tashmë të provuara që ndryshojnë gjatë cikleve të kohës, si p.sh., ulja e rrahjeve të zemrës gjatë natës dhe gjumit. Që nga momenti që myslimanët kanë adaptuar mënyrën e jetesës sipas rekomandimeve të fesë islame automatikisht kanë adoptuar edhe ciklet ditore deri vjetore sipas kalendarit islam. Duke filluar nga muskujt e skeletit dhe deri tek aktiviteti kardiovaskular e mendor janë pjesë e ndryshimeve cirkadiane, madje provohet se edhe efektet shëndetësore janë të ndikueshme nga ato.^{14,15} Çfarë do të mendohej

12. Bukhari, Syed Kalim Hyder, Jalil Abdul, and Nasir Hamid Rao. "Detection and Forecasting of Islamic Calendar Effects in Time Series Data: Revisited." *MPR4 Paper* 31124 (2011).

13. Yucel, Eray M. "Does Ramadan have any effect on food prices: A dual-calendar perspective on the Turkish data." *MPR4 Paper* 1141 (2005).

14. Harfmann, Brianna D., Elizabeth A. Schroder, and Karyn A. Esser. "Circadian rhythms, the molecular clock, and skeletal muscle." *Journal of biological rhythms* (2014): 0748730414561638

15. Chen, Lihong, and Guangrui Yang. "Recent advances in circadian rhythms

nëse dy regjime kohore ushtrohen mbi këto ritme natyrore, ai Islam dhe tjetër?! Sigurisht që këtu ka vend për studim. Efektet pozitive të dukshme të agjërimit janë të njohura, përveç përfitimeve të premtuara. Një studim tregon përfitimet në kontrollin e obezitetit, ndërkohë që të gjitha matjet para dhe pas agjërimit nuk tregojnë ndryshime të rëndësishme të parametrave në mostrat e gjakut të marra tek agjëruesit. Një terapi me efekte dhe pa pasoja, një terapi e përsosur!¹⁶ Për astronominë dhe trupin e njeriut duket që orët gjatë ditës dhe natës dhe vit pas viti nuk janë të njëjto, diku një orë është më e gjatë e diku më e shkurtër.

Treguesit e mësipërm dhe të tjerë që duhen studiuar e bëjnë të domosdoshme njohjen në detaje të ndryshimeve të kalendarit islam dhe marrëdhënjeve me metodat e tjera të matjes së kohës, për individin dhe për

in cardiovascular system.” *Frontiers in pharmacology* 6 (2015).

16. Khan, Alam, and M. M. A. K. Khattak. “Islamic fasting: An effective strategy for prevention and control of obesity.” *Pakistan Journal of Nutrition* 1.4 (2002): 185-187.

gjithë shoqërinë. Vetëm 4.9 %, ose nga 3.7-6.1% të kohës vjetore gjatë 34 viteve duhet të harxhojë individi për agjërime në Tiranë (**tab. 2**). Kurse shoqëria, në një kohë dyndjesh nga fshatrat në qytete, nuk duhet të harrojë që numri i myslimanëve në vitin 2020 projektohet 2,050,085,347 ose 26.01% e popullsisë së botës^{17,18}. Hadithi “Përfito nga pesë gjëra para pesë të tjerave: nga jeta para vdekjes, nga shëndeti para sëmundjes, nga koha e lirë para angazhimit, nga rinia para pleqërisë dhe nga pasuria para varfërisë”, i lidh këto begati në mënyrë të pandashme me kohën.¹⁹ Ka një kohë kur i kemi dhe një kohë kur mungojnë, duke qenë bekimi më i madh kur i ke dhe mund t’i përdorësh.

17. Buhaug, Halvard, and Henrik Urdal. “An urbanization bomb? Population growth and social disorder in cities.” *Global Environmental Change* 23.1 (2013): 1-10.

18. Kettani, Houssain. “2010 World Muslim Population.” *Proceedings of the 8th Hawaii international conference on arts and humanities*. 2010.

19. Hakimi, nga Ibni Abbasi (r.a).Etj. <http://www.islampress.info/2015/02/18/perfito-nga-pese-gjera-para-pese-te-tjerave/>

Mësimi i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare e deri në fillimin e viteve '20 të shekullit të kaluar (pjesa e II-të)

Prof. dr. Njazi Kazazi
Departamenti i Gjuhësisë
Universiteti i Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Proceset e ndryshme historike që ndodhën në Mesjetë lanë gjurmë të thella në zhvillimin e kulturës dhe të arsimit shqiptar. Shqipëria ishte e pushtuar dhe kundrejt synimeve asimiluese të të huajve, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe u bë mjaft i vështirë. Në kushte të tilla, si gjuhë shkrimi në territoret shqiptare ishin latinishtja në veri dhe greqishtja në jug. Në shekullin XV gjuhë zyrtare u bë ajo turko-arabe, po krahas saj përdorej edhe gjuha latino-italiane. Megjithëse këto gjuhë depërtonin njëra pas tjetrës, ato nuk arritën të marrin statusin e gjuhës së folur nga populli, kështu që përdorimi i tyre u kufizua vetëm në administratën e pushtuesit, në shërbesat fetare dhe në shkollat e tyre. Në këtë kohë në vend njiheshin si institucione arsimore vetëm shkollat e huaja. Shqipja me sa duket filloi të mësohej më vonë, por përpjekjet për ta zhvilluar atë me alfabet origjinal mund të kenë filluar që në shekullin XVII.

3. Mësimi i gjuhës shqipe në vitet e para të Pavarësisë Kombëtare

Në vazhdim të traditave të Rilindjes Kombëtare, atdhetarët-demokratë e pedagogët-didaktë i konsideruan arsimin dhe kulturën si faktorë të rëndësishëm për përparimin e kombit, por edhe si një mjet për bashkimin e tij e ruajtjen e unitetit kombëtar në luftë me përpjekjet e vazhdueshme të shovinistëve fqinjë për ta copëtuar.



Çlirimi nga Perandoria Osmane dhe krijimi i shtetit të pavarur shqiptar krijonin premisa politike për zhvillimin e arsimit kombëtar në kushte të tjera, larg ndjekjes dhe persekutimit të arsimit në gjuhë amtare, larg mallkimit të gjuhës

shqipe dhe abetareve në gjuhën amtare, për të cilat derdhën jo vetëm mendimin e djersën, por edhe gjakun e tyre shumë atdhetarë.

Qeveria e Vlorës, krahas vështirësive ekonomike, kishte edhe shumë probleme të mirëfillta pedagogjike dhe didaktike për të zgjidhur: duheshin hapur shumë shkolla, duheshin hartuar dokumentet e para shkollore (plane, programe dhe tekste shkollore etj.), të cilat si i përcaktonte ministri i arsimit të asaj qeverie, Luigj Gurakuqi, ishin “...gurët e themelit për të ngritur godinën e shkollës shtetërore shqiptare.”¹

Është i njohur fakti se në programin arsimor të Qeverisë

1. Qazim Kashari, “Zhvillimi i arsimit kombëtar në fillimet e Pavarësisë”, -“Revista pedagogjike”, Nr. 3 / 1996, f. 108.




së Vlorës, veç problemeve të përgjithshme, si: hedhja e bazave të ligjshmërisë arsimore, përpjekjet për krijimin e sistemit arsimor kombëtar, përcaktimi i karakterit kombëtar-demokratik, përpjekjet për arsimin fillor të detyrueshëm, përgatitja e mësuesve në shkollat normale dhe dërgimi i studentëve jashtë shtetit etj., vend të rëndësishëm zunë edhe vendosja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në shtetin e pavarur shqiptar, përdorimi i saj i detyruar në administratë e mbi të gjitha në shkollë.

Qeveria e Ismail Qemalit i kushtoi rëndësi të madhe zbatimit të detyrës për mësimin e shpejtë të gjuhës amtare të shkruar (të lexim-shkrimit), si një gjuhë zyrtare e gjithë shtetit shqiptar. Për këtë u hapën

kurse për nëpunësit e administratës, u krijua një komision për përgatitjen e terminologjisë shqipe për sferat e ndryshme të jetës së vendit dhe u projektua krijimi i një qendre shkencore për çështje të gjuhës amtare, të programeve dhe teksteve shkollore.

Luigj Gurakuqi, si ministër i arsimit i kohës, duke planifikuar masat që do të merreshin nga Qeveria e që do të zbatoheshin në vitin arsimor 1913-14, synonte që të hapeshin shkolla fillore, të mëdha e të vogla, në qytete e fshatra, por edhe shkolla normale për përgatitjen e mësuesve. Në vazhdim të masave organizative, u ngritën 4 drejtori arsimore (në Vlorë, Berat, Elbasan dhe Durrës). Në vitin shkollor 1913-14 në juridiksionin e Qeverisë së Vlorës vepruan rreth 60 shkolla, pjesa më e madhe në fshatra. Në këto vite vepruan edhe shkolla të njohura në historinë e arsimit shqiptar, si: shkolla “Liria” në Gjirokastrë, Shkolla e vashave në Korçë, Shkolla Popullore e Shkodrës (me drejtor Gaspër Mikelin), shkollat në Lis të Matit dhe Trebisht të Dibrës etj.

Vend të rëndësishëm në gjithë programin e asaj Qeverie, ashtu siç theksuam edhe më sipër, kishte gjuha shqipe, mësimi i saj në shkolla (madje edhe në shkollat e huaja), hartimi dhe miratimi i “*skajeve teknike*”, përdorimi i saj në administratë dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore.



Këto masa ndikuan në forcimin e arsimit kombëtar. Shkolla shtetërore shqiptare tani ishte një realitet i lindur në fillimet e Pavarësisë dhe e lidhur me kushtet e reja politike të kohës.

Mësimi i gjuhës shqipe në shkolla ishte shprehje e konceptit të drejtë dhe të saktë që kishin atdhetarët-didaktë për rolin e saj në shoqërinë shqiptare. *“Gjuba është më e madhja fortesë e mburojë e kujtudo populli. Sikur të mos qe shkruar e punuar gjuba shqipe, do të humbisnim si sëpata pa bisht..., gjuba amtare është si bariu që ruan dhentë...”*²

Në shtypin kombëtar të kohës (“Përlindja e Shqypnisë”, “Liri e Shqipërisë” dhe “Shqypnia e re”) u trajtua me forcë problemi i mësimin të saj në shkolla, niveli i mësuesve që do ta jepnin e të tjera probleme teknike. Shtypi në fjalë ka vazhdimisht korrespondenca, lajme dhe optimizëm për ecjen e kombit në rrugë të drejtë, drejt mësimin të gjuhës shqipe, si cilësi e dallueshme dhe kusht për qenien e popullit shqiptar, ashtu siç kishte qenë gjatë gjithë historisë. Në tekstet e kohës i kushtojë kujdes i veçantë ndërtimit të tyre me një gjuhë të pastër, të pasur e të bukur, me qëllim që duke zbuluar vlerat e saj, ajo të luante edhe rolin e vet edukativ për rritjen e dashurisë për gjuhën e mëmës dhe të atdheut në përgjithësi. Kështu, në një tekst leximi të kohës, lexojmë: *“Sa i ëmbël dhe i dashur është emri i ATDHEUT!*
2. Gazeta “Liri e Shqipërisë”, 11. 06. 1913.

Po kujt i themi ATDHE? Të gjitha aty janë të bukura e të dashura... Aty ku dheu është i gatuar me gjakun e të parëve tanë, të prindërve tanë që ranë në fushën e nderit duke luftuar trimërisht kundër armiqve, atij vendi i themi ATDHE. Ai është ATDHEU ynë që e nderojmë dhe e duam me gjithë shpirt”.

Me gjithë vështirësitë e kohës, të brendshme dhe të jashtme, optimizmi që shprehte ato ditë Ismail Qemali, se *“shqiptarët nuk do të vonojnë për të marrë në dorë armën e mësimin kombëtar”* u realizua dhe koha vërtetoi shpejt parashikimin e tij.

Qenë pedagogët dhe didaktët e arsimit kombëtar, si: Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Lef Nosi, Aleksandër Xhuvani, Sotir Peçi, Sali Gjuka, Kristo Floqi që së bashku me mësuesit e parë të emëruar nga ajo Qeveri, si: Avni Rustemi, Baba Dudë Karbunara, Jani Minga, Ahmet Gashi, Mati Logoreci, Kolë Zezaj, Abedin Çausi, Kolë Kamsi, Ismail Anamali, Gaspër Mikeli, Adem Sharofi etj., që duke u ushqyer edhe nga dashuria e popullit për arsimin dhe gjuhën shqipe, hodhën themelet e një shkolle të re. Ajo, nga një anë ishte vazhdim i shkollës kombëtare të Rilindjes me frymë atdhetare, demokratike, laike dhe iluministe dhe, nga ana tjetër, në pikëpamje organizative, ishte shtetërore dhe e detyrueshme, kështuqë hapi një faqe të re në historinë e arsimit shqiptar.

Me formimin e Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Përtashme

të Vlorës, siç thamë edhe më lart, u ngritën shumë shkolla fillore në të gjithë vendin. Nevoja që e ndjeshme, veçanërisht për tekste mësimore që thuajse mungonin tërësisht. Gjatë këtyre viteve vazhduan veprimtarinë e tyre shtypshkronjat ekzistuese, si: **“Mbrothësia”** e Sofjes, **“Zoja e Papërlyeme”** e **“Nikaj”** të Shkodrës, **“Dhori Kote”** e Korçës, **Shtypshkronjat e Vlorës** etj., por u krijuan edhe disa të tjera. Ato dhanë një kontribut të madh në botimin e teksteve shkollore e, në veçanti, të abetareve.

Shumë autorë shqiptarë të fushës së didaktikës, si: N. Lako, G. Beltoja, M. Logoreci, J. Minga, P. Qiriazi, Th. Papapano, Dh. Paparisto, K. Kamsi, Sh. Daiu, J. Erebara etj., dhanë ndihmesën e tyre në këtë fushë gjatë kësaj periudhe.

Qenia e një shkolle normale siç që ajo e Elbasanit dhe më vonë e asaj të Shkodrës, funksionimi pranë tyre i shkollave ushtrimore; qarkullimi i revistave pedagogjike, si: **“Kumtari Arsimuer”**, **“Shkolla e Re”**, **“Revista Pedagogjike”**, **“Mësuesi”** e deri te **“Shkolla Kombtare”**, ndihmuan shumë në krijimin e një opinioni profesional arsimor me pretendime për ngritjen e nivelit të vazhdueshëm të teksteve mësimore, por edhe të teksteve ndihmëse që thuajse mungonin krejtësisht. Të kësaj periudhe janë edhe metodikat e para. Nga disa autorë pati përpjekje që tekstet

e tyre t'i shoqëronin edhe me tekste ndihmëse ose me **“Librin e Mësuesit”** ose me udhëzime metodike për zbatimin dhe përdorimin e tyre.

Meqë pjesa më e madhe e shkollave në këtë periudhë ishin vetëm me klasa të para, iu kushtua vëmendje e veçantë hartimit dhe botimit të abetareve shqipe, si teksti i parë për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe, prej nga fillon edhe kultura e arsimimi i kultivuar.

Paraqitur në mënyrë kronologjike, pasqyra e abetareve shqipe të botuara, sipas viteve, paraqitet si më poshtë:

- **Më 1912 - 7 abetare.** Nga të cilat përmendim: **“Abetari i vogël shqyp”**, Shtyp. “Nikaj”, Shkodër; Diogjen Harito, si botues publikon dy tekste për klasën e parë: **“Abetari i gjuhës shqipe”**, Mot i parë, Athinë, 62 f. me il. dhe **“Shtimi i Abetarit shqip për çunat”**, po në Athinë. (Studiuesit i kanë quajtur këto dy tekste si punime të Luigj Gurakuqit, ndërsa Harito është vetëm botuesi.)³ **“Abetari për fmit qi msojnë shqip-italisht”**, Për mësimoret e Shqipërisë (Titulli edhe italisht), Shtypshkronja “Antonio Valardi”, Milano, 64 f. me ilustrime + një hartë;⁴ një tjetër botim anonim,

3. Një paraqitje të plotë të botimeve të Luigj Gurakuqit ka bërë Vehbi Hoti në librin, cituar në bibliografi, faqet 233-258. Kreu V (Tekstet mësimore të L. Gurakuqit...)

4. Lindita Kazazi - Nj. Kazazi, “Abetaret

me editor Lef Nosin, **“Abetare shqipe për djelmohët gegë”**, Shtypje e parë, Shtypshkronja Tregtare Ndërkombëtare, Manastir, 16 f. si dhe **“Abeceja shqipe e Kumanovës”**, botim i Klubit shqiptar të Kumanovës, me autor anonim, (që mendohet se është e Jashar Erëbarës). Kjo abetare u botua si suplement i gazetës “Shkupi”, Shkup, 1912.

- **Më 1913** vijojnë dy tekste, një anonim titulluar **“Përkryesimi i abetarit shqyp- italisht”** (Il complemento del silabario albanese-italiano), Për mësimoret e Shqipërisë, botuar në Milano dhe Nikolla Lako boton **“Këndim për radhën e parë”**, Me shumë fytyra, Cop’ e tretë, Paris, 72 f. me il.

- **Më 1914 - 15**, gjithsej **5 tekste**. Njëra është **një abetare e Kolë Kamsit**, botuar në Bari dhe **dy janë anonime**, me titull thuajse të njëjtë, me disa ndryshime në numrin e faqeve dhe në përmbajtjen e tyre. Jashar Agjahu boton **“Abetarja shqipe”**, Rreshtue prej..., Botue prej Ismail Zenel Mborjes, Shtypsh. “Korça”, 14 f. Është i rëndësishëm edhe një botim i tretë i **“Abetare për shkollat e para”** i P. D. Qirias në Worçester.

shqipe dhe Pavarësia Kombëtare, vështrim rreth abetareve dygjuhëshe shqip-italisht”, Botim i USH “L. Gurakuqi”, FSHSH, ISA, “Pavarësia e Shqipërisë dhe Albanologjia” Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, Studime shqiptare - 21, Shkodër, 2015, f. 347-350.

-**Në vitin 1916** u botuan **2 abetare**, njëra nga të cilat e autorit të abetareve dhe të teksteve shkollore, poetit të mirënjohur, Ndre Mjeda.

-**Në vitet 1917-1919** mund të përmendim abetaret e autorëve: Marko La Piana (Marco La Piana), Viskë Pulës, Thoma Papa Panos, Dhimitër Paparistos me editor Lef Nosin, Shefqet Daiut.

-**Në vitin 1920** u botuan shumë abetare, **7 tekste** të tilla. Në këtë vit, që fillon edhe një fazë e re në hartimin e abetareve shqipe, sa i përket metodës së përdorur dhe fillimit të botimit të teksteve në ndihmë të mësuesit. Kjo lidhet me botimin nga Shtypshkronja e “Zojës së Papërlyeme” të tekstit anonim me titull **“Abetare për shkollat fillestare të Shqypnis...”** **“LIBRIN E MËSUESIT** për përdorim të abetarit” të Mati Logorecit që mbyll serinë prej tre tekstesh që fillon me **“Abetar”** / hartue prej Mati Logorecit / vazhdon me **“Plotsorine abetarit”**.⁵

Si veçori themelore të botimeve të kësaj periudhe mendojmë se janë:

Vazhdohen disa cilësi të abetareve të Rilindjes Kombëtare e të pragut të Pavarësisë.

Ka një shtim të numrit të tyre në gjithë vendin dhe në kolonitë

5. Shefik Osmani - Njazi Kazazi, “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”, Botim i MASH dhe Shtëpisë “Idromeno”. Tiranë, 2000, f. 135- 224.

shqiptare, si nevojë e kohës dhe për t'iu përgjigjur vrullit të hapjes së shkollave.

Në ndonjë tekst shfrytëzohet përvoja botërore, siç është rasti me **“Abetare për shkollë fillestare të Shqipnis mas methudhës analitiko-synthetike** të shkrimit e të leximit” / Me fotografi të Fatosit Kruetanë / E para dorë / Shtypshkronja e “Zojës së Papërlyeme”. Shkodër, 1920, ku shtjellohen metodikisht, në mënyrë të hollësishme, qëllimi dhe mjetet e mësimit, sipas didaktit të njohur gjerman Prof. S. R. Hofman. Në librin në fjalë jepet dhe një plankonspekt i zhvillimit të mësimit në ndihmë të mësuesve që do ta zbatonin. Vend të veçantë në historinë e didaktikës shqiptare, zë **“Libri i Mësuesit”**, i botuar në Vlorë nga Mati Logoreci, në fillimin e viteve '20, ku shihet qartë niveli i përpunimit metodik të didaktikës së gjuhës shqipe në shkollat fillore. Mësuesit shqiptarë të arsimit fillor ishin futur në rrjedhat e kërkesave didaktike bashkëkohore.

Në përmbajtje ato përshkohen nga idetë e çlirimit nga pushtuesit dhe të futjes së kombit në rrugën e përparimit, duke e konsideruar mësimin e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e arsimit si një ndër rrugët më të efektshme për të realizuar këto qëllime.

Të gjitha këto tekste, veç qëllimit themelor për t'ua mësuar breznive të reja, por edhe më gjerë gjuhën e

shkruar shqipe, transmetojnë edhe mesazhe morale dhe synojnë të edukojnë te lexuesit dashurinë për atdheun, mirësinë, mirëkuptimin, bashkimin e vëllazërimin mes shqiptarëve pa dallim krahine, feje a ideje.

4. Planet, programet e teksteve për mësimin e gjuhës shqipe

4.1. Programet

Programi mësimor është një dokument (shtetëror ose privat) bazë, i cili përcakton përmbajtjen e një lënde si dhe metodën (a metodat) që do të ndiqet për përvetësimin e kërkesave të saj.

Në program përcaktohen qëllimet dhe detyrat mësimore, vëllimi i njohurive, shkathtësive dhe shprehive praktike që duhet të përvetësojnë nxënësit gjatë punës me këtë tekst mësimor, në një klasë të caktuar.

Programi ndryshon në bazë të hapave përpara që bën didaktika, risive që sjell në praktikën e përditshme mësimore si dhe arritjeve në fushën e teknikës së të mësuarit. Mbi këtë bazë përpunohen dhe ndryshojnë edhe metodat.

Nga një vëzhgim i përgjithshëm që u kemi bërë programeve dhe paralelisht me to edhe atyre teksteve mësimore të gjuhës shqipe, të botuara deri në dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX, kuptojmë se ato kanë ndryshuar herë pas here, gjithnjë me synimin që të përsosen,

të bëhen më të zbatueshme dhe, mbi të gjitha, të realizojnë sa më mirë detyrat themelore për aftësimin e nxënësve për të folur dhe shkruar qartë gjuhën amtare. Kjo është e natyrshme, ndryshimet e programeve kanë pasqyruar kthesat e mëdha që ka shënuar didaktika, gjuhësia, pedagogjia, psikologjia, teknika etj. Madje ato shpesh nuk kanë arritur të pasqyrojnë hapat që ka bërë didaktika dhe përshtatjet që duhej t'i bëheshin teksteve në bazë të veçorive që ka gjuha jonë.

Deri me botimin e programeve të para, gjuha shqipe dhe tekstet për mësimin e saj, nuk janë ndërtuar mbi bazën e programeve të miratuara më parë. Kjo për arsye se në fillimet e tyre mësonjëtoret e para (shkollat me klasa të para) nuk kanë qenë institucione shtetërore kombëtare, por edhe më vonë, megjithëse ka pasur programe, atyre u kanë munguar programet analitike. Vetëm në periudhën e funksionimit normal të institucioneve arsimore, deri te Ministria e Arsimit, në shtetin e pavarur shqiptar, hartimi dhe zbatimi i teksteve të gjuhës shqipe iu nënshtrua programeve shtetërore.

Si program i parë, i botuar dhe i njohur deri tani, është ai i vitit 1915 titulluar **“Programma analitike e shkollës fillore e të shkollës së mesme”**, miratuar nga Qeveria e Durrësit, botuar po në këtë qytet. Në një periudhë tepër të shkurtër, deri në fillimin e viteve ‘20 pas daljes

së botimit të sipërshënuar, ka pasur një denduri programesh, të botuara nga zona, qarqe administrative e drejtori arsimore në të gjithë vendin, që kanë luajtur rol të rëndësishëm në forcimin e disiplinës shkencore në shkollat ku u zbatuan.

Një vit më pas, më 1916, është zbatuar në zonën e Shkodrës një program shkollor sipas modelit të shkollave austro-hungareze e për të cilin nuk është folur.⁶ Programi në fjalë përbëhet prej 10 faqesh të daktilografuara. Me një shkresë përcjellëse shoqëruese, në shqip dhe në gjermanisht, i dërgohej Kryekomandës së Trupave të Ushtrisë Austro-Hungareze, në Shkodër, më 18.10.1916. Në këtë dokument shkollor, me të cilin mendojmë se kanë punuar shkollat e Shkodrës në vitin shkollor 1916-1917, veç udhëzimeve në përgjithësi, jepet edhe plani mësimor i shkollës fillore me 5 rende si dhe programi analitik për çdo lëndë. Në bazë të këtyre të dhënave, gjuha e mësimin zinte përkatësisht nga 12, 10, 8 e 6 orë mësimore në javë, për çdo rend, duke filluar nga klasa e parë.

Sipas këtij programi, në këtë lëndë kryesore, në përfundim të 5 viteve, nxënësit duhet të jenë të aftë që *“...të mund të kuptojnë kthjellësisht dëftimet e të tjerëve në gjuhë amtare, të këndojnë me shpejtim e me ndjesi të plotë çfarëdo shkrimi, si dore ashtu edhe shtypi, të fitojë zotënimin me dëftue mendimet e*

6. AQSH, F. 295, D. 2, V. 1917, Fl. 1-12.

*veta, në një mënyrë të bukur e të kthjelltë, si me gojë ashtu edhe me shkrim...*⁷ po kështu jepen edhe synimet konkrete për secilën klasë.

Mendojmë që ky program u zbatua në zonat që varehin nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me qendër në Shkodër, jo më tepër se 3 vjet, mbasi më 1919 e në vazhdim u zbatuan programet e didaktit të njohur, G. Beltoja, i cili më 1919, botoi **“Programi i së I e së II klasë fillore, të pjestuemit e tij e disa tema të zhvillueme metodikisht”** e që vazhdoi në vitin 1920 edhe me botimet e Programeve të kl. III-IV dhe të kl. V të shkollës fillore.

Në fillimin e viteve ‘20 të shek. XX e në vazhdim u botuan edhe shumë programe të tjera si:

- **“Programi analitik i shkollave të Qarkut të Korçës”** për vitin 1-918/1919, Korçë, 1918 dhe ribotim i tij më 1919 (përkatësisht me 12 dhe 7 faqe.)

- **“Programi analitik për katër rendet e shkollave fillore të Krahinës së Gjirokastrës”**, për vitin shkollor 191-9/1920.

- **“Programi i zbërthyer i lëndës së mësueme në shkollat fillore të Qarkut të Vlorës”**, për vitin 1920 - 1921, Vlorë, 1920, hartuar nga Jani Minga.

- **“Programa sintetike-analitike e shkollave fillore”**, Shkodër, 1921.

- **“Programa sintetike-**

7. Po aty, f. 4.

analytike e shkollave fillore”, Elbasan, 1922 etj., programe për kategori të tjera shkollash që u botuan në shtetin e pavarur shqiptar, ku në secilin ka zënë vend të rëndësishëm gjuha amtare dhe në veçanti mësimi i lexim-shkrimit në klasën e parë, për vetë vështirësitë që paraqet ky proces, por edhe për ndikimet që ka në vitet e mëvonshme. Duke qenë se tekstet për mësimin e gjuhës shqipe të shkruar, duke filluar me Abetaren, kanë të bëjnë me formimin e fëmijëve në zanafillën e jetës së tyre, por edhe ndikojnë në ecurinë e mëtejshme të tij në gjithë kohën e shkollimit dhe më gjerë edhe në jetë, shoqëria investon që ai të pasqyrojë arritjet e fundit në fushën e vet. Jo më kot në historinë e arsimit botëror vetë titullarë të institucioneve qendrore arsimore ose pedagogë e shkencëtarë të njohur, kanë qenë dhe autorë të këtyre teksteve. Një dukuri e tillë vihet re edhe në historinë e tekstologjisë shqiptare që nga Sami Frashëri që botoi veç **5 abetareve** edhe **“Shkronjëtores e gjuhës shqip”** (1886), si një ndër gramatikat e para shkollore për mësonjëtores shqipe, që së bashku me abetaret përbënin tekstet themelore për mësimin e gjuhës shqipe të shkruar⁸; Luigi Gurakuqi, ministër i parë i arsimit; Gaspër Beltoja, drejtor i arsimit të

8. Shefik Osmani - Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe...”, Botim i MASH dhe Shtëpisë “Idromeno”. Tiranë, 2000, f. 93-108 dhe 112-117.

Shkodrës, e më vonë: Aleksandër Xhuvani, zv/ministër i arsimit; Pertef Pogoni, didakt i shquar; etj. etj., për shumë vite me radhë kanë qenë autorë të abetareve dhe të teksteve të gjuhës shqipe.

Me normalizimin e punës mësimore në shkollë, me përcaktimin e qartë të strukturës mësimore dhe të ndarjes së lëndëve veç e veç, (kujtojmë se në fillimet e tyre p.sh. abetaret shqipe, përveç synimit të tyre themelor: formimit të shprehive të lexim-shkrimit të nxënësit, shpesh kryenin edhe funksionin e tekstit të këndimit, madje jepnin edhe njohuri të thjeshta nga historia, dituria e natyrës, gjeografia etj.), tekstet e gjuhës shqipe “*u profilizuan si të tilla*” për dhënien e përvetësimin e njohurive, shkathësive dhe shprehive të gjuhës amtare.

4. 2. Programet e Gasper Beltojës⁹

Siç e kemi theksuar edhe më parë, didakti Gasper Beltoja i siguroi vetes një vend të nderuar në historinë e arsimit shqiptar me botimin e programit për pesë klasë fillore, në vitet 1919-1920. Ndoshta vetëm pas kësaj autori do të ndjehej disi i lehtësuar dhe i kënaqur për detyrën që kishte kryer. Kjo kuptohet edhe

9. Vehbi Hoti, “*Gaspar Beltoja dhe vepra e tij arsimore dhe pedagogjike*” në BSH i USH, SSHD, Nr. 1 (49), 1997-2001, f. 119-125. Unë do të ndalem në analizën e gjuhës shqipe në këto programe.

nga fjalët e tij “*Një me mund të thohet se në gjuhë shqipe ka një metodikë për pesë klasët fillore.*”¹⁰

Ky program përbënte një ndihmesë të rëndësishme për sistemin arsimor që ishte në fazat e para të jetës së tij dhe ishte i destinuar për t’u zbatuar në shkollat fillore të Shkodrës dhe më gjerë.

Nga “*Parafjala*” e programit, autori na lë të kuptojmë se kanë qenë qëllimet e tij arsimore bashkë me ato atdhetare që e shtynë për t’i hyrë këtij “*shtegu*”, ku nuk kishin kaluar shumë të tjerë. Koncepti i tij rreth rolit të mësuesit të gjuhës shqipe e kishte embrionin që në Rilindje dhe erdhi e u konsolidua në këto vite. Sipas Beltojës, zhvillimi i kulturës së një kombi dhe e ardhmja e tij varen nga “*afërsimi i mësuesve*”.

Synimi i autorit duket qartë që në “**Parafjalën**” e tij ku thotë: “...shpresoj se këto shembulla të zhvillueme metodikësisht kanë për t’u vjeftun shumë mësuesve me mirasue të dhanunin e mësimit...”. Ai, duke njohur përvojën evropiane, shton se “... në lamë të metodikës...ka ndryshime ndërmjet kombesh, por dhe ndërmjet mësuesve të një kombi, mbasi ajo asht e gjanë e len mjaft shesh m’u hallakatë...” e “për këtë shkak i shtyem prej dëshirë të mirasuemit t’arsimit në Shqypni po u paraqes këto shembulla kolegve të mij me shpresa qi edhe ata, tue i pa t’arsyeshme, kanë për t’i shti në veprim.”¹¹

10. Gasper Beltoja, “Programi...”, Shtypshkronja e “Arësimit”. Shkodër, 1919, f. 4.

11. Po aty, f. 1.

Në “Vërejtje të përgjithshme” autori në mënyrë të qartë dhe koncize jep përcaktimet e tij për qëllimin e shkollës shqipe, të drejtat dhe detyrat e mësuesit, konceptin e programit si dhe arsyet pse është i nevojshëm programi.

Ai i njeh shkollës një rol të madh në formimin e personalitetit të njeriut, sepse shprehet: “*Shkolla popullore ka për qëllim të rriturit e djelmënisë n’urti, e n’besim, e zhvillimin e fuqivet mendore të nxanësve të njomë, tue u dhanë ato mësimë e njohsi të cillat të shtueme, e të përmirësueme ma vonë do të munden të përbajnë prej sish burra të ndersbëm e qytetas të vjefsbëm*”.¹²

Ndërsa për arritjen e këtij qëllimi mësuesi kishte për detyrë të përdorte të gjitha mënyrat e mjetet që i “*urdbënonte ligji dhe ato që i këshillon pedagogjia*”, sepse në të kundërt “*në qoftë se mësimi do të lebej në dorë e në mendje të se të cillit mësues...*” ky qëllim nuk do të realizohej. Në këtë mënyrë plani i tij arsimor do të ndihmonte në koordinimin e punës së të gjithë mësuesve.

Për hartimin e këtij plan-programi, autori është mbështetur në parime pedagogjike dhe shkencore, e kjo ndjehet që në konceptin e tij për programin shkollor. “*Plani i arësimit, shkruan Beltoja, dubet të shënojë e të caktojë skajet e së të cillës landë mësimi mbas përllimit të shkollës fillore, dubet të dajë edhe se të cillën landë, klasë për klasë, ashtu si e kërkon të rriturit e mendjes së nxënësve.*”¹³

12. Po aty, f. 1.

13. Po aty, f. 2.

Për të ndjekur zbatimin e programit ai ngarkon drejtorët e shkollave, ndërsa mësuesi duhej të shënonte çdo javë në regjistër, shkurt lëndën e zhvilluar.

Programet e hartuara nga G. Beltoja janë analitike dhe u drejtohen mësuesve të pesë klasave të fillores, të shkollave popullore shqiptare. Në të paraqiten planet mësimore të shkollës.

Për **klasën e parë** shënohen të detyrueshme këto lëndë:

1. Besim.
2. Gjuhë mësimi (mësim shkrimi, këndim, shkrim dhe ortografi, ushtrime gramatikore).
3. Arithmetikë.
4. Kaligrafi.
5. Vizatim.
6. Kangë.
7. Gimnastikë.
8. Punë dore (për varza).

Vërejtjet dhe synimet e përgjithshme jepen në fillim të programit, për çdo lëndë dhe për çdo klasë. Kështu për gjuhën shqipe shkruhet:

Gjuhë mësimi - “*Mësimi i gjuhës ka për qëllim, qi, në krye të pesë vjetëve, nxanësit të mund të kuptojnë këthjelltësisht diftimit e të tjerëve në gjuhë amtare; të këndojnë me shpejtim e me ndisi të plotë çfarëdo shkrimi si dore ashtu edhe shtypi e të tregojnë zotnimin me diftue mendimet e veta me një mënyrë të bukur e të kthjellët, si me gojë ashtu me shkrim*».¹⁴

14. Gasper Beltoja, Programi për kl. I-II...,

Këndim-shkrim: - **“Ushtime zanash e germash, në shkrim dore e shtypi; këndim i kadalshëm e me zâ; ligjërime mbi sende të këndueme. Ushtime të lehta përshkrimi prej librit të këndimit. Të përthanun e të xanun përmendsh copash të zgjedhuna, sidomos në vjershë”**.¹⁵

Nga konsultimi i programit me synimin për të parë dhe evidentuar si duhet të jetë realizuar mësimi i lexim-shkrimit (këndim- shkrimit) rreth 80 vjet më parë, po vëmë në dukje këto veçori:

- Gjuha e mësimin në klasën e parë zinte rreth 12 orë në javë, nga 21-22 gjithsej, gjë që përcaktohej nga sasia e orëve të besimit, me këtë nëndarje: a. këndim-shkrimi - 7 orë, b. mësim shikimi - 3 orë, c. përmendësh - 2 orë.

- Orët e mësimin, sipas orarit të dhënë, ishin të ndara në paradreke dhe pasdreke: 8-9 e 9-10, paradreke; 2-3 e 3-4 pasdreke.¹⁶

- Vend jo të vogël në program zë dhe përsëritja a sistemimi i lëndës, rimarrja herë pas here e njohurive të zhvilluara më parë. Në këtë program caktohen për këtë problem 2 javë gjatë vitit mësimor dhe 4 javë në fund të tij.

Lënda e abetares, pra mësimi i lexim- shkrimit, zhvillohej gjatë gjithë vitit. Viti kishte gjithsej 36 javë mësimore, nga tetori deri në fillim të qershorit, pra 9 muaj të plotë.

Shkodër, 1919, f. 2.

15. Po aty, f. 2.

16. Po aty, f. 5-6.

Mbi bazën e kësaj përvoje të pasur që kishte grumbulluar, më 1921 Beltoja botoi **“LIBËR I PARË apo Abetar për Shkolla Fillore të Shqypnis” / Përpiluem e mbledhë prej G. Beltojës, Drejtorit t’Arsimit të Shkodrës/**. Teksti, prej 56 faqesh, është botim i shtypshkronjës “Nikaj” në Shkodër.

Në libër zbatohen parimet themelore të **“Programit të së I dhe së II klasë fillore, të pjestuemit e tij e disa thema të zhvillueme methodikisht”**, Shtypshkrojtë e “ARËSIMIT”, Shkodër, 1919, të huazuara nga modelet austriake.

Po t’i hedhim një vështrim abetares së G. Beltojës, do të vëmë re se më parë është mësuar shkrimi dhe pastaj leximi, proces që sot zhvillohet në të kundërt. Në abetaret e botuara deri në atë kohë nuk ka pasur një linjë të njëjtë dhe të pandryshueshme për këtë problem, kështu që herë është filluar nga shkronjat e shtypin dhe herë me shkronjat e dorës, por gjithnjë mësimi i leximit dhe i shkrimit janë kuptuar dhe zbatuar si një proces i ndërsjellë e për rrjedhojë janë zhvilluar paralelisht. Në këtë abetare pas mbarimit të shkronjave të vogla të dorës e të shtypit, jepen të mëdhatë, që zënë katër javë mësimore.

Ndryshe nga shumë abetare të tjera, këtu nuk ka asnjë pjesë leximi. Në fund të çdo mësimi vihen disa fjali të shkëputura që nuk përbëjnë tekste.

G. Beltoja, ithtar i pedagogjisë herbartiane në ato vite,¹⁷ i nisur nga nevojat, për të ndihmuar metodikisht mësuesit në procesin e mësimdhënies së abetares, në programin e hartuar nga ai, jep edhe modele për këtë proces. Po japim më poshtë zhvillimin e një ore mësimi, ashtu si e rekomandonte Beltoja.

Themë: Lexim e Shkrim

Njësi methodike: Të mësuesit e germës “u”.

1. *Gatim:* Të përshkruemit e urithit.

2. *Qëllim:* Sot duem me xanë një germë të re.

3. *Të paraqitun:*

a. Të fituemit e tingullës.

b. Të shkruemit e germës në tabelë.

c. Të ndamit e saj në pjesë.

d. Të diftuemit e u-së të shtypshkronjës.

e. Gjasimi me kafshë (në qoftë se ka).

f. Të përdorunit e u-së në esklamacione (në qoftë se ka).

g. Të thanun prej anës së nrxanësve fjalë që fillojnë me “u”.

4. Të përmbledhun:

a. Të përbamit e “u”-së prej pjesëve të saja.

b. Ndryshimet a ngjasimet e u-së së dorëshkrimit me u-në e shtypshkrimit.

c. Ndryshimet apo gjasimet e u-së me i-në.

Tingujt-shkronjat e gjuhës shqipe jepeshin në 12 javë, mesatarisht nga 3 në javë, por disa prej tyre përsëriteshin dhe rimerreshin pas disa orësh, më qëllim përforcimi dhe krijimin e shprehive në të lexuar.

Sa i përket metodës, ndiqej rruga e zakonshme e deriatëhershme, e zbatuar në dhjetëra abetare, për më se një shekull: fillohet me dy-tri zanore, vazhdohet me disa bashkëtingëllore e kështu me radhë në rrokje, fjalë dhe fjali të thjeshta. Abetarja në fjalë është ndërtuar sipas metodave sintetike: e tingujve dhe rrokjesore.

Si didakt me përvojë të gjatë, Beltoja “...tue pasë sprovue ndër sa vjet shërbimi sa mënyra methodike...” bën kujdes, duke rritur ngarkesën në mënyrë të natyrshme, nga tema në temë.

Në tekst gjejnë përdorim të gjerë zanoret hundore si dhe dukuri të tjera të gegërishtes veripërendimore.

Në bazë të përvojës botërore autori e ilustron abetaren e tij. Në fillim të faqes vendos një figurë, emri i së cilës fillon me shkronjën e re që mësohet.

Autori i kushton gjithashtu vend të rëndësishëm grupeve të bashkëtingëlloreve dhe përvetësimit të tyre, duke filluar me dy bashkëtingëllore të njëpasnjëshme, si: *st, bl, mb, nd, ng* e deri me tri-katër të tilla, si: *zdr, zhdr, shtr, shkr, shndr etj.* Nisur nga vështirësinë që paraqesin

17. Shefik Osmani, “Dy linja paralele në botimet e didaktit Gaspër Beltoja”, - “Revista pedagogjike”, 1997 / 2, f. 105-112.

këto, autori u kushton disa javë mësimore në program.

Teksti zbaton parimet shkencore e didaktike të përcaktuara në “Programet shkollore...” të hartuara nga vetë Beltoja.

Edhe në programet në vazhdim, për kl. II-V, autori ka përcaktuar lëndët e detyrueshme për çdo klasë (të cilat variojnë nga 8 deri në 11), orët përkatëse në javë, qëllimin (objektivat) e secilës lëndë, strukturën javore të vitit shkollor... etj.

Në këtë kontekst fare lehtë mund të dallojmë se lënda, së cilës i është dhënë një përparësi e dukshme, gjithnjë ka qenë gjuha shqipe.

Në qoftë se studiojmë shpërndarjen e lëndëve mësimore sipas strukturës javore të vitit shkollor, në të gjitha klasat, rezulton se kjo është bërë duke pasur parasysh aftësitë dhe shprehitë që duhet të zotërojë nxënësi pasi të mbarojë klasën e pestë, aftësi dhe shprehi këto teoriko-praktike, si: “... të kuptojë... mendimet e të tjerëve në gjuhë amtare, të këndojë me shpejtë...” dhe “... të fitojë zotënimin me dëftue mendimet e veta...”.

Kjo mund të shihet më qartë nga një model ore mësimi në gramatikë siç e sugjeron Beltoja:

Themë: **Gramatikë**¹⁸

Njësi metodike: **Folja**

Merendim (disiposicjon)

Gatim: *Të përsriturit e të damit të*

18. G. Beltoja, “Programi...”, Shtypshkronja e “Arësimit”, Shkodër, 1919, f. 43- 44.

copës së leximit në kinda e të kindave në folje.

Qëllim: *Sot po duem me xanë mbi foljen...*

Të paraqitun: a. *Të përbamit e disa foljeve.*

b. *Subjekti e predikati.*

Të përmbledhun: *Të përqendruemit e lëndës.*

Ushtrim: a. *Të gjetunit foljesh në tabelë.*

b. *Të përbamit foljesh me shkrim.*

Kush apo shka ?	1. <i>Dielli asht i shndritshëm...</i>	Si asht ?
	2. <i>Delja blegron...</i>	Shka ban ?
	3. <i>Gruni korret...</i>	Shka pson ?

Nga programi dhe zhvillimi i hollësishëm i kësaj teme nga gramatika theksojmë se:

Mësuesi nuk e fillon shpjegimin menjëherë me dhënien e koncepteve teorike (në rastin konkret të foljes, subjektit, predikatit...etj).

Për të ardhur tek teoria mësuesi përdor një argument didaktik që më të shumtën e rasteve është një tekst letrar (në rastin tonë “Ma e para lule”).

Nëpërmjet pyetjeve mësuesi ndihmon nxënësin të operojë me tekstin derisa të arrijë te koncepti që do të shpjegohet (këtu: *Po kindat në shka i kena da?... -në folje...*).

Vetëm pas një shpjegimi shumë të qartë, me aktivizimin herë pas here të nxënësve, dhe çka është më

e veçanta, pas një përmbledhjeje të informacionit, mund të fillohej me punimin e ushtrimeve.

Siç shihet, pothuajse të gjitha elementet e kësaj ore janë të njëjtë me kërkesat dhe udhëzimet që jepen në programet e sotme për zhvillimin e një ore mësimi në lëndën e gjuhës shqipe.

Sa i përket metodës që ndiqet, duhet thënë se:

Nuk ekziston ndonjë rregullsi (radhë) në dhënien e njohurive nga fonetika, morfologjia, sintaksa... etj. përkundrazi kemi një ndërthurje të tyre, siç ndodh në programet e sotme. Kështu në klasën e dytë fillohet me foljen, kalohet në sintaksë me predikatin, vijon më pas emri për dhjetë javë e me radhë mbiemri, përemri etj.

Rimerren koncepte brenda së njëjtës klasë, duke shtuar elemente të reja. Në klasën e dytë rimerret predikati duke thënë llojet e tij; e njëjta gjë edhe për foljen, duke thënë kohët e para.

Rimerren njohuritë nga klasa në klasë duke u zgjeruar vëllimi dhe cilësia e tyre. Kështu në klasën e dytë nëse informacioni për foljen kufizohet vetëm te numri dhe kohët e para, në klasën e tretë, mund të flitej për folje ndihmëtare (ndihmëse), mënyrat e foljes, llojet etj.

Ushtrimet drejtshkrimore zënë një vend të konsiderueshëm në këtë program mësimor. Në klasën e tretë këtyre ushtrimeve u kushtohen tetë

javë mësimore, java e parë e çdo muaji dhe ato konsistojnë në të shkruarit drejt të fjalëve me: zanoret i, u, e, a, y, e.

Bashkëtingëlloret e ndryshme, si: z, ç, x, q, gj, dh, ll, rr, nj, sh, zh, th...

Grupe bashkëtingëlloresh: mb, nd, ng, br, kll, pl, fl, kr, krr, zhg, skll...etj.

Ndërsa në klasën e tretë, ushtrimet gramatikore përqendrohen në shenjat e pikësimit.

Përsëritja e njohurive shikohej si mënyra më e mirë që nxënësit t'i fiksojnë njohuritë dhe t'i kthejnë në shprehje praktike. Në klasën e tretë, p.sh. i kushtohen më se tetë javë përsëritjes, gjatë gjithë vitit shkollor.

Nuk synohet vetëm përvetësimi mekanik i njohurive teorike, por paralelisht me këtë edhe krijimi i shprehjeve praktike. Kjo dëshmohet më së miri tek: "*Rregulla mbi gramatikë*", ku autori shtron disa mendime dhe udhëzime, gjithnjë me synimin për të ndihmuar mësuesit në zhvillimin e gramatikës. Ndërmjet të tjerave ai thotë: "*Mësimi i gramatikës asht një send abstrakt e i vështirë e kishte për me qenë krejt i paarsyeshëm e kishte për t'i mërzi të nxanësit në qoftë qi mësuesi nuk zhvillon këtë mësim prej gjuhës, veç i ngarkon fmit me rregulla të thata, të cilat mas disa kobe barrohen. Nxianësit bien në shkollë përgjithësisht një njohtim të mirë gjuhe, në përpjesitim të kërcikut të tyre, e në themel të këtij njoftimi mësuesi do të drejtojë gramatikisht*

shka fëmija di e do të ndërtojë e plotësojë lëndën e gjuhës me një mënyrë qi nxënësit me kohë të bahen të zotët me i dëftue mendimet e veta si me gojë ashtu me shkrim sikur i përket një njerit të dhenun".¹⁹

Autori i programit sugjeron gjithashtu se meqë ende nuk ishte caktuar një gjuhë shkrimi, mësuesit brenda mundësive të jepnin njohuri për të dy dialektet, pra: në qoftë se nxënësit janë toskë, të kenë njohuri edhe për dialektin gegë; e nëse janë gegë, të dinë diçka për dialektin toskë.

Për mendimin tonë, kulmin e të gjithë punës së tij për programet (flasim për gjuhën shqipe), Gasper Beltoja e ka arritur me dhënien e 8 rregullave që kanë të bëjnë me përgatitjen e mësuesit, të cilat po i sjellim duke menduar se paraqesin interes edhe për mësuesit dhe studentët. Në përgjithësi nuk është prekur struktura e tekstit, me përjashtim të ndonjë ndryshimi të vogël që nuk ka prishur përmbajtjen e tij. Ato janë:

Mësimi i gramatikës do të fillojë analitikisht d.m.th. prej unitetit në pjesë, prej të përgjithshmes tek e veçanta, prej shembujve në rregulla e me njohuritë e fituara në këtë rrugë, ndërtohen sintetikisht, d.m.th. prej pjesëve në unitet, prej të veçantës në të përgjithshme e prej rregullës në shembuj, folje e hartime.

Mësimi i gramatikës do të
19. Po aty, f. 17.

zhvillohet me pyetje nëpër të cilat mësuesi e ndihmon nxënësin të gjejë vetë trajtat e rregullta gramatikore e ky lloj shpjegimi është më i qartë e mbahet mend më gjatë se asnjë tjetër.

Mënyra e të dhënit mësim të jetë e këndshme si në të folur si në të pruem e do të përcillet interes i gjallë në të zhvilluarit e lëndës (motivimi) pa të cilin mësimi kishte me qenë i vokët e s'kishte për të dhanë frytin e kërkuar.

Mësuesi të përgatitet në mënyrë që ta zotërojë plotësisht lëndën.

Shembujt të shkruhen në tabelë, të rregulluar në një mënyrë që nxënësit të kenë qartë parasysh lëndën për të cilën flitet.

Mësuesi të shohë vetëm temën që asht duke zhvilluar e s'do të flasë vetë as s'do të lerë nxënësit që të pyesin për gjëra që nuk kanë të bëjnë me të.

Temat të zhvillohen plotësisht e s'duhet lënë deri kur shumica e nxënësve ta kenë kuptuar mirë e s'duhet pyetur kurrë rregullat para se mësuesi të shohë se shumica e fëmijëve kanë hyrë vërtet në shpirtin e lëndës.

Pas mëimit të vijë ushtrim i mjaftueshëm, si me gojë edhe me shkrim, sepse ky bën që të nguliten thellë në mendje të nxënësit njohuritë e fituara.²⁰

Besojmë se nuk mund të shpreheshim më saktë dhe më bukur se kaq (për kohën) këto rregulla,

20. Po aty, f. 17- 18.

koncepte dhe argumente të cilat i kanë rezistuar kohës e mund të mbështetemi në to edhe në ditët e sotme gjatë procesit të mësimdhënies së gjuhës shqipe.

Për të krijuar një ide më të plotë mbi çka rekomandon Beltoja, le të shohim edhe një orë gramatikë nga klasa e pestë:

Themë: **Gramatikë**

Njësi metodike: **Folje të lidhuna**
Merendim (dispozicion)

Gatim: Të folunit mbi folje të para e të dyta.

Qëllim: Sot, fëmi, po duem me folë mbi folje të lidhuna (të para, më të para)

Të paraqitun: a. të gjetunit e foljeve të lidhuna me të pvetuna,

b. të shkruemit në tabelë e të vretunit e tyre,

c. të përbandt këso foljesh prej nxanësve.

Të përmbledhun: a. Të përbandruemit e landës,

b. të zhvilluemit e rregullës.

Ushtrim: a. të përbandt këso foljesh prej anës së nxanësve,

b. të gjetunit e këso foljesh në libër,

c. të përbandt këso foljesh me shkrim si punë shkolle ashtu shpije.

* * *

Nga të gjitha këto që thamë mbi programet e G. Beltojës do të ishte me vend të evidentonim disa veçori të tyre dhe ndryshimin e situatës arsimore në Shqipëri, që solli si nevojë botimin e tyre.

Programet e “*numrit një*” të arsimit të Shkodrës (inspektorit të arsimit të Shkodrës), në vitet -1919 1920, ishin hartuar, siç kemi thënë edhe më lart, duke u mbështetur në modelet austriake.

Ato, të lidhura organikisht me njëri-tjetrin, përbënin një metodikë mjaft të dobishme për pesë klasë fillore.

Në këto plane e programe arsimore, gjuha shqipe zë kryet e vendit në rrethin e lëndëve mësimore të çdo klase.

Ndonëse kanë kaluar më shumë se 80 vite, programet janë të një standardi shkencor dhe didaktik të lartë edhe sot.

Shumë nga metodat, udhëzimet... etj., të këtyre programeve përkrijnë me ato të sotmet, gjë që dëshmojnë për aftësitë e mëdha didaktike të autorit duke pasur parasysh mungesën e përvojës së mëparshme në këtë drejtim.

Me botimin e programeve të G. Beltojës mësimi i gjuhës shqipe ngjiti disa shkallë njëherësh në historinë e mësimin të saj në shkollë.

Duke bërë krahasime, aq sa është e mundur, me programet e sotme, gjejmë disa pikëtakime, si: -lëndët për çdo klasë, -strukturën javore të vitit shkollor, -sasinë e orëve javore për çdo lëndë e për çdo klasë, -udhëzime për zbatimin e tij (të cilat në këtë rast përfaqësohen nga modele të orëve të mësimin), -temat për çdo javë (programet e sotme, kapitujt etj.).

4. 3. Vendi i gjuhës shqipe në planet e programet mësimore të viteve 1912-1920

Vitet	Klasat				Dokumentacioni i shfrytëzuar
	I	II	III	IV	
1912	10	6	6	5	Plani mësimor i Mësonjëtores Shqipe të Korçës, "Arsimi Popullor", Nr. 2 / 1963, f. 83.
1915	6	6	5	3	Programma analitike e shkollës fillore e të shkollës së mesme, Durrës, 1915.
1916	12	10	8	8	Programi i shkollave fillore të Shkodrës, f. 3.
1919	12	10	8	8	Programi i G. Beltojës, për kl. I e II, III-IV dhe V fillore, Shkodër, 1919.

4. 4. Tekstet mësimore

Në fillimet e dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XX pati përpjekje dhe arritje të mëdha për hapjen e shkollave. Sipas të dhënave të kohës, numri i shkollave në vitin mësimor 1916-1917, në zonën e pushtimit austriak arriti në 231, ndërsa i mësuesve në 294.²¹ Kjo hapje e vrullshme e shkollave sillte si nevojë të domosdoshme hartimin

21. ISP, Historia e arsimit shqiptar (Maket). Tiranë, 1990, f. 271.

dhe botimin e teksteve për shkollat kombëtare shqiptare. Ishte koha kur për të hedhur themelet e arsimit popullor shqiptar, intelektualëve-atdhetarë-didaktë u duhet jo vetëm të hapnin shkolla, por edhe të organizonin përmbajtjen e shkollës, të hartonin kurrikulat e reja shkollore, në përputhje me synimet e afërta dhe të largëta kombëtare. Rol të dorës së parë në këtë drejtim të rëndësishëm, luajtën ata pedagogë me arsim të kryer në shkollat e Perëndimit.

Bibliografi

- Ashta, Kolë: “Leksiku historik i gjuhës shqipe” - I, Shkodër, 1996.
- Beltoja, Gaspër: “Programi i gjuhës shqipe për kl. I-II”, Shtypshkronja e “Arësimit”. Shkodër, 1919.
- Haxhi, Artan - Topalli, Tefë: “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”, Shkodër, 1999.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike: “Historia e arsimit shqiptar”, Tiranë, 1990.
- Franja, Luigj: “*H-ja nistore në shkrime të vjetra*”, “Hylli i Dritës”, Vjeti XXIII, 1994, Nr. 1-2.
- Frashëri, Sami: “Gjuha Shqip”, në “Alfabetare e gluhëse shqip”, Ndë Konstantinupojë, 1879.
- Frashëri, Sami: “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”. ShBLSH . Tiranë, 1980.
- Gazeta “Liri e Shqipërisë”, 11.06.1913.
- Hoti, Vehbi: “Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar” (Monografi). Biblioteka “Shkodra”, Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Botim i USH “Luigj Gurakuqi”, Tiranë, dhjetor 2002.
- Hoti, Vehbi: “*Gasper Beltoja dhe vepra e tij arsimore e pedagogjike*”, në “Buletin shkencor” i USH, Seria e shkencave didaktike, Viti XXXI i botimit, Nr. 1 (49), 1997-2001.
- Kabineti pedagogjik: “Historiku i arsimit në Shkodër”, Vëllimi I. Shkodër, 1980. (Dorëshkrim).
- Kashari, Qazim: “*Zhvillimi i arsimit kombëtar në fillimet e Pavarësisë*”, -“Revista pedagogjike”, Nr. 3 / 1996.
- Kastrati, Jup: “*Disa të dhëna mbi historikun e arsimit në Shkodër*”, në “Arsimi popullor”, 1964, Nr. 2.
- Kazazi, Lindita - Kazazi, Njazi “Abetaret shqipe dhe Pavarësia Kombëtare, vështrim rreth abetareve dygjuhëshe shqip-italisht”, Botim i USH “L. Gurakuqi”, FSHSH, ISA, “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE ALBANOLOGJIA” Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, Studime shqiptare - 21, Shkodër, 2015.
- Kazazi, Njazi: “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër” (nga fillimet e tij deri në vitet ’20 të shek. XX). Monografi. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike. Shkodër, 2014.

Lloshi, Xhevat: “*Vëprimtaria arsimore e K. Kristoforidhit*”, në “Revista pedagogjike”, 1976, Nr. 1.

Muzeu Popullor Shkodër, Dosja 1/15, Dok. 742.

Osmani, Shefik: “*Kompleksi arsimor-kulturor i Pashallëkut të Shkodrës*”, në “Drita”, 3 tetor 1982.

Osmani, Shefik: “*Dy linja paralele në botimet e didaktit Gaspër Beltoja*”, - “Revista pedagogjike”, 1997/2.

Osmani, Shefik - Kazazi, Njazi: “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe i Shtëpisë “Idromeno”. Tiranë, 2000.

Osmani, Tomor: “Udhë e shkronjave shqipe”- Histori e alfabetit. Fondacioni Soros. Shtëpia botuese “Idromeno”. Shkodër, 1999.

Prennushi, Mikel: “*Vështrim historik mbi gjendjen dhe zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe të huaj në Shkodrën e shek. XIX*”, në “Studime historike”, Nr. 3 / 1974.

Qafëzezi, Ilo Mitkë: “Dhaskal Gjoka...”. Korçë, 1936.

Revista “Dituria”, janar 1928.

Shkurtaç, Gjovalin: “Sociolinguistika”. Tiranë, 1999.

Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet për pavarësinë e xhamisë shqiptare

Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA

Abstrakt

Me propozimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit, i cili funksiononte si instanca më e lartë për çështjet e fesë islame, u bënë përpjekje edhe për riorganizimin e studimeve teologjike islame. Kështu, në vend të medreseve të vogla që gjendeshin me shumicë në të kaluarën, disa prej të cilave e vazhdonin akoma veprimtarinë e tyre me nga një mësues (myderriz), u projektua hapja e disa medreseve më të kompletuara në qytetet kryesore të Shqipërisë, si në Shkodër, Elbasan, Berat, Tiranë dhe Durrës. Këto medrese do të kishin strukturën e shkollave të mesme, sipas modelit evropian dhe, krabas lëndëve fetare, në to do të mësobeshin në gjuhën shqipe edhe lëndët laike. Për përgatitjen e mësuesve (myderrizëve) dhe gjykatësve të sheriatit ishte parashikuar hapja e një universiteti teologjic, në qendër të vendit, në Elbasan. Në këtë universitet do të studionin medresistët, të cilët aspironin për një përgatitje teologjike më të lartë.

Për të shkaktuar diversion në radhët e turqve, anglezët i dërguan ftesa për të marrë pjesë në Konferencën e Lozanës si qeverisë fitimtare të Ankarasë, në krye të së cilës qëndronte Mustafa Qemali, ashtu dhe qeverisë osmane të Stambollit, që drejtohej nga Teufik Pasha, por që zyrtarisht

përfaqësonte sulltanin. Duke parë se një gjë e tillë i rrezikonte pushtetin, Mustafa Qemali, më 31 tetor 1922, deklaroi se e vetmja zgjidhje ishte që të shfuqizohej sulltanati dhe, në këtë mënyrë, të rrëzohej regjimi i Stambollit. Më 1 nëntor 1922, Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë dekretoi legjislacionin e ri që e ndante



Pjesëmarrës në Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar, shkurt-mars 1923

sulltanatin nga kalifati, duke i lënë këtij të fundit vetëm rol fetar.¹ Më 16 nëntor 1922, duke e ndjerë veten në rrezik, sulltani i fundit Vahidedini u largua me një anije angleze fillimisht në Maltë e më pas për në San Remo. Më 17 nëntor, Kuvendi i Madh Kombëtar e shkarkoi atë si kalif dhe në vend të tij zgjodhi Abdylmexhidin e II (1868-1944). Sapo u emërua në detyrën e re, kalifi lëshoi një deklaratë për të gjithë myslimanët e botës, duke u kërkuar atyre që të pranonin autoritetin e tij shpirtëror.²

1. A. Şeref Gözübüyük & Suna Kili, *Türk Anayasa Metinleri Sened-İttifaktan Günümüze*, Ankara: Türkiye İş Bankası Yayınları, 1985, s. 96-97; *Düstür*, 3. Tertip, C.3, s.152.

2. Seçil Akgün, *Halifeliğin Kaldırılması ve Lâiklik (1924-1928)*, İstanbul: Temel, 2006, s.3-4; *Nutuk*, C.III, s.1251-1252.

Për të pasur një përfytyrim më të saktë mbi marrëdhëniet religjioze midis Shqipërisë dhe Kalifatit Osman e sidomos mbi procesin e autoqefalisë së xhamisë shqiptare, është e nevojshme që të hedhim një vështrim retrospektiv, sepse ky proces në të vërtetë ka nisur shumë më herët se sa dihet. *De facto* ai është kryer që më 28 nëntor 1912, atëherë kur Shqipëria u shkëput përfundimisht nga Perandoria Osmane. Kështu, krahas Shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të qeverisë së Ismail Qemalit, Kuvendi Kombëtar i Vlorës caktoi në krye të Senatit klerikun dhe patriotin Haxhi Vehbi Dibra, i cili do të mbante njëkohësisht edhe detyrën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman.

Menjëherë pas marrjes së detyrës ai filloi një veprimtari intensive për organizimin dhe reformimin e institucioneve të bashkësisë islame, të institucioneve të kadilerëve e myftulerëve, të rolit e detyrave të tyre, të ngritjes e organizimit të sherive etj. Këto probleme ai arriti t'i bëjë objekt diskutimi e trajtесе edhe në mbledhjet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.³ Kjo vihet re dhe në vendimin e kësaj qeverie të datës 5 maj 1913, ku thuhet se Këshilli i Ministrave kishte vendosur bashkimin e çështjeve civile me ato penale; suprimimin e kadilerëve dhe shikimin e padive fetare nga ana e myftulerëve; emërimin e një myftiu në çdo nënprefekturë me rrogë 1200 grosh e ndër prefektura me nga 1800 grosh. Të gjithë myftinjtë do të merreshin në provim prej Hirësisë së tij Vehbi Efendiut, Shejh-ul-Islamit të Shqipërisë dhe funksioni i tyre do të deklarohet prej tij.⁴

Më 23 shtator 1913, gazeta "Dielli", botoi nga Vlorë një korrespondencë që bënte fjalë për ndryshimet në kabinetin qeveritar, sipas së cilës, Vehbi Dibra që kishte qenë kryetar i Senatit, tani ishte emëruar kryetar i myslimanëve dhe vendin e tij e kishte zënë

3. Qazim Xhelili, *Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, Tiranë: albin, 1998, f. 200.

4. *AQSH*, F. 145, V. 1913, D. 2, dok. nr. 8135. Vendimi Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës lidhur me organizimin gjyqësor në Shqipëri.

Eqrem bej Vlora,⁵ çka tregon se Haxhi Vehbi Dibra ishte liruar nga posti i mëparshëm për t'u emëruar Kryemyfti i Përgjithshëm i Shqipërisë.

Duhet theksuar se, për shkak të rrethanave politike që u krijuan në këtë periudhë, nuk pati ndonjë veprimtari konkrete për organizimin dhe strukturimin e bashkësisë islame. Në kohën e qeverisë së Princ Wudit komuniteti mysliman në Shqipëri ishte po aq autoqefal sa edhe komuniteti mysliman në Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Rumani dhe Greqi. Në krye të klerit mysliman qëndronte kryemyftiu, i cili ishte njëkohësisht prijësi i të gjithë ulemave dhe i administratës së sheriatit.⁶ Në vitet e Luftës së Parë Botërore, në zonën austro-hungareze të pushtimit, e cila përfshinte Shqipërinë e Mesme dhe atë Veriore, sipas një raporti të komisarit civil austro-hungarez, Kral, Shqipëria, si një shtet autonom, e jo si një vend i aneksuar prej Monarkisë Habsburge, mund të pretendonte të kishte të parin e saj të fesë islame. Një lidhje shpirtërore me Shejh-ul-Islamin në Stamboll edhe mund të lejohej, por jo midis asaj dhe parisë së fesë islame të vendeve të tjera ballkanike, me të cilët, përderisa nuk ekzistonte një

5. *Dielli*, nr. 247, 23 shtator 1913, f. 3.

6. *HHSt.APA.A.* në *AIH*, Vj. 26-1-172, Raport i komisarit civil austro-hungarez Kral mbi çështjet e fesë islame në Shqipëri, Shkodër, 25.7.1916.

varësi politike, kurrësi nuk mund të ishin mbi të, por vetëm se të barabartë. Kral ishte në kundërshtim të plotë me propozimin e zv/shefit të shtabit të ushtrisë austro-hungareze me qendër në Shkodër, i cili i kishte kërkuar Vjenës që drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ta vinte në varësi të Reis-ul-Ulemasë të Sarajevës. Ai kishte menduar që këtë të fundit, ta ftonë në Shkodër dhe, pasi t'i dorëzonte “detyrën” e re, ta shëtiste nëpër Shqipëri së bashku me disa hoxhallarë boshnjakë, për t'i këshilluar myslimanët që të silleshin mirë kundrejt autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Kral jo vetëm që e kundërshtonte një veprim të tillë, por i propozonte MPJ në Vjenë emërimin e një kryemyftiu vendas, duke marrë për këtë edhe një lloj miratimi nga Shejh-ul Islami në Stamboll.⁷

Vjena e miratoi qëndrimin refuzues të Kral-it, për mosvënien e Komunitetit Mysliman Shqiptar nën varësi të Reis-ul-Ulemasë të Sarajevës. Ndërsa marrjen e një lloj miratimi nga Shejh-ul Islami në Stamboll për emërimin e kryemyftiut të Shqipërisë, ajo e konsideroi si një veprim jo të përshtatshëm për arsye se: a) Emërimi i kryemyftiut nga korpskomanda austro-hungareze nuk ishte definitiv, ai kishte një

7. *HHSht.A.PA.A.nëAIH*, Vj. 26-1-173, Raport i komisarit civil austro-hungarez Kral mbi çështjet e organizimit të fesë islame në Shqipëri, Shkodër, 11.8.1916.

karakter provizor, ashtu si të gjitha urdhëresat e administratës ushtarake në Shqipëri b) Marrja e një lloj miratimi nga Shejh-ul-Islami i Stambollit që ishte bërë për Reis-ul-Ulemanë e Sarajevës formonte një pjesë përbërëse integrale të atyre konditave, nën të cilat Perandoria Osmane në vitin 1909, aprovoi aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria. Në kundërshtim me këtë mënyrë veprimi, shkëputja e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, u bë pa ndonjë rezervë të tillë. Prandaj, pozita e bashkësisë islame në Shqipëri nuk i ngjante asaj në Bosnje dhe Hercegovinë, por asaj të vendeve krejtësisht të pavarura nga Turqia. Modifikimi i kësaj pozite, sipas Vjenës, ishte i panevojshëm, si për interesat e Austro-Hungarisë, ashtu edhe për ato të Shqipërisë.⁸

Në tetor të vitit 1916, me urdhër të komandës ushtarake austro-hungareze, u krijua në Shkodër Gjyqi i Naltë i Sheriatit i përbërë nga Kryemyftiu Vehbi Dibra dhe dy anëtarë, kryesekretari dhe dy shkruesa.⁹ Ndërsa në vitin 1917, komanda ushtarake austro-hungareze miratoi “*Parashkëresën e përkohshme për organizimin e Sherisë në*

8. *HHSht.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 26-1-174, Telegram i MPJ për komisarit civil austro-hungarez në Shkodër Kral, Vjenë, 22.8.1916.

9. *AQSH*, F. 882, V. 1917, D. 19, fl. 30. Urdhër i Komandës Ushtarake Austro-Hungareze.

Shqipëri”,¹⁰ e cila përbëhej nga 43 nene dhe deri në vitin 1923 luajti rolin e një statuti. Sipas “Parashkresës...”, në krye të bashkësisë myslimane dhe të organizimit të Sherisë në Shqipëri ishte Myftiu i Përgjithshëm. Nën kryesinë e tij, ishin të gjithë hoxhallarët dhe Gjqqtarët e Sherisë ashtu dhe të gjithë zyrtarët e tjerë. Myftiu i Përgjithshëm kishte drejtimin dhe kontrollin e epërt mbi të gjitha çështjet e myslimanëve, mbi institutet e bamirësisë dhe të arsimit. Bashkë me Myftiun e Përgjithshëm, pranë tij si ndihmës, qëndronin dhe dy ulema. Këta të dy, bashkë me Kryemyftiun përbënin Këshillin e Naltë ose Gjqin e Naltë të Sheriatit. Ky këshill ishte shkalla më e lartë për çështjet e besimit dhe të gjyqësisë. Ai kishte të drejtë të zgjidhte gjyqtarët e Sherisë, imamët, hatibët, hoxhallarët, mësuesit e besimit dhe nëpunësit e tjerë. Në Parashkresë, përcaktoheshin edhe detyrat e Kryemyftiut e të Këshillit të Lartë të Sherisë, të Myfti-Kadive, Naibëve, Vaizëve etj. Sipas nenit 18 të “Parashkresës...”, ligjëratat në xhami duhet të mbaheshin në shqip dhe arabisht, t’u përgjigjeshin nevojave të kohës dhe urdhrave të qeverisë. Vendimeve gjyqësore duhej

10. *HHSht.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-63, Rregullore provizore e organizimit të çështjeve të sheriatit në Shqipëri, Shkodër, 25 qershor 1917. Kjo rregullore u botua edhe në formën e një broshure nën emërtesën *Parashkresë e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri*, Shkodër 1917.

t’u bashkëngjitej përherë edhe një shkurtim në gjuhën shqipe.¹¹ Me interes të veçantë në këtë periudhë është dhe një qarkore që Myftiu i Përgjithshëm, Haxhi Vehbi Dibra, u dërgoi të gjitha sherive të qarqeve. Ai i urdhëroi ato që, meqë Shqipëria ishte një shtet i pavarur dhe nuk kishte ndonjë lidhje shtetërore me qeverinë turke, lutjet të mos bëheshin në turqisht, por në gjuhën shqipe dhe sulltani të mos përmendej më si mbret i Shqipërisë.¹²

Me propozimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit, i cili funksiononte si instanca më e lartë për çështjet e fesë islame, u bënë përpjekje edhe për riorganizimin e studimeve teologjike islame. Kështu, në vend të medreseve të vogla që gjendeshin me shumicë në të kaluarën, disa prej të cilave e vazhdonin akoma veprimtarinë e tyre me nga një mësues (*myderris*), u projektua hapja e disa medreseve më të kompletuara në qytetet kryesore të Shqipërisë, si në Shkodër, Elbasan, Berat, Tiranë dhe Durrës. Këto medrese do të kishin strukturën e shkollave të mesme, sipas modelit evropian dhe, krahas lëndëve fetare, në to do të mësoheshin në gjuhën shqipe edhe lëndët laike. Për

11. *HHSht.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-70, Qarkore dërguar të gjithë qark-komandave mbi vendimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit, Shkodër, 14.6.1918.

12. *AQSH*, F. 882, V.1917, D. 39, fl. 1. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, dërguar sherive të vendit, 26.6.1917.

përgatitjen e mësuesve (myderrisëve) dhe gjykatësve të sheriatit ishte parashikuar hapja e një universiteti teologjike, në qendër të vendit, në Elbasan. Në këtë universitet do të studionin medresistët, të cilët aspironin për një përgatitje teologjike më të lartë. Pranë medreseve dhe universitetit do të ndërtoheshin konvikte për strehimin e nxënësve që vinin nga larg. Shpenzimet për financimin e studimeve teologjike islame si burim primar do të kishin të ardhurat e vakufeve, ndërsa burimet shtetërore do të ishin sekondare, në formë subvencionesh. Me organizimin e studimit autonom të teologjisë islame në Shqipëri do të bëhej e mundur përgatitja në vend e një brezi të ri klerikësh, gjykatësish të sheriatit dhe e dijetarëve të teologjisë. Kjo do ta rriste shkallën e pavarësisë dhe eventualisht do bënte të hiqej dorë nga thirrja e kandidatëve të huaj nga Turqia, Egjipti apo nga shtete të tjera myslimane.¹³ Për plotësimin e nevojave që kishin mësuesit e lëndës së mësim-besimit, në shtypshkronjën shtetërore në Vjenë, u shtypën me tirazh të lartë edhe shumë kopje të bazave të fesë islame.¹⁴

Kur analizojmë rrugën që

13. *HHSi.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-67, Raport i korpskomandës austro-hungareze mbi çështjet e sheriatit dhe vakufit në Shqipëri, Shkodër, 23.3.1918.

14. *HHSi.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-80, Raport i korpskomandës austro-hungareze mbi çështjet e arsimit në Shqipëri, Shkodër, janar, 1918.

ka ndjekur procesi i realizimit të mëvetësisë së komunitetit mysliman shqiptar, duhet theksuar se pas vitit 1912 ai nuk ka pasur më asnjë kontakt zyrtar me Kalifatin Osman. Në fondin e Komunitetit Mysliman që gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit, të paktën deri tani, nuk është gjetur qoftë edhe një dokument që të dëshmojë lidhjet me Shejh-ul-Islamin në Stamboll.¹⁵ Përkundrazi, kleri mysliman shqiptar, i ndërgjegjshëm për rrugën që duhej ndjekur, nënvizoi si prioritet përdorimin e gjuhës shqipe. Këtu në radhë të parë vlen të theksohet roli i Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, i cili, më 14 dhjetor 1920, u shpërndau një qarkore tjetër zyrtare të shërive në prefektura dhe nënprefektura ku i urdhëroi ato se në të gjitha zyrat e sheriatit, duhet të përdornin gjuhën kombëtare. “Prandaj, jeni të urdhëruem mos me përdorë gjuhën turqishte ndër akte zyrtare, sikurse e kemi përdorë gjer më sot. Nga ky shkak, sekretarët, ashtu dhe shkruesat e gjyqeve sheri, janë të detyruem me ditë gjuhën kombëtare mirë, si me shkrim ashtu edhe me këndim. Veç kësaj, ilameve (shpalljeve/vendimeve-H. B.) sheri, përherë do t’u ngjitet një shkurtim në gjuhën shqipe”.¹⁶ Për të përmbushur

15. Q. Xhelili, *Vehbi Dibra-personalitet...*, f. 204.

16. *AQSH*, F. 882, V. 1921, D. 9, fl. 1. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, për mësimin e gjuhës

këtë qëllim, ai njoftoi se, të gjithë nëpunësit do t'i nënshtroheshin një kontrolli nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit.

Realizimi i përdorimit të gjuhës shqipe në aktet e institucioneve fetare islame nuk ishte një proces i lehtë, prandaj kjo çështje u ndoq në vijimësi. Në dhjetor të vitit 1921, njoftoheshin të gjitha Gjyqet e Sheriatit nëpër prefektura se shumë nga lutjet dhe aktet që i paraqiteshin Gjyqit të Naltë ashtu dhe gjyqeve që vareshin prej tij, ishin të shkruara në gjuhën turke. Meqenëse populli që u drejtohej këtyre gjyqeve, ashtu edhe nëpunësit e tyre, ishin shtetas shqiptarë dhe flisnin të gjithë gjuhën shqipe; meqenëse gjykatat e sheriatit mbështesin qeverisjen e shtetit, i cili zyrtarisht përdorte gjuhën kombëtare, porositet rreptësisht ndalimi i akteve dhe lutjeve në gjuhën turke dhe urdhërohej që të mos pranoheshin fare. Gjithashtu ndaloheshin nëpunësit e sherive për përdorimin e gjuhës turke mbi çdo akt zyrtar.¹⁷ Gazeta “Mbrojtja Kombëtare” e 12 majit 1921, e cila e botoi të plotë këtë qarkore, poshtë firmës së Haxhi Vehbi Dibrës ka vendosur shënimin e saj: “Zotit Myfti të Përgjithshëm i drejtojmë duartrokitjet tona”.¹⁸ Nga dokumentacioni i kohës vihet re se, për zbatimin e këtyre urdhëresave u hodhën hapa konkrete. Kështu,

shqipe nga nëpunësit e sherive.

17. *Mbrojtja Kombëtare*, 12 maj 1921, f. 1.

18. *Po aty*.

në një korrespondencë me gjyqin e sheriatit të Tiranës, Haxhi Vehbi Dibra shkruante: “Ngjitun u kthehet shkresa nr. 37, 21 shkurt 1922, dërguar Gjyqit të Naltë të Sheriatit për shkak se është shkruar në turqisht. Meqenëse korrespondenca duhet ba në shqipen zyrtare, jeni të porositun për të dytën herë që të mos i dërgoni këtij gjyqi shkresa të shkrueme në gjuhën turke, se nuk do të kryhet asnjë formalitet mbi to”.¹⁹ Një rëndësi e veçantë, në këtë periudhë, iu kushtua edhe përdorimit të simbolikës kombëtare. Në mars të vitit 1921, Haxhi Vehbi Dibra porosiste gjyqin e sherisë së Vlorës që në shkresat dhe aktet zyrtare të mos përdorte vulat turke, por të merrte sa më shpejt që të ishte e mundur një vulë me shqiponjë.²⁰

Abdylmexhidi II pasi u emërua në postin e kalifit i bëri thirrje të gjithë myslimanëve të botës për t'iu bindur autoritetit të tij shpirtëror. Lidhur me qëndrimin dhe relacionet që mbajti në këtë rast kleri mysliman shqiptar, dëshmon dhe një telegram që mban datën 23 dhjetor

19. *AQSH*, F. 882, V. 1922, D. 7, fl. 3. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, për gjyqin e sheriatit të Tiranës lidhur me mospërdorimin e turqishtes në shkresat zyrtare.

20. *Po aty*, V. 1921, D. 14, fl. 2. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, për gjyqin e sheriatit të Vlorës lidhur me mospërdorimin e vulave turqisht në shkresat zyrtare.

1922.²¹ Telegrami mban emërtesën “Nji telegram i kalifes”²² dhe nga teksti kuptohet se është një përgjigje ndaj një telegrami urimi që Haxhi Vehbi Dibra me cilësinë e Myftiut të Përgjithshëm të Shqipërisë i kishte dërguar Abdylmexhidit II, me rastin e emërimit të tij në postin e kalifit. Nga përgjigja e Kalifit duket se telegrami i Kryemyftiut të Shqipërisë, Haxhi Vehbi Dibra, kishte qenë thjesht një telegram kortezie dhe nuk kishte prekur çështje delikate të mëvetësisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar. Këtë çështje krerët myslimanë e

konsideronin dhe do ta trajtonin tërësisht si një çështje të brendshme të popullsisë myslimane shqiptare. Përgjigja e kalifit, ngjalli reagim dhe komente tek intelektualët e kohës. Gazeta “Elbasani” shkruante: “Tue i u fal nderit, Halifes së ri, për simpatin dhe bekimet që u ban myslymanëve shqiptar, gjejm rast t’i thomi se parimet kombëtare që banë të ndahet halifeti prej detyrash politike, nja`ato parime kanë ba edhe popullin shqiptar të mbështetet në bashkim vllaznuer e rracnuer pa i vu vesh aspak feve të ndryshme që e ndajnë vetëm në pikpamje të nevojave shpirtnore. Le ta dijë Halifja i ri se, deri sa ai të qëndrojë larg intrigës politike që kanë luejt disa autoritete fetare, myslimanët e Shqipërisë nuk do t’i kursejnë lutjet e veta të përzemërta për shkëlqimin e atij fronit. Gjithashtu duhet t’a dijë hilafeti edhe se, ma e vogla intrigë e mbulueme me ngjyra fetare shkakton mënin e përjetshme të popullit shqiptar kundër kujdo fronit fetar”.²³ Komentin e bërë nga gazeta “Elbasani” e ribotoi dhe gazeta “Shtypi”, duke i cilësuar ato si “Fjalë ari” dhe se ky shënim e nderonte shumë ndërgjegjen fetare dhe atdhetarizmin e shkrimtarëve të asaj fletoreje.²⁴

Pavarësisht telegrameve të kortezisë të shkëmbyera mes Stambollit dhe Tiranës, duhet

21. *Fletore Zyrtare*, nr. 1, 7 kallnduer 1923, f. 2; “Njofim”, *Shqipëri e re*, nr. 115, 28.1.1923, f. 1.

22. *Po aty*. “z. Vehbi, Myfti i Përgjithshëm në Tiranë. Telegramin derimtari Z. s`Uej I dërguem n`Emën të Popullit Mysliman Shqiptar që i uronte të madhit Halife fronin e naltë të Hilafetit u këndua nga Naltmadhënia e Tij me një gëzim të veçantë. N.M.T na urdhënoj t’i japim zbukurim gjuhës duke thanë se, Kombi Shqiptar, trim e shpirtmadh, meqenëse, në çdo gjendje e në çdo kohë ashtë një gjymtyrë i vlefshëm për trupin e përgjithshëm Mysliman, ka me e naltësue fjalën e njitimit (teuhidit) dhe në dy jetë ka me ja mbërritun shkallës ma të naltë të nderit e të lumturisë. Naltmadhënia e Tij dëshiron dhe zotnis s`Uaj, që jeni mbrojtësi sheriatit në atë shtet, Zoti u faltë sukses për plotësimin e dëshirave edhe për mirëpunët e pritshme, duke rranjosun e duke forcuem vendimet e nalta të Sheriati-Ahmedijes në çdo anë të Shqipnjes. Mbas urdhnit të N.M së Tij me gëzim po shpejtoj t`ju jap sihariq për Selamin Shpëtimprues të Madhit Halife që i çon të gjith Popullit Shqiptar Mysliman. Kryeadjutant Kajmekam Sheqib d.v Stamboll 23.12.1922”.

23. “Fjalë ari”, *Shtypi*, nr. 2, 11.1.1923, f. 1.

24. *Po aty*.

theksuar se marrëdhëniet ndërmjet kalifit të ri dhe drejtuesve kryesorë të klerit mysliman shqiptar, nuk vijuan më tej. Bile, nga gjysma e dytë e dhjetorit 1922, Haxhi Vehbi Dibra, i paraqiti qeverisë për miratim projektin e statutit të Xhematit Mysliman Shqiptar, për hartimin e të cilit kishte punuar, nën kryesinë e tij, një komision i posaçëm i përbërë nga intelektualët më në zë të klerit.²⁵

Më 7 shkurt 1923, ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, njoftoi të gjitha prefekturat se, me vendim të Këshillit të Ministrave, i jepej leja Gjyqit të Naltë të Sheriatit për të bërë më 20 shkurt 1923, mbledhjen e përgjithshme për formimin e Këshillit të Myslimanizmes (Xhemijeti Islamijes) të kërkuar shumë herë prej popullit mysliman.²⁶ Për zgjedhjen e delegatëve që do të mernin pjesë në këtë kongres u hartua një rregullore e veçantë, sipas së cilës, çdo prefekturë dhe nënprefekturë do të dërgonte nga një përfaqësues, i cili, ndër të tjera, duhet të dinte të shkruante dhe të lexonte mirë gjuhën shqipe.²⁷ Një eveniment

i tillë u prit me entuziazëm të madh në shtypin e kohës.²⁸ Redaksia e gazetës “Mbrotja Kombëtare”, pasi njoftonte mbi zgjedhjen e delegatit të Vlorës, Ibrahim Xhindi, uronte vëllezërit myslimanë që mbledhja për Xhaminë autoqefale të kishte sukses.²⁹ Ndërsa gazeta “Populli” përgëzonte iniciatorët e këtij kongresi duke qenë e sigurt se përfundimet dhe vendimet që do të merrte, do të ishin baza e përparimit dhe do t’i përgjigjeshin plotësisht interesave të shtetit dhe të kombit shqiptar.³⁰ Detyra e këtij kongresi, theksohej në një tjetër gazetë, do të ishte shkëputja e çdo lidhje me Shejh-ul-Islamin dhe të rregullonte Komunitetin Mysliman Shqiptar.³¹

Kongresi i filloi punimet në Tiranë, më 24 shkurt 1923, në sallën e shoqërisë “Djelmnia Dibrane”, kryetar i së cilës ishte patrioti Dervish

të plotësonin delegatët e zgjedhur për Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar.

28. *Populli*, nr. 5, 16.2.1923; *Elbasani*, nr. 9, 19.2.1923; *Mbrojtja Kombëtare*, nr. 5, 21.2.1923; *Shqipëri e re*, nr. 120, 4.3.1923; *Mbrojtja kombëtare*, nr. 5, 21.2.1923; *Politika*, nr. 8, 19.2.1923; “Kongresi i muhamedanëve shqiptarë”, *Shqipëri e re*, nr. 121, 11.3.1923; “Mbi mbledhjen e një kongresi fetar muhamedan që do të mbledhet në kryeqytet”, “Mbi proklamimin e xhamisë shqiptare nga kongresi muhamedan”, *Zëri i popullit*, nr. 20, 17.2.1923, f. 2; *Drita*, nr. 129, 27.3.1921.

29. “Në kongresin e muhamedanëve do të mare pjesë deputeti nga Vlora, Ibrahim Xhindi”, *Mbrojtja kombëtare*, nr. 5, 21.2.1923.

30. *Populli*, nr. 5, 16.2.1923.

31. *Zëri i popullit*, nr. 20, 17.2.1923.

25. *AQSH*, F. 882, V. 1922, D. 668, fl. 48. Parashtrësë e Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, dërguar Kryesisë së Këshillit të Ministrave për formimin e Xhematit Mysliman Shqiptar, 16.12.1922.

26. *Libri i Qarkoreve i Ministrisë së Punëve të Brendshme i vitit 1922-1923*, Tiranë 1923, nr. 5, f. 222.

27. *AQSH*, F. 882, V. 1923, D. 4, fl. 6. Urdhëresë e Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, për kriteret që duhet

Hima.³² Në Kongres merrnin pjesë 36 delegatë,³³ shtatë prej tyre ishin deputetë. Nga ana e qeverisë, ministri i Brendshëm Ahmet Zogu caktoi si përfaqësues në Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar, sekretarin e përgjithshëm të kësaj ministrie Beqir Çelon.³⁴

Që në mbledhjen e parë të delegatëve, Haxhi Vehbi Dibra, u zgjodh Kryetar i Kongresit Mysliman dhe punimet u zhvilluan nën kryesinë e tij. Në fjalën e hapjes, ai theksoi karakterin liberal e demokratik të fesë islame, e cila i kishte të hapura lirisht portat për diskutimin e lirë të të gjitha problemeve që i interesonin botës myslimane,³⁵ sepse, siç u shpreh

32. *AQSH*, F. 882, V. 1923, D. 4, fl.11. Disa ditë më parë Myftiu i Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, i dërgonte Dervish Himës një shkresë ku ndër të tjera e njoftonte se: “*Gjyqi i Naltë i Sberiatit, ka pas shpallur për një mbledhje të përgjithshme këtu në kryeqytet prej përfaqësuesve të popullit mysliman, të dërguar nga çdo prefekturë e nënprefekturë. Kjo mbledhje, që caktuar të hapet me 20 shkurt 1923, por tue mos muejt me mbritë në kohë disa prej delegatëve, u shty dhe u vendos që të hapet me 24 shkurt në orën nëntë, para dite, në ndërtesën e shoqërisë “Djelmnia Dibrane”, e cila kryesohet nga ana e z. suaj. Pra lutemi që ndërtesa në fjalë të stoliset e të rregullohet sikurse dubet, tue caktua posaçërisht vendet e delegatëve, të të ftuarve, të sekretarisë dhe të përfaqësuesit të qeverisë”.*

33. *Po aty*, fl. 16-17. Lista e delegatëve të prefekturave dhe nënprefekturave për në Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar.

34. *AQSH*, F. 482, V. 1923, D. 4, fl. 41. Letër e ministrit të Punëve të Brendshme Ahmet Zogu, mbi caktimin si të deleguar në Kongresin Mysliman të sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie z. Beqir Çelo.

35. Gazment Shpuza, “Rëndësia dhe

fjalë për fjalë ai, “me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjykimet”³⁶. Pas falënderimeve për kryeministrin Ahmet Zogu, i cili kishte ndihmuar në organizimin e këtij kuvendi, Hirësia e tij Vehbi Dibra theksoi përpara të gjithë delegatëve rëndësinë e vëllazërimit kombëtar të të gjithë shqiptarëve. “Sikurse e dini zotëria e juaj, popullsia e Shtetit tonë përbahet prej tre elementësh d.m.th. Mysliman, Katolik dhe Ortodoks, po në pikëpamje të Kombësisë në mes tonë kemi një vllazni të plotë e të patundëshme, e nuk mund të thuhet e të kuptohet asnjë send që e tund atë vllaznie të plotë. Çështja e fesë asht një çështje e posaçme e sejcili është i lirë për me e sigurue forcimin e fesë së vet. Ky organizim i fesë sonë asht vendosun qysh në Kongres të Dibrës fatzezë, po luftat ballkanike e ndaluen këtë qëllim”³⁷.

Në seancën e dytë, Kongresi zgjodhi një komision që do të punonte për hartimin e statutit, i cili ishte dokumenti më i rëndësishëm i mbledhjes së myslimanëve shqiptarë. Komisioni që u ngarkua me përgatitjen e projekt-statutit i vazhdoi bisedimet dhe formuloi projektin e paraqitur,³⁸

mesazhi i Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923”, *Perla*, Viti XI 2006 Nr. 2 (41), f. 107.

36. *Shtypi*, nr. 16, 28.2.1923; *Populli* nr. 120, 9.3.1923.

37. *Po aty*.

38. *AQSH*, F. 482, V. 1923, D. 4, fl. 195-197. Projekt statuti i Xhematit Mysliman Shqiptar.

ku ndër të tjera shkruhej: “Sikurse shihet në këtë projekt-statut, duke u marë parasysh qëllimet esenciale të organizimit, Statuti mer emrin Statuti i Trupit Mysliman Shqiptar, në të cilin jemi munduar të përmbledhim disa themele për sigurimin e mbarëvajtjen e organizimit të këtij trupi për sa i përket sigurimit të një morali të pastër e zhvillimit lëndor e ekonomik, duke u larguar kryekëput nga politika. Përbërja e trupit mysliman shqiptar për sigurimin e qëllimeve të sipërshënuara e forcimin vëllazëror ndërmjet shqiptarësh, i ngarkohet Këshillit të Naltë të Xhematit e ndihmës plot me vullnet të patundshëm të shqiptarëve myslimanë”.³⁹ Rëndësi të madhe kishte fakti se Statuti Mysliman përjashtonte dhe ndalonte çdo autoritet shpirtëror jashtë Shqipërisë, çka e shihte atë kundër idealit kombëtar.⁴⁰ Organi më i lartë mysliman në Shqipëri, po sipas këtij Statuti, ishte Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit. Ky drejtohej nga Myftiu i Përgjithshëm. Personi që do të vendosej në këtë detyrë duhet të kishte këto cilësi: së pari, të ishte nënsh tetas shqiptar dhe të dinte gjuhën shqipe; së dyti, të gëzonte të drejtat civile e politike; së treti, të ishte prej racës shqiptare ose me origjinë shqiptare prej tre brezash. Këtë post nuk mund ta zinin ata persona të cilët, duke filluar nga data 28 nëntor 1912 kishin luftuar kundër çështjes

39. *Po aty*.

40. *AQSH*, F. 882, V. 1923, D. 1, fl. 13. Statuti i Trupit Xhematit Mysliman Shqiptar.

kombëtare.⁴¹Sipas neneve gjashtë e shtatë të Statutit, Këshilli i Naltë i Sheriatit zgjidhej me shumicë votash dhe të gjithë anëtarët duhet të ishin me kombësi shqiptare. Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar i përfundoi punimet më 12 mars 1923. Me vendimet që mori ai shënon një ngjarje të rëndësishme historike, jo vetëm për besimtarët e fesë islame, por për mbarë popullin shqiptar. Në përfundim të punimeve, Kryetari i Kongresit Mysliman Shqiptar Haxhi Vehbi Dibra i drejtoi Këshillit të Ministrave një letër ku e vinte në dijeni se Kongresi i kishte mbyllur punimet me sukses të plotë, duke zgjedhur në bazë të neneve 6 dhe 7 të statutit edhe anëtarët e Këshillit të Naltë të Sheriatit.⁴²

Në Statutin e vitit 1923, jo vetëm që nuk bëhej fjalë për ndonjë lidhje me kalifatin, por, konfirmoheshin *de jure* vendimet e vitit 1913, kur si Myftiu i Përgjithshëm i Shqipërisë ishte zgjedhur Haxhi Vehbi Dibra. Ky ishte dhe Kongresi i shpalljes së autoqefalisë së xhamisë shqiptare, duke shkëputur kështu zyrtarisht

41. *Po aty*, fl. 3.

42. *AQSH*, F. 482, V. 1923, D. 4, fl. 28. Letër e Kryetarit të Kongresit Mysliman Shqiptar Vehbi Dibra, dërguar Këshillit të Ministrave. Anëtarë të Këshillit u zgjodhën Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Vejsel Nailiu, Haxhi Adem Vata, Sheh Ibrahim Karbunara, Qamil Bala, Reshat Kokalari. Vehbi Dibra u zgjodh Kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit, ndërsa Drejtor i Përgjithshëm i Vakëfeve nga Kongresi u zgjodh Sali Vuçiterni.

çdo marrëdhënie shpirtërore me Turqinë.⁴³ Një akt i tillë u prit me entuziazëm dhe u komentua gjerësisht në faqet e shtypit të kohës. Në Gjirokastrë dhe në Korçë lajmi për proklamimin e autoqefalisë së xhamisë shqiptare, u përshëndet me të shtëna artilerie, banda e qytetit luajti pjesë muzikore në oborrin e medresesë, ku priteshin vizita zyrtare.⁴⁴ Me këtë rast, gazeta “Zëri i popullit” përgëzonte vëllezërit myslimanë për këtë ditë të shënuar dhe u uronte atyre mbarëvajtje e përparim për interesin e përbashkët kombëtar, duke shkruar se një ndryshim të tillë, shqiptarët, duhet ta ndienin më shumë të nevojshme sesa turqit, se duhej marrë parasysh që ndodheshin në mes të Europës dhe nuk mund të qëndronin indiferentë përpara ndryshimeve sociale që po ndodhnin në mbarë botën.⁴⁵ Në Vlorë gazeta “Mbrojtja kombëtare” shkruante se, porsa kishte mbërritur lajmi, qyteti ishte zbukuruar me flamuj dhe në xhami ishin kënduar lutje. Më pas populli kishte vajtur në gjykatoren fetare ku ishin pritur

urime.⁴⁶ Ndërsa gazeta “Shqipëria e re” që dilte në Rumani, duke bërë fjalë për ceremoninë e zhvilluar në Tiranë me rastin e përfundimit të Kongresit Mysliman, njoftonte: “Të premtën e shkuar pas kongresit mysliman për autoqefalinë e fesë myslimane, u mbajt në xhami një lutje, ku për të parën herë, u këndua Kur`ani në gjuhën shqipe. Muar pjesë Këshilli i Naltë, Qeveria, Nënpunësit superiorë dhe një shumicë e madhe prej popullit. Në fjalën që mbajti i ndershmi Kryemyfti tha: Që këtej e tutje do të njohim kryesinë e fesë myslimane, Këshillin e Naltë dhe jo Shejh-ul Islamin e Stambollit”.⁴⁷

Vendimeve të Kongresit Mysliman Shqiptar u bënë jehonë edhe gazetat e huaja. Përfaqësuesi i Shqipërisë në Romë, Teufik Mborja, njoftonte Ministrinë e Jashtme shkruante se gazetat e atjeshme kishin lajmëruar autoqefalinë e xhamisë shqiptare nga kalifati i Stambollit.⁴⁸ Gazeta greke “Fruros” e datës 10 prill 1923, hapej me artikullin “Shqiptarët u ndanë prej Kalifatit”, ku njoftonte se me iniciativën e kryeministrit të Shqipërisë, Ahmet Zogu, në Tiranë ishte mbledhur Kongresi i Myslimanëve Shqiptarë. Ajo e vinte theksin në rëndësinë që do të kishin

43. “Congresso di Musulmani in Albania: la questione del Califfato e le riforme in materia islamica”, *Oriente Moderno*, nr. 2, 1922-1923, p. 706; “Ancoraintorno al Congressodei Musulmani”, *Oriente Moderno*, nr. 3, 1923, p. 78; Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, f. 110.

44. “Mbi mbylljen e Kongresit Mysliman në Tiranë”, *Drita*, nr. 127, 14.3.1923, f. 1.

45. Zëri i popullit, nr. 28, 21.3.1923.

46. *Mbrojtja kombëtare*, 15.3.1923.

47. “Njoftim”, *Shqipëria e re*, nr. 126, 15.4.1923.

48. *AMPJ*, D. 334, V. 1923, fl. 1. Telegram i përfaqësuesit të Shqipërisë në Romë, Teufik Mborja, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 16.3.1923.

vendimet e këtij Kongresi, pasi kështu do të ndërpritej çdo lidhje midis shqiptarëve (myslimanë) dhe Kalifatit të Turqisë dhe do të fillonte një emancipim i Shqipërisë prej influencës turke.⁴⁹ Për t'u shënuar është edhe artikulli i botuar në gazetën egiptiane "Al-Ahram", më 11 prill 1923, të cilit do t'i kundërpërgjigjej Vehbi Dibra me një artikull të gjatë të shkruar në arabisht dhe të botuar po në këtë gazetë. Nga ky shkrim mësojmë se Myftiu i Përgjithshëm, protestonte kundër përmbajtjes së një artikulli të botuar në gazetën "Times" të Londrës, lidhur me komentet dhe interpretimet që bëheshin për Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar.⁵⁰

Deri më sot nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë dokument mbi qëndrimin që mbajti Stambolli ndaj autoqefalisë së xhamisë shqiptare. Ndonëse kjo ngjarje nuk mund të ketë kaluar pa u vënë re nga qeveria turke, fakt është se ajo nuk ndërmoi ndonjë veprim apo reagim publik, për vetë faktin se bashkësia myslimane e Shqipërisë *de facto* e kishte fituar mëvetësinë e saj që kur vendi ynë u shkëput nga Perandoria Osmane. Por, kjo mund të lidhet edhe me pozitën aspak komode të Abdylmexhidit të II në raport me regjimin turk. Pasi

49. *Po aty*, fl. 4. "Shqiptarët u ndanë prej Kalifatit", artikull i gazetës greke "Fruros" e datës 10 prill 1923.

50. Alexander Popoviç, *Islamiçmi Ballkanik, Myslimanët e Europës Juglindore gjatë periudhës pasosmane*, Tiranë: Dituria, 2006, f. 35.

drithërimat e Lozanës morën fund, ai u kthye në një pikë qendrore për kundërshtarët e Mustafa Qemalit, që filluan të intrigojnë për të rikthyer sultanatin dhe sultanin.⁵¹ Kur kalifi i shkroi Mustafa Qemalit për t'i kërkuar përparësi më të mëdha, për shkak të dëmeve që i kishte shkaktuar këtij institucioni pakësimi i buxhetit,⁵² ai iu përgjigj: "Kalifi dhe mbarë bota le ta dinë se kalifi dhe kalifati, nuk kanë më asnjë kuptim dhe asnjë ekzistencë të vërtetë. Ne nuk mund ta vendosim Republikën e Turqisë përballë asnjë rreziku që cenon pavarësinë e saj. Vendi i kalifatit, për ne, nuk ka më asnjë rëndësi më shumë se sa kujtesa historike".⁵³ Më 29 shkurt 1924, Abdylmexhidi mori pjesë në ceremoninë e së premtes, e cila qe dhe ceremonia e fundit e mbajtur zyrtarisht nga një anëtar i dinastisë osmane. Katër ditë më pas, më 3 mars 1924, Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë e shfuqizoi kalifatin, duke i dhënë fund dinastisë osmane. Të nesërmen e asaj dite, Abdylmexhidi u largua nga Stambolli.⁵⁴

51. Emile Marmorstein, "Religious Opposition to Nationalism in the Middle East", *International Affairs*, July, 1952, p. 344-357.

52. Yusuf Sert, *Halifeliğin kaldırılmasının Konya basını ve kamuoyunda kıyansması, Selçuk Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Atatürk İlkelerine İnkılâp Tarihi Anabilim Dalı*, Yüksek Lisans Tezi, 1995, s. 51.

53. *Türkiye Büyük Millet Meclisi, ikincidevrec*. VII, Ankara, 1985, s. 27.

54. Yusuf Sert, *Halifeliğinkaldırılmasının...*, s. 65.

Shkatërrimi i Kalifatit Osman u shoqërua me komente të shumta në shtypin perëndimor.⁵⁵ Gazeta angleze “The Daily Telegraph” e quante një hap të nxituar veprimin e nacionalistëve turq. Ajo shkruante se prania e Kalifatit në Turqi e fuste atë në radhën e shteteve të fuqishme, ndërsa tani, ajo do të kthehej në një republikë të dorës së tretë.⁵⁶ Më 13 mars 1924 gazeta e Kajros “Al-Akbar” botoi artikullin “Bomba qemaliste mbërrin në zemër të islamit dhe të Turqisë”. Sipas kësaj gazete, tani Turqia e privuar nga kalifati, e kishte humbur vendin e saj midis perandorive të mëdha. Politikisht, tani ajo zinte një vend më të ulët nga ai i Bullgarisë. Ndikimi i saj mbi myslimanët e Azisë dhe të Afrikës ishte shkatërruar, dhe ajo ishte e reduktuar në një shtet prej 5 milionë banorësh. Kështu Republikës Turke si mbetej gjë tjetër veçse të mbrohej nëpërmjet militarizimit.⁵⁷

Edhe shtypi shqiptar i ndiqte me vëmendje zhvillimet në Turqi,

55. “The End of the Caliphate”, *The Times*, 5 March 1924, p. 14; “The Future of Islam”, *The Daily Telegraph*, 4 March 1924, p. 11; “The Exiled Khalif”, 6 March 1924, p. 10-11; “The Caliphate”, 11 March 1924, p. 12; “The Abolition of the Caliph”, *The Economist*, 8 March 1924, p. 523-524; “Angora and the Caliphate”, *Fortnightly Review*, January-June 1924, V. 115, p. 495-505; “Turkey the Khalifate and Islam”, *The Near East*, 20 March 1924, p. 299.

56. “The Caliphate”, *The Daily Telegraph*, 11 March 1924, p. 12.

57. *Oriente Moderno*, 4.4.1924, p. 215-217.

“Gazeta e Korçës” shkruante se në Parlamentin Turk ishte paraqitur një mocion për heqjen e kalifatit.⁵⁸ Ndërsa më 8 mars 1924, ajo jepte lajmin se Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë kishte miratuar ligjin që e abrogonte kalifatin.⁵⁹ Për t’u nënvizuar është se shtypi shqiptar e përshëndeti dhe e komentoi pozitivisht këtë hap madhor në emancipimin e shoqërisë turke. Këto komente në vetvete dëshmonin edhe frymën moderne dhe përparimtare të shtypit dhe inteligjencës shqiptare të kohës, e cila ishte e vendosur të ecte në rrugën e qytetërimit perëndimor. Në një artikull të gazetës “Dielli” komentohej se ky hap kishte rëndësi të përbotshme, se turqit po tregonin një guxim shumë të madh, duke rrëzuar një institut të vjetër të themeluar që në vitin 1517, i cili kishte qenë burimi kryesor i fuqisë së tyre. Ky vendim, nuk kishte vetëm kuptimin e rrëzimit të kalifatit, por, sikundër shpjegohej nga burime të ndryshme, kishte dhe kuptimin që tani e tutje Kur’ani dhe ligjet e shenjta do të shuheshin dhe do të çrënjoseshin krejtësisht nga gjykatat dhe shkollat publike, të cilat, kishin qenë nën influencën e fesë. Sipas gazetës, një kuptim tjetër ishte dhe se të gjitha gjërat e çmuara të institucioneve të shenjta, të cilat llogariteshin se kishin një

58. “Turqit do të heqin Kalifatin”, *Gazeta e Korçës*, nr. 68, 1.3.1924, f. 4.

59. *Gazeta e Korçës*, nr. 69, 8.3.1924, f. 1.

vlerë prej 500.000.000 dollarë, do t'i ktheheshin shtetit. Kjo masë, sipas gazetës, i thoshte lamtumirë Orientit e ideve orientale dhe e vinte Republikën Turke në një bazë të shëndoshë perëndimore, e cila do ta shpëtonte dhe do ta vinte në udhë të mbarë kombin turk.⁶⁰ Në të njëjtën linjë ishte dhe një artikull i botuar në “Gazeta e Korçës” më 25 mars 1924. Sipas tij, Asambleja Turke, me reformat themelore të bëra njëra pas tjetrës, po habiste mbarë botën. Shpallja e Republikës dhe abrogimi i Kalifatit, të mos përzierit e çështjeve fetare me ato kombëtare dhe shumë reforma rrënjësore të këtij lloji, jo vetëm që siguronin dhe e forconin brenda shtetin turk, por, e shtynin edhe popullin në një rrugë përparimtare. Pas gjithë këtyre çudirave që po bënte Mustafa Qemali, s’kishte asnjë dyshim se, jo vetëm shteti, por dhe populli turk, shumë shpejt do të shijonin frytet e kësaj pune me të vërtetë patriotike.

60. *Dielli*, nr. 229, 8.3.1924, f. 1.

Artikulli bënte dhe një analogji mes lëvizjes së nacionalistëve turq për të shpëtuar Anadollin dhe nacionalistëve shqiptarë që kishin luftuar rreptësisht për të ndaluar copëtimin e Shqipërisë, e që më vonë “mbajtën Mbledhje Kombëtare në Lushnjë dhe shpëtuan Shqipërinë nga copëtimi. Dhe mbledhjen e Lushnjes me të drejtë mund ta barazojmë me punët e Asamblesë së parë të Ankarasë”.⁶¹ Në fund ai mbyllet me fjalët: “Ja dhe një nga regjimet teokratike të botës, nga më të fuqishmit dhe më të vjetrit, i rrëzuar prej mendimeve të reja që po zhvillohen sot. Kalifati i sulltanëve të Perandorisë Osmane u rrëzua sot prej një grusht njerëzish me patriotizëm të pakufizuar. Idoli i myslimanizmit dhe përmbajtësi moral i lidhjes myslimane u rrëzua prej një grusht patriotësh, të cilët ndofta vepruan kundër dëshirës së popullit mysliman”.⁶²

61. *Gazeta e Korçës*, nr. 71, 25.3.1924, f. 2.

62. *Po aty*, f. 3.

Feja në shkolla, këndvështrim specialistësh të komunikimit ndërkulturor dhe të dialogut ndërfetar

MSc. Qani Sulku
Gazetar

Abstrakt

Një deklaratë e Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, për përfshirjen e një lënde mbi njohuritë fetare në kurrikulën e arsimit parauniversitar shkaktoi debat në mediat shqiptare online, audiovizive dhe të shkruara, si dhe sensacion në opinionin publik. Ajo që u vu re në këto diskutime ishte mungesa e specialistëve të komunikimit ndërkulturor dhe të dialogut ndërfetar, si njerëzit më kompetentë në këtë fushë, këndvështrimi dhe analiza e tyre është e rëndësishme dhe e nevojshme për tema të kësaj natyre. Si u prit dhe si u komentua deklaratata e Kryeministrit? Përse deklaratata të këtij lloji shkaktojnë reagime të shpejta në media, sipas mendimit të tyre? Sa qartë u kuptua deklaratata e dhënë nga kreu i qeverisë, nga opinionistët, të cilët ishin pjesë e paneleve televizive apo të shkrimeve në shtypin e përditshëm? A nënkuptonte Kryeministri në deklaratën e tij një lëndë të mirëfilltë fetare, apo lëndë e cila konsiston në studimin e historisë së feve? Sa të njëjta dhe të ndryshme janë këto të dyja? Këto dhe të tjera pyetje do të mundohemi t'i japim përgjigje nëpërmjet një interviste të zhvilluar me ekspertin e Komunikimit Ndërkulturor dhe Dialogut Ndërfetar, Prof. asoc. dr. Gentiana Skura, gjithashtu nëpërmjet një pyetësori të cilit i janë përgjigjur të diplomuar të profilin komunikim ndërkulturor gjatë vitit 2015, si dhe nëpërmjet një ankete të zhvilluar me nxënës të arsimit parauniversitar.

Hyrje

Deklarata e Kryeministrit Rama për futjen e një lënde fetare në kurrikulat e arsimit parauniversitar, e dhënë gjatë fjalës së rastit në programin kushtuar Profetit Muhamed, organizuar nga Komiteti Mysliman i Shqipërisë, më 9 prill 2016, shkaktoi debate dhe diskutime të shumta të fokusuara kryesisht në rrjetet sociale dhe mediat online, duke u shtrirë më pas edhe në mediat audiovizive e të shkruara. Duke mos qenë plotësisht e qartë, fjala e z. Rama shtyu opinionistë, analistë dhe të tjerë ta interpretojnë sipas këndvështrimit dhe perceptimit të tyre personal. Çështje që lidhen me fetë shkaktojnë vazhdimisht reagime të shpejta, sensacion dhe ndjeshmëri të lartë në një shoqëri si kjo e jona, meqenëse popullsia është e përkatësive fetare të ndryshme, apo edhe që nuk i përket ndonjë feje të caktuar. Dikush e kuptoi deklaratën e z. Rama si implementimin e një lënde të mirëfilltë fetare në tekstet shkollore; një tjetër e kuptoi si përfshirjen e një lënde e cila mund të jetë historia e feve, filozofia e feve apo kultura fetare. Të gjitha këto, sado të ndryshme apo të njëjta qofshin, sado dallime apo të përbashkëta të kenë, në fund të fundit kanë të bëjnë me komunikim kulturash dhe qytetërimesh, pra me komunikim ndërkulturor apo edhe me dialog ndërfetar. Për këtë arsye

le të sjellim shkurtimisht konceptin e këtyre dy termave të rëndësishme, që lidhen ngushtë me thelbin e këtij punimi.

Termi *komunikim ndërkulturor* për herë të parë është përdorur nga antropologu Hall, i cili me “teaching culture” nënkuptonte “studimin e kulturës” në kuptimin e plotë të fjalës. Sipas Hall, përdërisa *kultura është diçka që mësohet, do të thotë se ajo mund të jepet si lëndë në shkollë*. Idetë e Hall u pranuan nga shkencat e komunikimit dhe u institucionalizuan si programe mësimore në SHBA në fillim të viteve ‘70. Komunikimi ndërkulturor mbështetet te termi i zgjeruar për kulturën, domethënë në studimin e kulturës si kompleks i sjelljeve subjektive (norma, vlera, etj.) dhe objektive (veprime, mënyra sjelljeje, gjuhë), etj.

Komunikimi ndërkulturor dhe ndërfetar është një fushë që synon studimin e mënyrës se si njerëz me origjinë të ndryshme kulturore përpiqen të komunikojnë. Ai është një kombinim i fushës së antropologjisë, studimeve kulturore, psikologjisë, sociologjisë dhe komunikimit. Komunikimi ndërkulturor dhe ndërfetar është një nga drejtimet kryesore të marrëdhënieve të shoqërive dhe kombeve të ndryshme. Respektimi dhe ndërtimi i një dialogu me tjetrin, në kuptimin e një individi apo grupi që i përmbahet besimeve dhe vlerave të tjera religjioze dhe kulturore, është

mjeti kryesor për të mos u mbyllur brenda obsesioneve kulturore brendapërfshirëse.

Ajo që u vu re në diskutimet e shumta televizive mbi temën Feja në shkolla, si dhe në reagimet e ndryshme në median online e të shkruar, ishte mungesa e specialistëve të *komunikimit ndërkulturor* dhe *dialogut ndërfetar*, si njerëzit më kompetentë në këtë fushë, këndvështrimi dhe analiza e të cilëve është më se e nevojshme për tema të kësaj natyre. Si u prit dhe si u komentua deklarata e Kryeministrit? Përse deklarata të këtij lloji shkaktojnë reagime të shpejta në media, sipas mendimit të tyre? Sa qartë u kuptua deklarata e dhënë nga kreu i qeverisë, nga opinionistët, të cilët ishin pjesë e paneleve televizive apo të shkrimeve në shtypin e përditshëm? A nënkuptonte Kryeministri në deklaratën e tij një lëndë të mirëfilltë fetare, apo lëndë e cila konsiston në studimin e historisë së feve? Sa të njëjta dhe të ndryshme janë këto të dyja? Këto dhe të tjera pyetje do të mundohemi t'i japim përgjigje nëpërmjet një interviste të zhvilluar me ekspertin e Komunikimit Ndërkulturor dhe Dialogut Ndërfetar, Prof. asoc. dr. Gentiana Skura, gjithashtu nëpërmjet një pyetësori të cilit i janë përgjigjur rreth 20 të diplomuar të profilit komunikim ndërkulturor gjatë vitit 2015, si dhe nëpërmjet një ankete të zhvilluar me nxënës të arsimit parauniversitar.

1. Këndvështrimi dhe analiza e specialistes së komunikimit ndërkulturor dhe dialogut ndërfetar

Në diskutimet e shumta televizive, si dhe në shkrimet e publikuara online apo në shtypin e shkruar, në lidhje me çështjen “Feja në shkolla”, hasëm rrallë, ose më saktë nuk dëgjuam opinionin e specialistëve dhe ekspertëve të *komunikimit ndërkulturor dhe dialogut ndërfetar*. Për këtë arsye u mor një intervistë me ekspertin e kësaj fushe, pedagogen e lëndëve Komunikim Ndërkulturor dhe Dialog Ndërfetar në Universitetin e Tiranës, Prof. asoc. dr. Gentiana Skura, për të përcjellë këndvështrimin e saj në lidhje me këtë temë.

Si eksperte e komunikimit ndërkulturor dhe dialogut ndërfetar, si e pritët deklaratën e Kryeministrit për futjen e lëndës fetare në shkolla?

-Nuk është hera e parë që flitet për këtë çështje. Ndër vite, herë pas here, është cekur kjo temë, por gjithmonë është debatuar në media dhe ka mbetur me kaq. Për shembull: kujtoj se në prill të vitit 2012, është diskutuar në Komisionin Parlamentar të Arsimit dhe Medias bashkë me përfaqësuesit e komuniteteve fetare, ku këta të fundit kërkuan futjen në kurrikulën e arsimit parauniversitar të një lënde për të dhënë njohuri rreth feve, por që më vonë nuk pati ndonjë hap konkret në këtë drejtim.¹

Pra propozimi për të implementuar në tekstet e arsimit

1. Intervista me Prof. asoc. dr. Genta Skura
<https://youtu.be/xFqkcBbMwzI>

parauniversitar një lëndë mbi njohuritë fetare nuk është diçka e re. Pikërisht përpara 4-viteve është hedhur e njëjta ide, por që mbeti në suazat dhe kuadrin e një propozimi pa shkuar më tutje në zbatim. E njëjta ide e para katër viteve nuk pati të njëjtin fokus mediatik krahasuar me atë të këtij viti, por pyetja që lind natyrshëm është:

Përse deklarata e shefit të qeverisë shqiptare shkaktoi debat në media nga personalitete të fushave të ndryshme, të cilët nuk nguruan të japin deklarata apo mendime pro dhe kundër implementimit të lëndës rreth fesë në shkolla?

*-Gjithmonë kur flitet për çështje që kanë të bëjnë më fenë apo besimet fetare shoqëritë janë të ndjeshme. Kështu që nuk besoj se ne bëjmë përjashtim në këtë aspekt. Për sa i përket debatit, padyshim që e konsideroj konstruktiv. Është një arenë mendimesh, që pavarësisht se mund të jenë pro dhe kundër, patjetër që do të kontribuojnë në qartësimin dhe argumentimin e futjes ose jo të lëndës në fjalë në sistemin tonë arsimor publik”.*²

Ajo që zgjeroi debatin mediatik ishte paqartësia e deklaratës së Kryeministrit, pasi nuk u bë e qartë nëse nënkuptonte implementimin e një lënde të mirëfilltë fetare apo kulturë fetare dhe histori të feve. Pikërisht këtu lind pyetja: Sa janë të njëjta dhe të ndryshme termat “lëndë fetare” dhe “histori e feve”?

*-‘Lëndë fetare’ dhe ‘histori e feve’ duken sikur janë të njëjta, pasi të përbashkët kanë fjalën ‘fe’, por në realitet janë të ndryshme. E para ka të bëjë me teologjinë, ndërsa e dyta me historinë e zhvillimit të feve (monoteiste: judaizmin, krishterimin dhe islamin; por dhe budizmin, hinduizmin, konfucizmin etj.) e komunikimin mes tyre. Thënë ndryshe, lënda mësimore e religionit nënkupton mësim-besimin e një konfesionit fetar të caktuar, duke mos e përzjer atë me fe të tjera. Kjo formë mendoj se është goxha komplekse për t’u realizuar në vendin tonë.*³

Lënda e Komunikimit Ndërkulturor dhe Dialogut Ndërfetar, që zhvillohet në Universitet, ofron, veç të tjerash, edhe njohuri të përgjithshme mbi fetë, si: Islami, Krishterimi dhe Judaizmi, si dhe parime bazë të secilës prej tyre. Specialistja Skura shpjegon se kurrikula e lëndëve që ajo jep është e bazuar mbi kurrikulat bashkëkohore të universiteteve evropiane dhe amerikane. Ka kaq shumë modele të kësaj disipline e aq më tepër edhe botime bashkëkohore të studiuesve në Evropë e SHBA.

-Shumë studiues në veprat e tyre mbështeten si te Bibla, ashtu edhe te Kur’ani, duke u përpjekur t’i analizojnë në këndvështrimin shkencor e laik, si: France Farrago, Karen Armstrong, Bernard Lewis, etj., të cilët i analizojnë fetë monoteiste në këndvështrimin

3. Intervista me Prof. Asoc. Dr. Genta Skura <https://youtu.be/xFqkcBbMwzI>

2. Po aty.

*historik, komunikimin mes tyre, ngjashmëritë apo edhe dallimet.*⁴

Përgjatë intervistës, pedagogia Skura nuk nguron të pohojë se nuk është e interesuar që të njihet me përmbajtjen e lëndës mbi fenë që do të implementohet si projekt pilot, pasi nuk e sheh si prioritarë as për kohën dhe as për rrethanat shoqërore të vendit tonë.

Edhe pse projekti pilot që është propozuar nuk është vënë ende në zbatim, nxënësit kanë dëgjuar dhe lexuar rreth feve në tekstet e “Historisë”, Sociologjisë apo Filozofisë, madje në këto lëndë janë vënë re gabime të mëdha e trashanike, si për shembull: Në tekstin e Sociologjisë, klasa e 11⁵, ku thuhej se *Muhamedi është i biri i Zotit* (ndërkohë sipas fesë islame, Muhamedi është i Dërguari i Zotit). Ja se çfarë thotë profesoresha Skura: *“Në fakt, nxënësit shqiptarë njihen me fetë, pasi në libra të tillë si Historia e qytetërimeve, Sociologjia, Filozofia, trajtohen tema të tilla. Nëse vendoset që të futet në kurrikul një lëndë*

*e tillë, padyshim që sfidat janë të mëdha. E para, teksti do të detyrojë hartuesit që të rishihen edhe tekstet e lartpërmendura, të mos bien në përsëritje, por nga ana tjetër, del një problem i madh - mësuesit. Çfarë përgatitje duhet të kenë ata që të jenë të kualifikuar për një lëndë mbi fetë. Po ashtu, të mos harrojmë që, përveçse mësues, duhet të jenë shumë të kujdesshëm në mënyrën se si do t'i qasen tematikave të ndryshme, pasi nxënësit janë të përkatësive të ndryshme fetare; kush më shumë e kush më pak apo aspak, mund të vijë nga familje praktikante etj. Kështu që çështja e mësuesve duhet të trajtohet me kujdesin e dubur.”*⁶

Pedagogia rrëfen edhe se si janë pritur nga studentët e saj të përkatësive të ndryshme fetare dy lëndët që ata kanë studiuar në drejtimin komunikim ndërkulturor: *“Shoqëria jonë i përket besimeve të ndryshme fetare dhe kësajsoj edhe studentët. Në fakt, dialogu ndërjetar është zhvillimi dhe komunikimi mes besimeve fetare dhe feve të ndryshme, ky i përqendruar më shumë në shëkujt e fundit. Interesimi i studentëve sa vjen e shtohet, madje in duket një fushë shumë interesante dhe dinamike për t'u studiuar. Po ashtu, ka pasur edhe studime më të thelluara në tema të kësaj fushe. Në lidhje me reagimet, mund të them që diskutimet e shumta mbi literaturën e po ashtu mbi çështje të rëndësishme që lidhen me komunikimin ndërkulturor e ndërjetar,*

6. Po aty.

4. Po aty.

5. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përmes një shkrese zyrtare i pati dërguar ministres së arsimit znj. Lindita Nikolla një kërkesë për rishikim të teksteve shkollore ku trajtohen çështjet fetare Islame, për të cilat në disa raste janë konstatuar edhe gabime dhe pas kësaj shkrese u bë dhe korigjimi i tekstit. (Shën. i redaksisë) <http://www.dritaislame.al/pas-kerkeses-se-kmsh-se-ministria-e-arsimit-korigjon-tekstin-e-sociologjise/>

i kanë bërë studentët të thellohen më shumë në këtë disiplinë e të reflektojnë mbi atë çka ndodh edhe në realitetin e sotëm në vend dhe botë”.⁷

2. Këndvështrime rreth temës nga të sapodiplomuar në komunikim ndërkulturor

Për të njëjtën çështje u organizua një pyetësor me përafërsisht 20 të diplomuar gjatë vitit 2015 në drejtimin Komunikim Ndërkulturor. Këtu po japim disa prej komenteve të përzgjedhura:

Aulon Kalaja – me profesion gazetar / drejtues i emisionit “Flakë për Flakë” në televizionin “Zjarr”:
“Jam pro mësimi fetar në shkollë, por qeveria duhet të marrë masat që këtë lëndë ta japin profesionistët dhe të mos shërbejë si orë mbushëse, për të paguar mësuesit zëvendësues! Është më mirë të merret kulturë e përgjithshme mbi fenë në shkollë se sa fëmijët t’i atashohen sekteve të dyshimta, që kanë kaluar deri në lavazh truri dhe vetëvrasje! Feja është gjë e mirë dhe nuk duhet stigmatizuar me lajme dhe komente denigruese për një fe të caktuar, sepse asnjëra nga fetë nuk ka si qëllim negativitetin, por rrugën e drejtë për njerëzimin. Kjo duhet kuptuar dhe duhet të përfshihet në mësimdhënie.”⁸

Arjola Breshanaj, e cila i përket fesë së krishterë, u shpreh: “Nuk kam

asgjë kundër lëndës fetare në shkollë, por që të jetë alternative dhe jo e detyrueshme”.⁹

Eni Ferhati, gazetar në Top Channel, dha këtë koment: “Jam pro idesë për t’u përfshirë në kurrikulat e arsimit parauniversitar njohuri fetare, por jam kundër që të jetë një lëndë më vete. Them që të implementohet te ndonjë lëndë ekzistuese si p.sh.: Sociologji, Edukatë qytetare, etj., dhe informacioni të jetë sipërfaqësor dhe jo narrativ për praktikën e fesë, sepse në këtë mënyrë shmanget predikimi. Duhet gjetur balanca midis informacionit dhe predikimit”.¹⁰

Elira Kadriu, gazetare e ish-emisionit “Shqip”, u shpreh: “Jam absolutisht dakord, nëse ka të bëjë me rrafshin e historisë së fesë më tepër sesa njohjen e saj, pasi mendoj se çdo nxënës do të ishte mirë të kishte njohuri për lindjen e fesë, përhapjen dhe ndikimin e saj në kulturë dhe shoqëri. Kjo gjë është shumë e rëndësishme sidomos tani me konfliktet madhore që kanë lindur së fundmi”.¹¹

3. Anketë me nxënës të arsimit parauniversitar

Për të bërë një punim të saktë, profesional dhe të plotë, nuk u mjaftuam vetëm me intervistën e specialistes së komunikimit ndërkulturor apo të diplomuarve në këtë drejtim, por zhvilluam gjithashtu edhe një anketë drejtuar më shumë

7. Intervista me Prof. asoc. dr. Genta Skura
<https://youtu.be/xFqkcBbMwzI>

8. Komete rreth temës nga të sapodiplomuar në Komunikim ndërkulturor
<https://youtu.be/aM-HAWRJMv8>

9. Po aty.

10. Po aty.

11. Komete rreth temës nga të sapodiplomuar në Komunikim ndërkulturor
<https://youtu.be/aM-HAWRJMv8>

se 150 nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, kryesisht të kryeqytetit, por edhe të rrethinave të tij, nxënës nga klasa e pestë e deri në klasë të njëmbëdhjetë, të cilëve iu shtrua pyetja: *A jeni dakord që të ketë një lëndë mbi besimet fetare në shkolla?* Gati 100 % e nxënësve dhanë këtë përgjigje: *Po, jemi dakord që të ketë një lëndë të tillë*, ndërsa një përqindje më e vogël shtoi se *kyo lëndë duhet të jetë me zgjedhje dhe jo e detyrueshme*.

4. Lënda fetare në shkollat evropiane

Lënda e kulturës fetare zhvillohet në 40 shtete të Evropës. Në Austri mësimi fetar mbahet në të gjitha shkollat e vendit. Në Gjermani kushtetuta e garanton mësimin fetar në shkollat shtetërore si lëndë "normale". Në Angli, mësimi fetar është pjesë e plan-programit mësimor. Në Spanjë, mësimi fetar, në rend të parë ai katolik, në shkollat shtetërore, është lëndë fakultative (lënda vlerësohet, mirëpo nota nuk merret për bazë në rastin e regjistrimit në shkolla). Në Belgjikë, po ashtu zyrtarisht, edukata fetare është e garantuar me ligj. Pjesë e kësaj edukate është edhe ajo islame. Në Greqi, si anëtare e Unionit Evropian, ende është në fuqi ligji i vitit 1930, i cili favorizon fenë ortodokse, kurse në mënyrë flagrante shkelen të drejtat e pakicave fetare. Mësimi fetar është i obliguar për nxënësit që deklarohen si ortodoksë. Në Irlandë,

kushtetuta garanton të drejtën e prindërve që fëmijët e tyre të marrin jo vetëm njohuri fetare, por edhe edukatë fetare. Mësimi fetar është i obliguar edhe në Finlandë e Danimarkë, të cilat kanë kishat e tyre shtetërore nacionale. Norvegjia e ka kishën shtetërore, si dhe e ka të obligueshme mbajtjen e mësimin fetar. Nëpër shkolla ku ka numër të konsiderueshëm të pakicave fetare, mund të organizohet mbajtja e mësimin fetar. Shteti i pranon dhe i paguan mësimdhënësit e lëndës fetare. E njëjta situatë është edhe në shtetet e tjera skandinave. Në Hungari, mësimi fetar është lëndë fakultative dhe nuk është e përfshirë në plan-programet shkollorë; mësimdhënësi fetar nuk është anëtar i këshillit mësimor, por nëpunës kishtar, që e paguan shteti. Në Poloni mësim-besimi është i obliguar dhe është në kuadër të plan-programit shkollor. Më se 20.000 mësimdhënës fetarë kanë statusin e mësimdhënësve të rregullt që prej vitit 1997. Për rrogat e tyre vjetore shteti ndan afërsisht 85 milionë dollarë. Në Itali, prej vitit 1985, pas nënshkrimit të marrëveshjes (konkordatit) me Vatikanin, mësimi fetar është lëndë sipas dëshirës. Në Lituani, gjithashtu, mësimi fetar është lëndë sipas dëshirës.¹²

12. <http://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=2842>

5. Përfundime dhe sugjerime

Në përfundim të këtij kërkimi dhe punimi shkencor po përcjellim edhe këndvështrimin tonë rreth projekt-idesë së propozuar nga qeveria aktuale për përfshirjen e fesë në shkolla. E mendojmë si një projekt të vonuar, pasi duhej implementuar në kurrikulat parauniversitare menjëherë pas rikthimit të sistemit demokratik në vend në vitin 1992 e këtej. Ndërsa sa i përket krahasimit, nëse duhet të jetë një lëndë e mirëfilltë fetare, apo histori fetare dhe sa të ndryshme apo të njëjta janë; do të thoshim se kanë të përbashkëta, pasi edhe në historinë e filozofinë e feve jepen parimet bazë të secilës fe, profeti përfaqësues i fesë përkatëse, si dhe informacione të tjera rreth lindjes dhe përhapjes së feve në vende dhe territore të caktuara, por sigurisht që të gjitha këto nuk e kalojnë prapë e propagandës fetare. Jemi të mendimit që të jetë një lëndë që përfshin njohuri dhe informacione bazë për të gjitha besimet, që do të përzgjidhen për të qenë pjesë e kurrikulës, ndërsa mësuesit duhen trajnuar me profesionalizëm pranë komuniteteve përkatëse, me qëllim që të jenë të paanshëm gjatë mësimdhënies. Hartimi i kësaj lënde duhet bërë me mbështetjen e specialistëve të

akredituar nga komunitetet fetare në vend. Kjo lëndë duhet të jetë e detyrueshme për të gjithë nxënësit e përkatësive të ndryshme fetare dhe afetare, pasi vetëm kështu ata mund të njihen me kulturën dhe njohuritë bazë të feve, por edhe mbi fenë dhe kulturën e tjetrit, çka do të ndihmojë në njohjen më mirë të tjetrit, në eliminimin e keqkuptimeve dhe perceptimeve të gabuara, si dhe në zgjerimin e shkëmbimit të kulturave dhe subkulturave. Besojmë se një lëndë e tillë do të jetë shumë herë më me vlerë se sa disa lëndë që janë përfshirë vitet e fundit në kurrikulën e arsimit parauniversitar, pasi impakti dhe efekti i kësaj lënde do të jetë shumë pozitiv në rrafshin individual, kolektiv dhe kombëtar.

Për sa i përket diskutimeve në media rreth kësaj çështjeje, por dhe çështjeve të tjera, mendojmë se nuk kanë qenë produktive, pasi nuk kanë dalë në konkluzione apo përfundime konkrete për t'u marrë në konsideratë. Autorët e programeve, nëpërmjet këtyre debateve, mesa duket kanë synuar rritjen e audiencës dhe konkurrencën televizive sesa janë fokusuar te çështja që trajtohet, për të dalë më pas me dy-tre pika kyçe, që mund t'i drejtohen institucioneve kompetente dhe përgjegjëse për t'i shqyrtuar.

Literatura e konsultuar

Casmir, Fred L. 1997: Intercultural and International Communication. Washington.

Maletzke, Gerhard 1970: Intercultural and International Communication.

Kruja Genti: Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar. Tiranë: Prizmi.

Farago France. 2007. Krishterimi, Judaizmi, Islami dhe mendimi perëndimor. Tiranë: LIRA.

Rrugë drejt dialogut ndërfetar. 2010. Studime dhe refleksione. Tiranë.

Intervistë me Prof. asoc. dr. Gentiana Skura.

Pyetësori drejtuar të sapodiplomuarve në drejtimin Komunikim ndërkulturor.

Anketa me nxënës e nxënëse të shkollave të kryeqytetit dhe rrethinave të tij.

Iljas Bej Mirahori, një personalitet i shquar shqiptar (1410-1512)

Hysen Kobellari, Ph.D.

Abstrakt

Nga thellësitë e shëkuqjve na vijnë shenja, të dhëna, fakte e dokumenta interesante për një personalitet të shquar e të rëndësishëm shqiptar dhe jo vetëm shqiptar, të periudhës së mesjetës – Iljas bej Mirahorin. Kjo figurë madhore, pak e ndriçuar nga historiografia jonë, por i përjetësuar në memorien e popullit, i kalon caqet e historisë së një vendi, për nga ndikimi dhe veprimtaria e gjerë, e gjatë dhe e shumanshme në kohë dhe hapësira. S. Frashëri, N. Naçi, Ilo Mitkë Qafëzezi, P. Pepo, S. Pulaha, S. Ramo, etj., kanë dhënë informata me rëndësi e të vlefshme për të ndriçuar sadopak këtë figurë sa shumëplanëshe, aq madhështore e tërheqëse. Janë me mijëra faqe dokumentash e shkresash që dergjen nëpër arkivat e Turqisë; në Arkivin e Shtetit në Tiranë, në fondin me emrin e tij, gjenden katër dekrete (fermanë) të Sulltanit, që u përkasin viteve 1484, 1496, 1497 dhe 1503; tregime, këngë e legjenda gjallojnë akoma në popull për jetën dhe veprat e tij; toponime, kufij, emra vendesh dhe objektesh e përkujtojnë edhe sot e kësaj dite, pas pluhurit që lë pas barresa e shëkuqjve. Pasuria e lënë prej Mirahorit ndodhet në disa vende të Ballkanit, ndoshta në dy kontinente; veprimtaria bamirëse dhe qytetëruese iluminuese e Iljas Beut është ndër të parat dhe ndër më të rrallat në kontinent; pasardhës të tij jetojnë ende në Korçë e gjetin nën mbiemrin Myteveli, vëllezërit Frashëri kanë qenë nga nëna e tyre, stërnipër me famë, dijetarë e mëmëdhetarë të dobishëm e të njohur; një monument madhështor kulture dhe historie u ka rezistuar kohërave, Xhamia “Iljas bej Mirahori”, ndër më të vjetrat dhe më të bukurat në rajon; e mbi të gjitha një qytet i tërë, Korça, sa i lashtë, po aq edhe i ri, i bukur e bashkëkohor mban emrin e tij...



Xhamia e Iljaz bej Mirahorit, Korçë

1. Vendlindja dhe paraardhësit

“Ilia ishte një fshatar trim me origjinë nga fshati Panarit që bënte pjesë në Kazanë e Përmetit, të varur nga Vilajeti i Janinës” (Sami Frashëri “Kamus-Ul-Alam”)

Nga të dhënat konkrete, për të cilat kanë rënë dakord të gjithë studiuesit, është qartësuar se Iljas bej Mirahori u lind në fshatin Panarit të Qarkut të Korçës, fshat i cili kufizohet me fshatra të tjerë të rretheve Korçë, Kolonjë, Përmet dhe Skrapar. Gjatë sundimit osman të vendit tonë dhe të krejt Ballkanit, në ekspeditat e viteve 1385 dhe 1431, fshati Panarit bënte pjesë në Ziametin e Çakderit, ose siç e quanin turqit Vilik-Ili (Pronat e Vilikut). Emri i këtij fshati vjen nga fjala e lashtë

shqipe *panare*, që përdoret edhe sot në Krahinën e Oparit e gjetkë, që do të thotë, vend i ngritur, kapuç, shport. Profesor Çabej ka shpjeguar se emri Panarit afrohet me fjalën greke *panaris*, që do të thotë shport, por ka ndryshim në theksim.

Këtë emër ka edhe një fshat afër Këlcyrës. Me emrin Panarit janë disa fshatra në Greqi, tre prej të cilëve kanë origjinë nga ai i Korçës, për shkak emigrimi. Madje edhe në SHBA ndodhet një vend me emrin Panarit...

Iljas bej Mirahori u lind në fshatin Panarit të Korçës midis viteve 1408-1410. Emrin fillestar e kishte Ilia, si bir i priftit të kishës më të madhe të fshatit; ky është një emër shenjtor i krishterë, Shën Ilia. Për emrin e

të atit nuk ka të dhëna, përveç asaj se në Testamentin fetar të Mirahorit, të quajtur Vakëfname, i shkruar në vitet 1504-1505, emri i islamizuar është Abdullah. (Vakëfnameja është shkruar në gjuhën arabe, me dorë, në një letër të trashë rreth 7 metra të gjatë, përkthyer pa autor dhe botuar nga Petraq Pepo.) Për emrin e nënës deri tani nuk ka asnjë të dhënë.

Babai ishte edukatori i parë i misionarit me famë. Duke qenë prift me emër e me kulturë, i dëgjuar dhe i njohur jo vetëm në Panarit, por në gjithë Ziametin e Çakderit, ai ndikoi fort në formimin e karakterit të djaloshit, që në vitet e para të jetës së tij. Prift, bujk, blegtor, zanatçi i mirë, me veti të larta njerëzore, njeri me kulturë të qëndrueshme.

Porteti, karakteri dhe tiparet e Ilias janë transmetuar brez pas brezi nga veteranët në kujtimet e tyre... Ishtenjë djalë i fortë, i zgjuar, i hijshëm e trim; trup gjatë e shpatullgjërë. Sytë e tij, që shkëlqenin si uji i burimeve të Soropullit, shihnin larg, si sytë e shqiponjës. Fytyra e tij hijeshohej nga flokët e dendur, të ashpër e pak të dredhur, ashtu si pllajat e sheshet e bukura të fshatit të lindjes. Duke jetuar mes panaritasve të dalluar si blegtorë e muratorë shumë të zot, këto zanate ai i përvetësoi shpejt e i nguliti në kujtesë, çka e ndihmuan të kishte sukses të madh në jetë, kudo që shkoi. Njeri plot virtyte, i urtë, durimtar dhe i sakrificës për gjithë jetën e vet të gjatë e plot peripeci.

Pema e Madhe, pengu i atdhedashurisë dhe kujtesës

Puna e parë që bëri sapo u kthye në vendlindje ishte mbjellja e një peme, pikërisht në atë vend, të cilin e kishte lënë përpara gjashtëdhjetë e ca vitesh. Për shumë shekuj ai vend u quajt "Pema e Madhe". Ky vend është në lindje të fshatit Panarit të Korçës, mbi rrugën për në fshatin Treskë, afër Bogovës. Të moshuarit edhe sot i mbajnë mend kujtimet e trashëguara brez pas brezi për Pemën e Madhe. Ajo ishte një pemë e veçantë; një krijesë drunore të tillë kurrë nuk ka patur në tërë Zonën e Vakëfeve, siç u quajt më vonë. Thuhet se këtë pemë e kishte mbjellë vetë Iljas bej Mirahori, me farën e sjellë nga Stambolli i largët. Kur ai i ktheu pronat e tij në Vakëf, bëri të tillë edhe arën e vetme Jeze Bexhik, në kufijtë e fshatit Panarit, vetëm se aty ishte Pema e Madhe, pengu i dashurisë dhe kujtesës. Vendi aty ka shërbyer si Vakëf i shenjtë.

Pas shumë e shumë vitesh pema u tha, ngaqë ishte shumë e vjetër, nga gërryerjet e ujrave, por më tepër ngaqë i zoti i saj nuk ishte më në jetë; koha, vetmia dhe harresa than e përthan çdo gjallesë që gjendet mbi dhe... Pema u tha, por vendi ndër shekuj vazhdoi të quhej Pema e Madhe. Banorët deshën të mbillnin një pemë tjetër në atë vend, por ngaqë nuk e gjetën farën e së parës e për ta nderuar atë, thjesht e shndërruan vendin në një muranë përkujtimore.

Edhe kur në vendin tonë me ligj u ndaluan besimi dhe veprimtaritë fetare, panaritasit aty luteshin e faleshin; te ky vakëf i shenjtë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të kërkojnë ndihmën e Perëndisë...

Hanet e Mirahorit - falas për panaritasit shtegtarë ...

Qyteti Korçës, i themeluar nga Iljas Hoxha, para shumë shekujsh ka patur disa hane, natyrisht, të ndërtuara që në kohën e tij. Kur shkonin në qytet për pazar, banorët e fshatrave malore të Vakëfeve kalonin ditën ose natën nëpër hane. Për vite e vite me radhë, fshatarët panaritas shkonin në hanet e Mirahorit, kalonin aty natën dhe nuk paguanin taksa për kohën e qëndrimit, duke përfituar falas edhe tagji e ujë për kafshët e tyre. Thuhet se Iljas bej Mirahori e kishte lënë me gojën e vet si amanet që fshatarët e Vakëfeve të mos paguanin asnjë taksë edhe pas vdekjes së tij; ky amanet u zbatua për një kohë të gjatë, saqë këto tregime i rrëfejnë edhe sot të moshuarit e fshatit Panarit të Korçës. Jo vetëm kujtimet e veteranëve, por edhe dokumentet kadastrale të periudhës së sundimit osman vërtetojnë privilegjet që gëzonin panaritarët në atë kohë...

2. Epoka – Parakalim telegrafik Sulltanësh ...

Iljas bej Mirahori, ose ndryshe Ilija Panariti, pati një jetë të gjatë e plot peripeci, brodhi botën, në Europë, Turqi, Persi, Ballkan e gjetkë, kaloi nëpër ngjarje me rëndësi të madhe

për njerëzimin, derisa mbylli sytë në dheun që e lindi, në moshë mbi njëshekullore. Për martesën e tij nuk ka të dhëna të dokumentuara. Nuk na duken të sakta të dhënat e pabazuara në disa shkrime, ku thuhet se Mirahori është martuar me të bijën e Sulltan Mehmetit II, por që është martuar në rrethin e oborrit sulltanor, kjo është më e arsyeshme...

Ai jetoi e veproi nën epokën dhe sundimin e këtyre sulltanëve osmanë: *Sulltan Murati i Dytë (1404-1451)*, djali i Çelebi Sulltan Mehmetit, nipi i Bajazitit, i cili ka hipur në fronin sulltanor në moshën 18 vjeçare. Ishte i gjashti sulltan në atë fron. Mbretëroi duke luftuar me kryqtarët dhe kryengritësit; pasi vendosi dhe konsolidoi paqen në perandorinë e tij, ia dorëzoi fronin të birit, Princit Mehmet II dhe u largua për në Manisa, por nuk qëndroi gjatë aty, se rifilluan sulmet e kryqtarëve dhe vezirët e thirrën të merrte përsëri fronin. Shkroi poezi shumë të bukura dhe fliste me fjalë të rimuara.

Fatih Mehmet Hani (1432-1481), djali i Sulltan Muratit të Dytë, sulltan i 7-të i Perandorisë Osmane. Ka marrë Stambollin dhe ka qenë jo vetëm luftëtar, por edhe pasionant dhe dashamirës i dijeve dhe kulturës. Themeloi disa universitete dhe xhami, duke u marrë me arte, muzikë e letërsi; ka patur poetë që janë ndikuar nga arti i tij poetik.

Adliu - Bajaziti i Dytë (1447-1512), djali i madh i Fatih Sulltan Mehmetit të Dytë. Teksa u bë guvernator në Amasya, jeniçerët e lutën që të bëhej Sulltan, por i vëllai, Xhema e kundërshtoi emërimin e të vëllait në postin që po mbante vetë. Ka ndërtuar shumë universitete, xhami dhe mensa publike, duke qenë mbrojtës i madh i arteve. Ka qenë mjeshtrë i madh i artit të pikturës kaligrafike, ndërsa në poezitë e tij përdorte pseudonimin letrar Adliu. Për këtë sundimtar Iljas Mirahori u bë edukator në dije, kulturë dhe fe. Me kohë u bë edhe vjehri i tij. Me Ferman të këtij Sulltani, Iljas bej Mirahori u nis për në vendlindje, u bë zotëruar i trevave të gjera tokësore, rindërtoi qytetin e Korçës, duke e bërë strumbullar të një zone të tërë të begatë e të rilindur...

Princi Xhemë (1454-1495), djali më i vogël i Sulltan Mehmet Pushtuesit, kunati i vajzës së Iljaz bej Mirahorit, i arsimuar më së miri. Ka bërë kryengritje kundër vëllait të tij Sulltan Bajazitit II, duke marrë ndihmë nga pashallarë dhe popullsia e disa qyteteve. Bajaziti e mundi Xhemën, ndërsa ky gjeti strehim te Mamlukët egjiptianë. Kalorësit e St. Joh, me në krye Mjeshtrin e Madh të Kalorësve, kur ai arriti në Rodus e pritën me nderime, pastaj e çuan në Francë. Me urdhër të Papa Aleksandrit VI është burgosur. Ka qenë poet i shquar dhe ka shkruar poezi në gjuhën perse dhe turke.

Javuz Sulltan Selimi (1466-1520), djali i Sulltan Bajazitit II, nipi i Iljaz bej Mirahorit, një nga Sulltanët më luftarakë dhe poet i shquar. Shkroi në gjuhën perse dhe osmane, duke përkrahur artet dhe njerëzit e artit; ka mbrojtur shkencëtarët dhe gjykonte siç gjykojnë poetët.

Kerim Princ Korkuti (1470-1513), djali i Sulltan Bajazitit II, nipi i Mirahorit. Ka qenë ulur në fronin sulltanor vetëm për 17 ditë. Për shumë kohë luftoi kundër babait të vet, derisa u asgjësua. Një fis me mbiemrin Korkuti kanë jetuar në Plasë të Korçës dhe thuhet që i ka prurë Iljaz bej Mirahori me vete, kur themeloi Korçën. I shkolluar mirë, mbrojtës i zjarrtë i artit, ka qenë edhe kaligrafist i mirë. Ka kryer studime shkencore në gjuhën arabe dhe në osmanisht.

3. Jeta në Stamboll dhe kthimi në vendlindje

Pak të dhëna kemi për jetën e Iljas bej Mirahorit në Stamboll. Ato më kryesoret po i renditim telegrafisht:

- Me të mbërritur në Stamboll, pastaj në Edrene, kryeqendër e Perandorisë Osmane, nisi edukimi i Ilia Panaritit, më pas Iljaz bej Mirahori. Në fillim ai iu nënshtrua mësimin intensiv të gjuhës osmane, gjuhës arabe dhe mësimin të Kur'anit në original. Krahas këtyre, mësoi edhe shkenca të tjera. Ai nuk u trajtua si pengjet e tjerë, të cilët

mobilizoheshin si nizamë dhe jeniçerë, mbase edhe për arsye të moshës së njomë, por edhe për shkak të karakteristikave të veçanta e të spikatura intelektuale, me shenja gjenialiteti. Që në vendlindje ai dinte gjuhën shqipe, por mbase edhe greqishten. Edukimi i tij u kompletua nëpërmjet institucionit të iveriglanëve dhe të gulameve. U shkollua në Enderun-i Humajun në Edrene, sipas historianëve. Aty Iljas beu mori edhe gradën Lale - Profesor i Dinastisë Osmane... U bë një nga mjekët veterinerë më të zotë të Perandorisë.

- Studiuesi i talentuar, historiani osmanolog Selami Pulaha na i ka shpjeguar këtë sistem në veprën e vet “Pronësia feudale në tokat shqiptare” (f. 36) “Pushteti osman, gjatë një periudhe gati shekullore, përdori një varg rrugësh dhe metodash të karakterit ekonomik, politik dhe ideologjikofetar për të kthyer klasën feudale vendase, për ta zhdukur atë si forcë ekonomike dhe politike të pavarur. Zbatimi i tyre filloi herët, qysh në kontaktet e para shqiptaro-osmane, në fund të shek. XIV, me kthimin e feudalëve shqiptarë në vasalë të Sulltanit. Një vemendje të veçantë ai i kushtoi marrjes peng të fëmijëve të feudalëve, rritjes së tyre pranë oborrit të Sulltanit si pazh i oborrit ose pranë dijetarëve të mëdhenj ushtarakë, si gulame (djalë, bir)” Qëllimi ishte që duke iu dhënë djemve një

edukatë të tillë të lartë osmane dhe me zanate civile, të zëvendësonte klasën vendase feudale, me anëtarë të zakonshëm të klasës sunduese osmane, ndërthurur kjo edhe me karrierën ushtarake e administrative. Kjo ishte rruga kryesore e integritit, për të krijuar kështu mbeshtetjen politiko-shoqërore në vendet e pushtuara. Kjo politikë dha frytet e saj që herët në Ballkan. Pas kësaj përgatitjeje, nga njëra anë dhe për shkak të trimërisë dhe talentit të veçantë, mbase edhe të gjenialitetit, që tregoi Ilia Panariti në kryerjen e detyrave të ngarkuara nga Porta e Lartë, nga ana tjetër, do të merrte poste të ndryshme administrative e ushtarake gjatë periudhës së sundimit të Muratit II dhe të Mehmetit II. Kur u kthye në mysliman emri Ilia u bë Iljas. Në vitin 1453 u pushtua Kostandinopoja nga Potra e Lartë. Iljas beu mori pjesë në luftë dhe tregoi trimëri dhe zgjuarsis të madhe, si komandant i shquar ushtarak, duke udhëhequr kalorësinë dhe prapavijën. Për trimëritë dhe talentin e rrallë ushtarako-administrativ Iljasi kaloi nëpër poste të ndryshme gjatë periudhës së sundimit të Sulltanëve Murati II dhe Mehemeti II. Ai u bë gjithashtu edukator i Sulltan Bajazitit II, të cilit i dha pastaj për grua të bijën. Iljas beu u martua me një grua nga dera sulltanore dhe pati 3 djem dhe 3 vajza. Djemtë ishin: Muhamet, Mehmet dhe Sefer Shah Çelebi. Mehmet bej, ose Ine bej, siç e quan

Sami Frashëri është vrarë në luftë, në Bagdad; ky ka lënë një xhami në Stamboll me emrin e tij. Djali i parë vdiq para të atit dhe u varros në Korçë, ndërsa i vogli, pas të atit dhe e ka varrin në një tyrbe me të atin po në këtë qytet. Në Muzeun Kombëtar të Armëve në Tiranë, para disa vitesh është dorëzuar një shpatë nga një qytetar korçar, i cili e kishte marrë atë në varr-vakëfin pranë xhamisë “Iljas bej Mirahori”; shpata i përket personazhit për të cilin po flasim dhe mendohet se është dhuratë e Sulltan Bajazitit II për të... Vonë është përkthyer nga osmanishtja shënimi në tehun e kësaj shpate, dëshmi e historisë...

- Sapo Sulltan Bajaziti II hipi në fron, Iljas bej Mirahori u caktua Mirahor Evel, pra Gjeneral i Parë. Në lagjen Jedi Kule (shtatë kullat), në Kostandinopojë, ku ishte një kishë, me lejen perandorake Iljas bej Mirahori e ktheu në xhami, e cila, siç pohon Sami Frashëri në Enciklopedia turke, mbante emrin Xhamia e

Mirahorit, ose kisha-xhami; pranë saj ka një teqe, vakëf i Mirahorit.

Me leje dhe Ferman-Dekret Perandorak të Sulltan Bajazitit II, në pleqëri, pasi i kishte provuar të gjitha hyneret e jetës metropolitane osmane, Iljas bej Mirahori vendosi të kthehej në vatanin e tij, larg nga rrëmuja dhe rrëmeti, siç do të shkruante pas shekujsh poeti ynë kombëtar Naim Frashëri; kjo ndodhi para vitit 1484; mori si dhuratë nën pronësi tokat e mëmëdheut, të fshatrave të Vakëfeve dhe ato të Fushës së Korçës me rrethina. Pronat e blera fillimisht dhe pastaj të falura nga Sulltani, i mori me dokumentacion të rregullt, të noterizuara nga Kadiu dhe dëshmitarë të tjerë vendas dhe të ardhur. Këto dokumenta kanë mbërritur deri në ditët tona, gjë që tregon seriozitetin e administratës shtetërore të asaj kohe. Ky ndërtim u kompletua për shumë vite pune me radhë dhe veç ndërtesës së xhamisë, kompleksi-bërthamë i qytetit të ri kishte hanet, imaretin, medresenë,

Rrënojat e xhamisë së Mirahorit, Jedi Kule, Stamboll.





Medreseja e Mirahorit, Korçë

hamamin, etj. Më parë u ndërtuan Tyrbja dhe banesat e Iljas beut dhe shpurës që e shoqëronte. Në atdhe Iljaz bej Mirahori nuk erdhi vetëm, por me një bylyk njerëzish të rrethit farefisnor e miqsh, midis tyre edhe turq, arabë e afrikanë, të cilët formonin përnjëherësh një fshat të tërë në vendfushim. Një fis arab ka pasardhës edhe sot në fshatin Pojan, po edhe në fshatra të tjerë. Korça si qytet, në planet e Iljas Hoxhës ishte piketuar si një qendër rrethi me rrathë të tjerë bashkëqendrorë, me ndërtime e vendbanime nga të gjitha anët ...Mbeten mister qëndrimet dhe marrëdhëniet e tij me lëvizjet e Skënderbeut (Gjergj Kastrioti), etj., në Stamboll, Shqipëri dhe pas rënies së Krujës...

Iljas Bej Mirahori u bë Hafiz, Haxhi, dijetar i shkencave veterinerë, Vezir, administrator vizionar, etj. Njeri me përmasa të mëdha ishte ai në Perandorinë Osmane. Disa nga këto mjeshtëri i ushtroi edhe në atdhe, megjithëse në moshë të thyer... Ai ishte Hafizi i parë i xhamisë që ndërtoi vetë, mësues i

Medresesë, po ashtu edhe Myftiu i Parë i Krahinës.

Iljas bej Mirahori ishte edhe administrator kryesor i pronave të tij, të cilin turqit e quanin Myteveli, baras me Epitrop, Kujdestar, Administrator. Myteveli i parë ishte ai vetë, ndërsa me vonë, me Vakëfnamenë e vitit 1505-ës, ku ai caktoi fondacionet, që do krijoheshin me pronat dhe pasurinë e vet, Myteveliu do të ishte nga vatra e familjes së vet brez pas brezi. Edhe sot në Korçë ka pasardhës nga fisi i Mytevelinjve të fundit, familja e Rustem Hysen Myteveliu, inxhinier urbanist i njohur; nga ky fis është dëshmorja e atdheut rënë gjatë Luftës së II të Përbotshme Floresha Myteveli, emrin e së cilës e mban një rrugë afër Xhamisë "Iljas bej Mirahori" të qytetit të Korçës...

- Iljas bej Mirahori ka jetuar, vepruar dhe ka lënë histori e prona në Stamboll (Lagjja e Xhamisë Jedi Kule-7 Kullat dhe Ivllanka); në Janinë, sepse Sulltan Bajaziti II e emëroi në postin e Valiut të Janinës (Dekretet 1496-7), duke e quajtur "Beu i Sanxhakut të Janinës"; në Korçë me rrethina, ndërtoi xhaminë e famshme, një nga më të lashtat në rajon, me projekte të xhamisë së Firuz Agait në Stamboll, vakëfin e Tarikatit Symblyl pranë saj, shkollën, tregun si bërthama të një qyteti të ri, të cilit i dha emrin e vet Koxha=Korça (Nuçi Naçi dhe Petraq Pepo). Iljas Beu erdhi në vendlindje në moshë

të thyer, ndaj për respekt prej vitesh kishte marrë emrin Koxha Mirahori, siç e thërrinin në Stamboll e Janinë. Ky emër vjen nga turqishtja, që shkruhet *Koca* e lexohet Koxha dhe ka dy kuptime: si mbiemër; i madh, i moshuar, plak; si emër, bashkëshort, burrë. Gjatë përdorimit në popull për një kohë të gjatë e përshtatjes në fjalorin vendas, fjala Koxha u shndërrua në Korça...

- Pasi njihesh me materiale e dokumenta të botuara e të pabotuara për personalitetin, jetën dhe veprën e Iljas Bej Mirahorit (Ilia Panariti), të lind një ndjenjë krenarie e ligjshme, mbushesh me ndjenja e mendime pozitive.

- Krenohesh me talentin dhe aftësitë e pashtershme të gjenit shqiptar, të cilat kur gjejnë kushte të përshtatshme për t'u zhvilluar në mënyrë të gjithanshme, çlirojnë energji të pashtershme për vepra të mëdha në shërbim të paqes e prosperitetit të mbarë njerëzimit.

- Bindesh në vazhdimësinë e besimit, drejt besimit më të mirë e të vërtetë, duke kultivuar gjithkund vetitë më të mira të qenies njerëzore.

- Beson në frytshmërinë e prurë si vlerë e shtuar, me krijimin e kushteve më të mira për zhvillim të shpejtë në vendbanimet e lashta, kushte të cilat kanë si baza: demokracinë, përvojën botërore, kulturën, harmoninë, tolerancën, humanizmin, diturinë, tregun e lirë, sjelljen e urtë e paqedashëse të administratës, etj. ...

Në kupolën e brendshme të Xhamisë "Iljas Bej Mirahori" të qytetit të Korçës është shkruar me idenë dhe dorën e themeluesit të saj, pesë shekuj e gjysëm më parë:

“O njerëz! Premtimi i Zotit është i vërtetë; mos t’ju mashtrojë jeta e kësaj bote; mos t’ju mashtrojë për Zotin, djalli mashtrues.” (Krijuesi-Fatir, ajeti 5, Kur’ani Kerim.)

Literatura kryesore e konsultuar:

- Sami Frashëri: “Kamus –Ul-Alam”- Enciklopedia turke.
Nuçi D. Naçi: “Korça dhe fshatrat përçark”, 1901.
Evlja Çelebi: “Shqipëria para dy shekujve”.
Pirro Thomo: “Korça, Urbanistika dhe Arkitektura”.
Univ. Tiranës: “Historia e Mesjetës”.
Gjerark Karaiskaj: “ 5000 vjet fortifikime në Shqipëri”.
Vexhi Buharaja: “Regjistri i Korçës dhe Përmetit”, shek. XV e XVI.
Petraq Pepo: Rev. Studime Historike, 1967 “Katër Dekrete të Sulltan Bajazitit të Dytë për Mirahor Iljaz Benë”.
Petraq Pepo: “Kodiku i Korçës dhe Selasforit”, etj.
Selami Pulaha: “Defteri i Sanxhakut të Vlorës”, dorëshkrim i filmuar.
Zija Shkodra: “Qyteti shqiptar”.
Vladimir Dino: Rev. “Tradita”, 2002, “Fshatrat me emrin Panarit në Greqi”.
Sejdin Ramo: “Ilia Panariti dhe Korça”, 2003.
Riza Lahi: “Lirika dashurie të Sulltanëve”, 2012, etj.

Duhet përkrahur feja

Rrapo Rustemi
Student i Medresesë së Përgjithshme

Abstarkt

Njeriu e ka në natyrë mirë-njoftjen dhe nderimin ndaj një shoku, prej të cilit ka pasë një mirësi qoftë edhe të vogël. Njeriu e veshtron me sy te mirë pasurin e tij, në qoftë se, prej sajë, ka korrë frytin e dobishem; aj gjithë një mundohet t' i bajë sherbimin e nevojshëm pronës së tij, mbasi prej sajë siguron ushqimet fizike, të cilat i ndihmojnë jetës së tij të perkobëshme.

استعِذ بالله: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا
أَنْصَارَ اللَّهِ كَمَا قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ لِلْحَوَارِيِّينَ
مَنْ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ
اللَّهِ ﴿صدق الله العظيم.

Njeriu e ka në natyrë mirë-njoftjen dhe nderimin ndaj një shoku, prej të cilit ka pasë një mirësi qoftë edhe të vogël. Njeriu e veshtron me sy te mirë pasurin e tij, në qoftë se, prej sajë, ka korrë frytin e dobishem; aj gjithë një mundohet t' i bajë sherbimin e nevojshëm pronës së tij, mbasi prej sajë siguron ushqimet

fizike, të cilat i ndihmojnë jetës së tij të perkobëshme.

Kur një i dashtun na dergon një dhuratë, për veç q' e falënderojmë tepër, por se na shtohet edhe një herë dashurija ndaj tij. Mandej dhuraten e ruajmë me pekul, e vëmë në një vend të posaçëm dhe, të gjithë, pothuaj, mbajmë për bazë proverbin Arab «Dhurata as këthehet e as shperdorohet - الهدية لا ترد ولا تعطى».

Atëhere, qysh të mos e falënderojmë, në menyrën më të meriuteshme, Perëndin, i Cili na ka dhuruar sa e sa dhurata? Qysh të mos

e perkrahim¹ e të mos e ndihmojmë Feën Islame, të cilën e ka derguar Zoti si dhuratë, për mbarë-vajtjen njerzore? Si të mos e përkrahim e të mos e përqafojmë ngushtaz Islamizmen, të cilën Zoti na e ka zgjedhur për Fé, sikurse urdhnon: «و رضيت لكم الإسلام ديناً - Juve u kam zgjedhur për fé Islamizmen»? pse të mos e përkrahim Islamizmen, të cilën Zot' i Naltë, q' i bën punët me vend, e ka pranuar për fé Hyjnore, sikurse urdhnon në Kodin e Islamizmes, Kuranin e Shënjtë: «إن الدين عند الله الإسلام» - Me të vërtetë fé e pranueshme tek Zoti është Islamizma e tjetër jo?»

Islamizma duhet ruajtu me pekul, duhet përkrahur dhe duhet të zerë, në ndergjegje të njeriut vëndin më të lartë, pse Ajo është përkrahse e bonjakve dhe e të vorfënve, fortes' e shpëtimit, kopsht' i përparimit materjal e shpirtnorë, është themel i paqës, i vellazerís dhe i barazís. Cila është ajo qi siguron drejtësin, cila është ajo qi përmirëson moralin, cila është ajo qi perkrah atdhën? Ësht Islamizma, Feja Hyjnore; prandaj këjo Fé meriton çdo ndihmë e sakrificë prej të gjithë njerzve.

Verseti Hyjnor, m të cilin u stolis kryet e këti arikulli, shkurtimisht ka këtë kuptim: «O Besimtarë! O ju q' e kini pastruar zemrën prej të gjitha ndyesive! O ju q' e kini ndriçuar zemrën me dritën e Besimit dhe e kini nderuar dhe zbukuruar gjuhen

1. Përkrahja është për të mirën t' onë, pse Zoti fenë që ka çue e ruan Vetë.

me fjalën madhështore t' Unitetit (Tevhidë)! Behuni ndihmuesa në qellim të Zotit, sikur se Krishti, i Bir' i Merjemës, u tha Apostujve: «Cilët janë ndihmtarët e mí në qellim të Zotit»? Apostujt u përgjegjën: «Na jemi ndihmtarë në qellim të Zotit».» Tash len një pyetje kështu: Si mund t' a ndihmojmë e t' a përkrahim feën? Të gjitha punrat e mira, si përkrahja e të vorferve, e bonjekve, themelimi dhe meremetim' i xhamijave, përkrahja e studentave, të cilët perpiqen për Atdhé e fé, çilja e spitaleve dhe shumë sende të tjera, mund të numrohen ndihmë e përkrahje për fé. Por, ndihma m' e rëndësishme mund t' i bëhet fés, për mbas mendimit t' em, tuke marrë parasysh kohën e kritikëshme, me edukimin e fëmive, mbi të cilët mbështetet vlera e fés dhe e atdheut.

Edukim' i fëmive u përket prindërve, të cilve Zot' i Madhnueshëm ja u ka bâ detyrë me versetin që po shënojmë këtu poshtë: «يا أيها الذين آمنوا قوا أنفسكم وأهليكم» - O Besimtarë! Ruani vehten dhe familjen t' uaj prej zjarrit!»

Për të bërë fjalët e prindërve efektin e duhur, duhet të kenë pajosë vehten e tyre me sjellje dhe edukatë shëmllore, të cilën lypset, për mbas urdhërit Hyjnuer, t' ja u mësojmë edhe fëmivët të tyre. Shpëtimtari i njerëzimit H. Muhammedi (A. S.) urdhnon: «كلكم راع و كل راع مسؤول عن - رعيتة - Seicili prej jush është bari dhe përgjegjës për turmën e veb». Kjo

fjal' e lartë Profetike na shtyn të kemi kujdes të plotë për ata, të cilët i kemi nën vehte e qi na njohin si kryetar; atyre duhet t' ju plotsojmë nevojat, m' e madhja e të clavet është t' edukuarit e shpirtit. Detyra e Profitve qe udhë-heqja e popullit në rrugë të mbarë, detyra e prindve është edukim' i fëmive të tyre; prandaj, si thamë, duhet të jenë aqë të sjellshëm, sa qi fjalët e tyre të bijnë ndër fëmijët përshtypjen m' të thellë dhe të përgjegjen: «po, ju bindëm dhe e pranuemë urdhërin t' uaj» sikurse u bindën apostujt, tue than: «Na jemi ndihmtarë për qëllimin e Zotit».

Edukim' i fëmive plotësohet, atëherë, kur t' ju mësohet atyre feja, bashkë me të cilën kanë lindur. Feja, me të cilën ata lejnë dhe e kanë në natyrë, është Islamizma sikurse e vërteton fjala Profetike: «كل مولود يولد -على فطرة الإسلام ثم أبواه يهودانه أو ينصرانه أو يمجسانه- Çdo fëmi len me natyrën Islame d. m. th. Sikur të mos i mësohet ndonji fé, kishte për të përçafuar Islamizmen; mirë po, prindërit e bëjnë Jahudi, ose Kristjan, apo Mexhusi».

Koh' e edukatës është qysh prej djepit deri në varr, por m' e volitëshmja është në vogjëli, mbasi i vogli është mjaftë sensitiv dhe ka mëndjen e kulluar, me të cilën thith sjelljet, sikurse aparat' i fotografis, i cili thith figurat q' i dalin para. Nji fjal' e lartë Arabe është kështu: «العصن الرطيب يتقوم بالتربية» e cila do të thotë: «Filiz' i njomë rritet si mbas drejtimeve qi t' i openë».

Edukimi ka nji rëndësi të posaçme, mbasi shofim se është princip' i njerzve të mbëdhej e të virtytshëm, të cilët janë munduar me çdo mëndyrë qi ka qenë e mundur, si e si t' i pajosnin fëmijet e tyre me sjellje të pëlqyeshme, me të cilën të knaqnin jo vetëm prindrit e tyre, por edhe rrethin, ku ndodheshin.

Llokman Haqimi, i cili, sikurse na e difton Kur-an' i Shënjtë, s' qe vetëm nji doktor, por edhe nj' i Shenjtë, është munduar mjaftë tue edukuar djalin e Tij, q' ishte i pa fé. Me kurajon që diftoj H. Llokmani e pruri, m' në fund, djalin ne fé dhe nuk e la n' errsirë.

Fëmija afetar s' është i vlefshëm as për atdhë dhe as për familje, mbasi nuk i di detyrat qi ka kundrejt tyre. Ata të cilët thonë se, atdhetari duhet të jetë i pa fé, janë krejtë të gabuarë, pse, fëmija afetare, edhe n' i ditët detyrat qi ka kundrejt atdheut, nuk mund të luftojë me gjithë shpirt, mbasi nuk beson se ka ndonji shpërblim në jeten tjetër dhe nuk beson se shkon dëshmorë. Kurse fetari, jo vetëm q' i di e i njeh detyrat që ka kundrejt atdheut, por edhe lufton për të, mbasi ka dy shpresa të gjalla:

a) Në qoftë se fiton luftën, shpëton atdhën dhe del fitues (triumphator).

b) Në qoftë se vritet, vdes dëshmorë, i cili, për mbas mësimet fetare, shkon në paraajs (xhennet).

Të gjitha urdhnat e porositura prej Kur-anit të Shënjtë e prej H. Muhammedit (A. S.) janë baza themeltare me anën e të cilave lartësohen njerzit; mirë po, në vënd që t' i afrohemi detyrës, më tepër i shtëmangemi, dhe urdhnat e Profetit të Shënjtë, të cilat jo-Muslimanët i kanë marrë për rregullim dhe shumicën e tyre i konsiderojnë si burim të tyre, i kemi lënë pas dore. Prandaj duhet vajtuar hall' i jonë, kur shofim nëpër rruga fëmijët tue folë fjalë të këqija e plotë me rrena. Për të vertetuar se, shumë udhëna të H. Muhammedit i konsiderojmë si të tyret, po bije një shëmbëll, e cila ka lidhje me themën, t' onë: Anglezët rrenën e numrojnë një gjë të poshtme e të keqe; prandaj para femive nuk flasin rrena, pse atëhere edhe fëmijët do të mësohen me rrejtë. Këtë princip Anglezët e njohin si një burim origjinal të tyre; mirë po, në qoftë se vështrojmë në Librin «إحياء العلوم – Ihjaul-ulum» të Gazaliut, gjëjmë këtë ndodhi:

«H. Pejgamberi kishte shkuar te halla e Vetë e cila i tha djalit të sajë: (Ec në treg, na merr një send, pra, kur të ktheheç, kam me të dhënë një lek – po themi –; mirë po, kur u kthye djali, ajo s' i dha gjë). H. Muhammedi, të Cilin në çdo pikpamje që t' a shofim, na del m' i përsosuri njeri, i tha: - Mos e rrej, o Hall' e Eme! pse i vogli e

bën zakon e kështu ka për të rrejtur, kur të rritet». Merret vesh se të mos gënjerit e prindvet para femive, nuk është zakon origjinal i Anglezvet, por porosi e H. Muhammedit (A. S.). Atëhere, del fundi kështu:

Të gjithë ata, qi dëshirojnë me shpëtue nga ndëshkimi Perndijor, ata që dëshirojnë të kenë shpërblime në të dy jetët, ata që dëshirojnë të mirën e atdheut dhe ata që dëshirojnë të përmenden pas me respekt, le t' edukojnë fëmijët e tyre si pas porosive të Kur-anit e të H. Muhammedit (paqa dhe bekim' i Zotit qoftë mbi të).

Lumtërija e kombeve, forca dhe qetsija e shteteve varet n' edukimin e të rive; prandaj Filosofi Laibniç ka thënë: «Le të ma apin mua edukimin e fëmijvet t' a këtthej për së mbari gjëndjen e faqes së dheut».

N. M. T. Zog. I, Mbret' i jonë shumë i dashtun, shpreh këtë fjalë t' artë: «Unë djalerin e dua me disiplinë»; këjo na tregon se, edukim' i të rive, luan një rrol me rëndësi n' evolusjonin e një shteti.

Si dashurues i të mirës, i lutem Mëshiruesit Perëndi qi brez' i ri i Shqipnis të pajoset me dedukatën e plotë dhe me virtytet e larta fetare, me anën e të cilave të përpiqen për Atdhé për Fé e për Mbret.²

2. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 3, viti XI, mars 1936, f. 77 – 82.

Abstracts in English

Islamic Sciences

1. Islam's strategy for peacemaking in the world

Prof. dr. Muhamed Sherkavi, Saudi Arabia

Abstract

Islamic teachings point to the human right to freely choose their own faith and religion. The Qur'an emphasizes this principle in many passages like: "There is no compulsion in religion" (Baqara, 256); "If anyone wants to believe let him believe and whosoever will, let him disbelieve" (al-Kahf, 29); "And you are not obligated to make them believe forcefully" (Ghashiya, 22); "Your duty is just to foreshadow." (Shura, 48).

Islam recognizes the right to freedom of opinion and expression.

It should be known that any attempt to dismantle the principle of pluralism and freedom, and any manipulation that can be done in this respect has nothing to do with Islam and does not represent the true principles of Islam, even if it comes from people and organizations who identify themselves with Islamic religion. Such practices are totally far away from the true Islam and the major goals of its message.

2. It is the Glorious Qur'an(A verse and reflections on a fact)

Blerim Lazimi

Physics teacher at "Said Najdeni" High School, Peshkopia

Abstract

People, at any time, have made efforts to find arguments by which justifying the mobility or immobility of the Earth, and furthermore, to understand its place in the universe (as the only planet sustaining life)... In the first part of the verse the opinion and viewpoint that ruled for centuries in scientific and philosophical worldview, even beyond Quranic era until the years 1500-1600, is clearly reflected. "And you see the mountains and think they are stationary ...". Namely, in this short part of the verse appears synthesized the idea that humanity has constantly and historically observed and studied the mountains of the earth. And further, it means that people have surmised that the mountains and the earth are

stationary. So they have formulated the false impression that the earth does not move, i.e. the idea of geocentric system.

3. Ibn Majah and his Sunan

Dr. Sedat Islami, Kosovo

Abstract

One of the scholars that has taken an important place in the history of Islamic science is Ibnu Majah. His contribution, although extended in several religious areas, has left deep traces in the hadith. Ibnu Majah is the author of Sunan, one of six basic books of prophetic traditions or Hadiths as they are known in the relevant terminology. This paper aims to shed light on the biography of the author on the one hand, and on the research description of his work on the other. Its importance lies in the fact that maybe for the first time in this format, it introduces to the reader this colossus of knowledge and his majestic work.

Studies

4. An overdue homage for the cornerstone personality of the Albanian bridge Lumo SKËNDO at “Zani i Naltë”

Prof. dr. Rahim Ombashi, BEDER University, Tirana

Abstract

This magazine of Albanian Muslim Community emerged during an important period of our national history which resulted very agitated; at a period with little events when Albanian spiritual world was in search of the lost time. After several rebellions, uprisings and coups that followed one another, the magazine appeared in our spiritual sky like a warm light that would offer its help not only in informing the reader, but which would foster such a type of communication that had local and temporal coloring.

The magazine shows the interconnection of traditional media with the contemporary, as T.S. Elliot has noted in his essay entitled “The individual tradition and talent” (1919). According him, even the most individual parts and the best work of a certain author, are those by which the previous authors had strongly confirmed their immortality.

5. “ZANI i Naltë” – A magazine of religious thought and national emancipation

H. Resul Rexhepi, Muslim Community of Kosovo

Abstract

“Zani i Nalte” is an enterprise designed by great people, by visionaries farsighted patriots and ulemas, who through their work contributed preciously in explaining the teachings of Islam fairly and accurately and helped in creating the state and national identity forming. It is just this golden generation of prominent Muslim leaders who left their outstanding mark on our religious and national history, like Hajji Vehbi Dibra – the imam who gave the fatwa on the declaration of Independence, and later the founder and first chairman of the Albanian Muslim Community; the well known ulemmas: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Ali Kraja, Ismail Maçi, Jonuz Bulej, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, Qazim Hoxha, Shevqet Dajiu, Shevqet Muka, Nebil Çika, Sali Butka, Hamid Gjylbegu and many others, without leaving aside here the other personalities of political, cultural and literary thought like Midhat Frashëri and other compatriots. This has made possible that even 90 years later, the articles published in “Zani i Nalte” resembling very actual and coherent and sounding as being said today.

6. Muslims and the time, Muslims in time

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

University Hospital Center “Mother Teresa”, Department of Statistics, Tirana

Abstract

Muslims constitute 24% of the world’s population and their number in 2020 is expected to be about 2 billion or 26% of the total population. Such a population extended across continents, brings with it a unique culture of their faith, where the concept of time, its measurement and management takes an Islamic hue. Implementation of transcendental Quranic comandations has been well defined for the Ummah of Muhammad P.U.B.H., being also ordered to coexist with others without imposing forcefully their own faith through violence. The existence of Islamic society in such a balance makes no exception to the notion of time, extensively referred from the Quran and with a direct impact on the practice of religious duties. Its knowledge and study minimally becomes the first task for everyday life and also for managing the relations with others. The principle remains the same for all Muslims, while in reality the projection takes different values depending on geography, historical periods and social relations. It can be calculated that in Mecca the time necessary for fasting consists 4.7% of a lunar year while in Tirana it is 4.9% of the period of an entire lunar year. On the other hand we can see the obligated changes made throughout history when Muslims have combined their standard measuring time via lunar calendar and times of prayer with the solar calendar, or have adopted components such as the periodic clock changing twice a year. Such a permanent change requires a constant study of the phenomenon and frequent adjustments.

Language and literature

7. Albanian language instruction during the Renaissance up to beginning of the 20's of the last century

Prof. dr. Njazi Kazazi

Department of Linguistics,

“LUIGJ GURAKUQI” University, Shkodra

Abstract

Several historical processes that occurred during the middle ages left deep traces in the development of culture and education in Albania. Albania was occupied and in front of assimilating targets of foreigners, the development of education in the Albanian language was very difficult. In such conditions as writing language in Albanian territories were used Latin language in the North and Greek language in the South. In the fifteenth century the Turkish-Arabic language became the official language, but in addition, Italian and Latin language were also used. Although these languages penetrated one after another, they failed to get the status of the spoken language by the people, thus their use was limited to the administration of the invaders, religious services and in their schools. During this time in the country only the foreign schools were recognized as standard educational institutions. Albanian language apparently began to be taught later, but efforts to develop its original script may have started in the XVII century.

History

8. Albania's secession from the Ottoman Caliphate and the efforts for the independence of the Albanian mosque

Dr. Hasan Bello

Institute of History - Centre of Albanological Studies

Abstract

On the proposal of the Sharia High Court, which functioned as the highest instance of Islamic affairs, attempts were made to reorganize the Islamic theological studies. Thus, instead of small madrasas that were very extended in the past, some of which performed their activity with a single teacher (Myderriz), the opening of some more complete madrasas was projected in the main cities of Albania, such as Shkodra, Elbasan, Berat, Tirana and Durrës. These madrasas would have the structure of high schools according to the European model and, in addition to religious subjects, secular subjects would be taught in Albanian

language. For the preparation of religious teachers (*myderriz*) and sharia judges, the opening of a theological university in the center of the country, exactly in Elbasan was thought. In this university would study madrassists who aspired for a higher theological preparation.

9. Religion in schools

A view of intercultural communication and interfaith dialogue specialists

MSc. Qani Sulku

Journalist

Abstract

A statement of the Prime Minister of Albania, Mr. Edi Rama about the inclusion of a subject on religious knowledge in university education curricula sparked an online debate in the Albanian media, both audiovisual and printed, and also made sensation in public opinion. In these discussions was observed the lack of intercultural communication and interfaith dialogue specialists as the most competent people in this field. Their perspective and analysis is important and necessary for the subject of this nature. But how was considered and commented the statement of the Prime Minister? Why statements of this type cause a rapid response in the media, according their opinion? How clearly the statement made by the head of government was understood by the pollsters who were part of television panels or columnists of the daily press? Did Prime Minister in his statement mean a genuine religious subject, or merely a subject which consists in studying the history of religions? How similar and different are these two? These and other questions we will try to answer through an interview conducted by the expert of Intercultural Communications and Interreligious Dialogue, Prof. asoc. dr. Gentiana Skura, and also through a questionnaire conducted to graduates students of intercultural communication profile in 2015, as well as through a survey conducted by students of pre-university educational system.

Personalities

10. A major personality of medieval Albania - Ilyas Bey Mirahori (1410-1512)

Hysen Kobellari, Ph.D.

Abstract

From the depths of centuries come to us signs, informations, interesting facts and documents about a distinguished and important Albanian personality - and not only – of medieval period, called Ilyas Bey Mirahori. This major figure neglected by our historiography, but immortalized in the memory of people, has exceeded the limits of the history of a

country, regarding his wide, long and multi-faceted influence and activity extended in time and space. S. Frashëri, N. Naci, Ilo Mitkë Qafëzezi, P. Pepo, S. Pulaha, S. Ramo, etc., have given many important and valuable informations in order to somehow illuminate this multifaceted figure of such a magnificent fashion. There are thousands of pages of documents and letters that languishes in the archives of Turkey. In the State Archive of Tirana, in the fund entitled on his name, there are four decrees (noble fermans) Sultan, belonging to the years 1484, 1496, 1497 and 1503; stories, songs and legends on his life and his works still vivify among people; toponyms, boundaries, names of places and objects still exist today, regardless the dust of forgetfulness that centuries leave behind. Real estates left by Mirahori are located in several Balkan countries, perhaps in two continents; the charitable and civilized activity of Ilyas Bey is one of the first and one of the few on the continent. His descendants still live in Korca and elsewhere under Myteveli surname. Frashëri brothers – well known patriots and scholars - were his progeny by their mothers lineage. A magnificent monument of culture and history which has resisted time, “Ilyas Bey Mirahori “Mosque, the oldest and most beautiful in the region and above all, an entire city, Korca, ancient as much as young, beautiful and contemporary, all these bear his name.

Retrospective

11. Religion should be supported

Rrapo Rustemi

Student of the General Madrassa (Tirana)

Abstract

The man has rooted in his nature the appreciation and reverence to a friend, from whom he has had a kindness, even if small. Man sees with sympathy his wealth, especially if he has harvested useful fruits from it; he always tries to do the necessary service to his property because from it he provides physical foods which help him surviving in his provisional life.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.